
| | |
|---|----|
| Zonat kulturore e civilizimit islam | 3 |
| Brzezinski: respektim të dinjitetit politik të muslimanëve..... | 8 |
| Islami në dy tre fjalë | 9 |
| Shkëndija e udhëzimit..... | 10 |
| Një miliard musliman në krah të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem..... | 12 |
| Zgjedhja e shokëve..... | 16 |
| Përgjegjësia e edukimit të fëmijëve..... | 18 |
| Morali i shoqërisë muslimane..... | 21 |
| Mëkatet gjatë verës..... | 25 |
| Hifzi-mësimi përmendësh i Kur'anit..... | 29 |
| Sqarim për hadithin e Nexhd-it | 31 |
| Dispozita islame për adoptin..... | 33 |
| Definicioni i Sheriatit | 37 |
| Konflikti mes mendjes dhe epshit..... | 38 |
| Arti i të dëgjuarit..... | 41 |
| Babi, mi jep 10 euro!..... | 41 |
| Këshillat e Lukmanit drejtuar të birit të tij..... | 42 |
| Dy fjalë nga zemra, motra–motrës | 44 |
| Imam Zuferi..... | 45 |
| Imam Ebu Theuri | 46 |
| Imam Ibën Salah..... | 47 |
| Ibën Haxher El Askalani..... | 48 |
| Tema: Pastrimi dhe namazi i të sëmurëve | 50 |
| Gjendja jonë e dhimbshme | 52 |
| 12. Vlera e zuhdit në këtë botë | 62 |

edicion i botuar / viti i parë / nr: 12

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

redaktor teknik: Azem Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Zonat kulturore e civilizimit islam

Njerëzit shpesh flasin për islamin arab, persian apo turk, sikur të ekzistonin tre islama. Në realitet, ekziston vetëm një islam, por me nuanca lokale të lidhura me tiparet etnike, linguistike dhe kulturore të popujve të ndryshëm që janë bërë pjesë e komunitetit islam. Kudo që ka arritur islami, ai nuk ka tentuar të rrënojë deri në themel strukturat ekzistuese kulturore, por t'i ruaj dhe transformojë nëse ata i kanë kundërshtuar frymës dhe formës së shpalljes islame. Rezultati ka qenë krijimi i një identiteti islam. Rrafshi i gjerë i "Atdheut islam" (dar ul-islam), prandaj, ka zhvilluar një varietet të dukshëm në planin njerëzor, derisa gjithandej ka mbajtur porosinë e Kur'anit të shpallur përmes Pejgamberit. Ky varietet etnik dhe kulturor, karshi të gjithë faktorëve tani më të përmendur, për t'i bërë më të qartë modelet të cilët, të vendosur njëri mbi tjetrin, kanë krijuar një llojllojshmëri të madhe në unitetin ekzistues islam.

Zona e parë kulturore në botën islame është ajo arabe, e cila shtrihet prej Irakut dhe gjirit të Persisë deri në Mauritani, ndërsa para vitit 1492 është shtrirë madje deri në pjesët jugore të gadishullit të Iberisë. Nuk është nevoja të theksohet, për dallim prej asaj që mendohej në Perëndim, që bota arabe në asnjë mënyrë nuk është sinonim me botën islame. Në të vërtetë, muslimanët arabë përbëjnë më pak se një të pestën e të gjithë muslimanëve, ngase Arabët janë në numër diku rreth 220 milionë, mirëpo me që Kur'ani i është shpallur një Arabi Pejgamber

të islamit, dhe pasi që grupi i parë islam është krijuar në Arabi, zona arabe e "Shtëpisë së islamit" është pjesa më e vjetër e komunitetit islam. ...

...Fjala "arab" është term lingvistik dhe jo etnik kur përdoret në fraza si "bota arabe". (çdo të thotë, mendohet në një popull që fletë në gjuhën arabe). Gjithashtu ka pasur shumë migrime arabe në këtë pjesë të botës, mirëpo ajo që e ka bërë këtë botë vendosmërisht arab ka qenë përqafimi i gjuhës arabe prej Marokut deri në Irak. Madje edhe vendet me një të kaluar shumë më të lashtë siç është Egjipti, janë bërë arabe, dhe në të vërtetë, deri më sot ka mbetur qendër e kulturës arabe. ...

Është interesant të krahasohet ky zhvillim me përhapjen e krishterimit në Evropë. Duke u bërë krishtere, Evropa gjithashtu deri në një masë është bërë pjesë e botës abrahamicane, mirëpo mbetet më pak e semitizuar se muslimanët joarabë të cilët e kishin pranuar islamin, sepse krishterimi i Shën Palit edhe vetë ishte bërë më pak "semitik" para përhapjes në Evropë. Këtu qëndron arsyeja përse krishterimi i Evropës nuk është shoqëruar edhe me përhapjen e gjuhës arameite apo një gjuhe tjetër semite në mënyrë të njejtë në të cilën ishte përhapur gjuha arabe në Lindjen e Mesme dhe në Afrikë, si dhe ndër Persianë dhe Indusë, të cilët i përkasin drurit të njejtë gjuhësor dhe racor si dhe evropianët. Jo vetëm që ugjiyt kanë qenë të shkruar me gjuhën greke dhe jo atë aramei-

te me të cilën ka folur Krishti, por gjithashtu edhe vetë Bibla është përkthyer në gjuhën latine si Vulgata dhe kështu u këput në aspektin gjuhësor nga burimi i saj. Gjuha latinishte u bë më e afërt, për nga roli i saj si gjuhë fetare dhe shkencore në Perëndim, siç do të bëhet gjuha arabe në botën islame, me dallimin kryesor që arabishtja është gjuhë vërtet e shenjtë e islamit, siç është hebreishtja e jahudizmit, ndërkaq që latinishtja është gjuhë liturgjike e krishterimit bashkë me disa gjuhë tjera liturgjike, si ajo sllave dhe greke. ... rëndësia e gjuhës arabe tek muslimanët joarabë nuk mund të identifikohet me krishterimin e Evropës dhe rolin e gjuhës latine në Perëndimin mesjetar ...

... Zona e dytë e kulturës islame, populli i cilës ka qenë grupacion tjetër që e kishte pranuar islamin dhe bashkë me Arabët, kishite marrur pjesë në ndërtimin e civilizimit klasik islam, është zona persiane, të cilën e përbëjnë Irani i sotëm, Afganistani dhe Taxhikistani (me disa qytetet në Uzbekistan). Gjuha dominuese e popujve të këtyre vendeve është gjuha persiano-iraniane...

... Persiani i parë i cili e kishte përqaftuar islamin ka qenë Selman el-Farisi, rob të cilin Pejgamberi e kishte ndihmuar të bëhet i lirë...

... Mirëpo do të ishte gabim të supozohej që Persianët gjithnjë kanë qenë shiitë, kurse Arabët sunitë... Shiizmi ka zënë fill në mesin e Arabëve, ndërsa në shekullin dhjetë, sipas Isait, alejhis-selam, pjesa më e madhe e lindjes arabe ka qenë shiite, ndërkaq që Horosani, krahina kryesore persiane, ka qenë qendër e mendimit sunit. Vetëm pas themelimit të Safavidëve, Persia u bë kryesisht shiite, ndërsa kjo mazhorancë u shtua kur Afganistani, një pjesë e Baluxhistanit dhe pjesa më e madhe e Azisë së mesme, që kanë qenë kryesisht sunitë, u ndanë nga

Persia dhe kur u themelua Irani në formën e sotme. Kur është fjala për Afganistanin, gjatë periodës së Safavidëve deri në shekullin tetëmbëdhjetë ka qenë pjesë e Persisë. Pastaj prijësi i fiseve afgane mposhti Safavidët dhe arriti ta vrasë mbretin e fundit safavid...

Zona e tretë e kulturës islame është Afrika e zezë. Në përcjelljen e Pejgamberit, krahas Selmanit, ka qenë edhe një shok tjetër i cili nuk ka qenë Arab. Ai është Bilal ibni Rabah el-Habeshi, mujezini ose thirrësi në namaz i Pejgamberit, i cili ka qenë Afrikan i zi. Prania e tij ka simbolizuar përhapjen e shpejtë të islamit në mesin e zezakëve dhe krijimin e zonës afrikano-zezake të kulturës islame, e cila përfshin një sipërfaqe tejet të madhe prej rrafshlartës etiopiase, ku islami u përhap që në shekullin shtatë, deri në Lai dhe Senegal. Për pasardhësit e Bilallit flitet se kanë migruar në Mali, duke themeluar klanin Mandinga të Keitit... Disa prej shokëve të Pejgamberit gjithashtu kanë migruar në Çad dhe atje e vendosën islamin një gjeneratë pas Pejgamberit. Sidoqoftë, islami u përhap në Afrikën e zezë kryesisht përmes tregtisë, ndërsa fiset si sanhaxhët, të cilët me herët vetë e kishin përqaftuar islamin, u bënë ndërmjetës midis muslimanëve arabë në veri dhe Afrikanasve të zinj. Në shekullin njëmbëdhjetë u themelua mbretëria e fortë islame në Ganë, ndërsa në shekullin katërmëdhjetë perandoria e Malit e cila ishte muslimane, dhe ishte njëra ndër më të pasurat në botë. Sundimtari më i njohur, Mansa Musa, ka qenë njëri prej sundimtarëve më të shquar në mbarë botën islame. Në Afrikën lindore e cila e kishte pranuar islamin para Afrikës perëndimore, procesi i përhapjes së islamit ka marrur rrugëtim të ndryshëm dhe ka qenë nën ndikim të thellë të migracionit si të Arabëve ashtu edhe të Persianëve në viset

bregdetare të Afrikës. Në shekullin dymbëdhjetë u themelua mbretëria Svahili me kryeqytetin Kilvi, ndërsa nga përzierja e gjuhëve arabe, persiane dhe bantu u krijuar gjuha e re svahili, mbase gjuha më e rëndësishme e Afrikës së zezë muslimane. Mirëpo, për dallim nga bota arabe dhe persiane, ku dominon një gjuhë, zona afrikano zezake e kulturës islame përbëhet nga disa nënzona me gjuhë tejet të ndryshme, duke filluar prej hausëve dhe fulanëve deri te somalitët. Me disa prej këtyre gjuhëve komunikojnë edhe të krishterët, ndërsa në aspektin kulturor ato gjuhë janë të rëndësishme për krishterimin afrikan.

Ndonëse veriu afrikan ka qenë tanimë arab që një shekull pas paraqitjes së islamit, vendi i quajtur Sudan, që përfshin stepat dhe kullosat deri te Sudani i sotëm dhe Senegali, gjithashtu është bërë në masë të madhe muslimane para më se një mileniumi. Mirëpo vetëm prej shekullit nëntëmbëdhjetë islami ka filluar të depërtojë edhe në brendi në regjionet malore në jug të Sudanit klasik. Ekzistojnë, natyrisht, edhe regjione dytësore midis veriut arab dhe Afrikës së zezë, ku këto dy zona janë pikëpjekur, siç është Sudani i sotëm, Eritreja dhe Somalia. Zona e kulturës afrikano-zezake islame, me një popullsi prej rreth 150 milion banorësh është shumë e ndryshme dhe paraqet panoramë të dallimit etnik dhe kulturor brenda unitetit lokal të kulturës së afrikano-zezakëve dhe unitetit universal të vetë islamit.

Zona e katërt e kulturës islame është zona turke, e cila përfshin të gjithë popujt që flasin njëren prej gjuhëve altaike, prej cilëve më e rëndësishme është turqishtja, por në gjuhët altajase bëjnë pjesë edhe gjuhët: azere, çeçene, ujqure, uzbeke, kirgize dhe turkmene. Populli turk, i cili fillimisht kishte qenë nomad, ka migruar në jug prej maleve

të Altait për ta pushtuar Azinë e mesme prej Persianëve, duke ndryshuar natyrën etnike të saj, por e cila në aspektin kulturor ka mbetur tejet e afërt me botën persiane...

...Turqit jo vetëm që mposhtën sundimtaret lokalë persianë, siç janë Samanidët, porse depërtuan në perëndim kah Anadolia, duke i shkaktuar humbje armatës bizantine në Betejën e Manzikertit (Malazgirt), në vitin 1071. Kjo ka qenë njëra prej betejave vendimtare në historinë islame. Ajo hapi kullosat e Anadollisë për nomadët turq dhe solli turqizimin e Anadollisë, themelimin e perandorisë Osmane dhe në fund pushtimin e Konstatinopolit, në vitin 1453. Turqët ishin të fortë ushtarakisht dhe kanë sunduar në shumë vende muslimane, duke përfshirë Persinë dhe Egjiptin, ndërsa roli i tyre në historinë e mëvonshme islame vështirë se mund të tejtheksohet. Sot popujt turq, që janë më se 150 milion, janë të përhapur prej Maqedonisë deri në Siberi, dhe më tej deri në Vlladivostok, dhe në aspektin gjeografik janë grupacioni më i gjerë etnik dhe kulturor brenda botës islame. Ekzistojnë grupacione të rëndësishme turke brenda viseve tjera që nuk janë me shumicë turke përfshirë këtu Persinë, Afganistanin, Egjiptin, Jordaninë, Sirinë dhe Rusinë, e cila ka pakica të mëdha etnike turke që janë mbetje e popujve të mbetur gjatë ekspansionit të perandorisë ruse...

Zona e pestë e rëndësishme e kulturës islame është ajo në siudhesën e Indisë. Që në dekadën e parë të shekullit tetë sipas Isait, alejhis-selam, armata e Muhammed ibni Kasimit e pushton Sindin, dhe kështu filloi depërtimi i islamit në këtë siudhesë, që zgjati në disa dekadat e ardhshme...

...Gjithashtu kanë qenë edhe invazionet në Indi të ndërmarra nga disa sundimtarë turq, ndërsa prej shekullit njëmbëdhjetë e këtej, deri në kolonizimin britanik të Indisë,

sundimtarët muslimanë kanë sunduar pjesën më të madhe të Indisë, ku Mogulët themeluan perandorinë e madhe në shekullin gjashtëmbëdhjetë. Islami indus në planin etnik kryesisht është homogjen, me disa elemente persiane dhe turke, por në aspektin kulturor dhe gjuhësor është tejet i ndryshëm. Gjatë pothuaj njëmijë vjetëve gjuha persiane tek muslimanët indianë ka qenë gjuhë e intelektualëve dhe shkrimit, por disa gjuhë lokale, siç është: sindi, guxharati, panxhabi dhe bengali, gjithashtu kishin rol të madh si gjuhë islame. Gradualisht, prej shekullit gjashtëmbëdhjetë deri në atë tetëmbëdhjetë, gjuha e re u lind duke kombinuar gjuhët induse dhe atë persiane si dhe elementeve të gjuhës turke, dhe kjo gjuhë e re u bë e njohur si gjuha urdu. E shkruar me shkrimin arabopersian, si svahili, gjuhës osmane-turke dhe disa gjuhëve tjera islame, urdu së shpejti u bë gjuhë kryesore i diskursit islam dhe më vonë u pranua si gjuhë zyrtare në Pakistan. Zona indiane e kulturës islame përfshinë Pakistanin, Bangladeshin, muslimanët e Indisë dhe Nepalit, dhe Shri Lankë. Në këtë regjion jetojnë rreth 400 milion muslimanë; prandaj ka më shumë muslimanë në këtë pjesë të botës se në çfarëdo regjioni tjetër. Arsye për një popullëzim aq të madh është shtimi i popullacionit të përgjithshëm në tërë Indinë prej shekullit nëntë, duke përfshirë indusët dhe muslimanët, dhe faktit që më se një e katërta e indusëve e kanë pranuar islamin...

...Muslimanët indusë kanë krijuar disa nga veprat më të mëdha të artit dhe kulturës islame...

Zona e gjashtë e kulturës islame përfshin botën malaje të Azisë juglindore. Në këtë pjesë të botës islamin e kanë përhapur tregtarët arabë nga gjiri i Persisë dhe deti arabik, por edhe ata të Indisë prej shekullit

trembëdhjetë e këndeje. Islami malaj tregon gjithashtu homogjenitet të madh etnik dhe posedon tiparet e veta lokale...

...Islami malaj, ku dominojnë gjuhët malaje dhe javane, përfshin Indonezinë, Malezinë, Brunejin dhe pakicat e mëdha në Tajlandë dhe në Filipine, si dhe pakica më të vogla në Kamboxhë dhe Vijetnam. Sidoqoftë, janë rreth 200 milion muslimanë në këtë zonë, dhe ndonëse kjo pjesë e botës islame është relativisht e re në "Shtëpinë islame"...

...Krahas këtyre gjashtë zonave të kulturës islame, duhet gjithashtu të përmenden edhe disa më të vogla. Njëra është islami kinez, prejardhja e cilit shkon prapa deri në shekullin shtatë, kur, së shpejti pas arritjes së islamit, tregtarët islamë i vendosën në disa pjesë të Kinës siç është Kantonit. Prej kësaj kohe në Kinë islami ka qenë gjithënjë prezent, por kryesisht në Sing-jang, siç e quajnë gjeografët muslimanë Triksistanin lindor. Popullsia islame e Kinës përfshin si popullin me prejardhje turke, siç janë Ujgurët, ashtu edhe Kinezët vendës të quajtur Hui. Madje edhe në mesin e Hanëve ka pak muslimanë. Numri i muslimanëve në Kinë mbetet mister i vërtetë, kurse përmendet numri prej 25 deri 100 milionë. Ekziston një arkitekturë dhe kaligrafi e posaçme kineze, si dhe një traditë intelektuale...

Ekzistojnë, pastaj, muslimanët evropianë – jo enklavat turke që ndodhen në Bullgari, Greqi dhe Maqedoni – por grupet etnike evropiane që janë musliman tani e pesë shekuj. Grupacioni më i rëndësishëm në këtë aspekt janë Shqiptarët, të cilët janë të shtrirë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, dhe Boshnjakët, të cilët jetojnë kryesisht në Bosnjë, por një numër i vogël i tyre jeton edhe në Kroaci dhe Sërbi. Këto grupacione janë pema etnike evropiane, ndërsa të kuptuarit e kulturë së tyre është me rëndësi për kupti-

min më të mirë të spektrit të islamit në tërësinë e tij, gjithashtu edhe për marrëdhëniet më të mira të islamit dhe Perëndimit në Evropën e sotme.

Së fundit, ekzistojnë bashkësi islame në Evropë dhe Amerikë, duke përfshirë edhe emigrantët dhe konvertitët (ose ata që muslimanët më me dëshirë i quajnë "revertitë", respektivisht ata që i janë kthyer religjionit parësor/primordial, e cila këtu identifikohet me islamit). Këto bashkësi islame përfshijnë edhe disa milionë afrikano-veriorë në Francë, rreth 3 milionë turq dhe një numër të konsiderueshëm kurdësh në Gjermani, rreth 2 milionë njerëz, kryesisht nga gadishulli i Indisë në Britaninë e Madhe, dhe një pjesë më të vogël por të konsiderueshme në vendet tjera evropiane. Në Amerikë ka si emigrantë, të cilët janë kryesisht nga Lindja arabe, Irani dhe gadishulli i Indisë, ashtu edhe konvertitë, kryesisht nga amerikanët e Afrikës, por edhe një numër nga të bardhët. ... Në këtë proces roli i el-Haxh Malik el-Shabazzit, të njohur si Malkolmi X, ka qenë me rëndësi të veçantë. Aktualisht ekzistojnë rreth 25 milionë muslimanë në Evropë, rreth 6 milionë (ndonëse disa operojnë me shifra prej 5 deri 7 milionë) në Amerikë, gjysëm milioni në Kanada, dhe mbase mbi 2 milionë në Amerikën Jugore. Për ta shqyrtuar spektrin e islamit në tërësi, do të duhej gjithashtu të merret në konsideratë komunitetet islame në Perëndim, posaçërisht ngase lozin rol tejet me rëndësi si urë lidhëse midis "Shtëpisë

së islamit" (darul-islam), prej nga kanë ardhur, dhe Perëndimit, i cili është atdheu i tyre.

Këto zona të kulturës islame, të cilat këtu janë përshkruajtur vetëm shkurtimisht, dëshmojnë për gjerdanin e jashtëzakonshëm të popujve, gjuhëve, formave artistike dhe konditave të ndryshme për jetën e njerëzve. Islami praktikohet prej xhunglave në Borneo deri në majat Hindu Kush, por edhe deri në shkretirat e Mauritanisë. Islami përfshin njerëz të racës së bardhë, zezë dhe të verdhë, dhe praktikisht përfshin edhe çdo tip ndërmjetës. Ithtarët e islamit janë flokëzinj por gjithashtu edhe flokëverdë, sy të përhimtë si dhe asosh të kaltër. Mirëpo, në kuadër të këtij varieteti të dukshëm, ekzistojnë fusha të unitetit të krijuara nga islami, unitet i cili mund të vërehet në recitimin e Kur'anit në gjuhën arabe prej Lindjes deri në Perëndim, në namazin ditor që kryhet në drejtim të Mekës, në pasimin e Sheriatit, ..., dhe në shumë faktorë të tjerë. Uniteti në islam kurrë nuk ka nënkuptuar uniformizëm dhe gjithnjë ka përfshirë dallime. Për t'u kuptuar ky unitet dhe ky dallim brenda unitetit, do të duhej kuptuar mënyrën në të cilën islami është në gjendje të përfshijë aq shumë kualitete njerëzore dhe të respektojë dhe çmojë dallimet e dhëna nga Zoti dhe njëkohësisht të krijojë një civilizim grandioz i cili është i bashkuar dhe në të cilën mbretëron principi i tevhidit...

S.N.

Përktheu: Dr.Selim Sylejmani

Editor: Zekerija Abdullahi

Copyright: © Drita e jetës-Gjilan

2.7.2004

Brzezinski: respektim të dinjitetit politik të muslimanëve

The Choice: Global Domination or Global Leadership (Zgjedhja: Dominim global ose udhëheqje globale) është titulli që mban libri i fundit i Zbigniew Brzezinski. Autori i librit është një ish-këshilltar për siguri nacionale i SHBA-ve, njeriut që tërë kohës ishte afër Jimmy Carter-it, (Xhimi Karter). Shkurt thënë njeriu që nga krejt funksionet dhe postet që kreu gjatë karrierës së tij të bujshme me siguri meriton epitetin "the man behind those who pull the strings"-njeriu pas atyre që tërheqin penjtë. Ky libër është botuar në prill të këtij viti nga Basic Books dhe nga recensionet e shumta që pati ky libër duket se do jetë literaturë kryesore në shumë qarqe por sidomos për ata që duan të dijnë për ardhmërinë e politikës së jashtme të SHBA-ve.

Nën titullin "The American Mission?" William Pfaff në prestigjiozen The New York Review of Books shkroi recensimin më të plotë dhe më të bujshëm për këtë libër. Ai aty librin e cilëson si "një turne nëpër horizonte në vitin zgjedhor i politikës së jashtme, më e sofistikuar në analiza dhe rekomandi-

me dhe në temperament më burrështetërore se shkrimet e fundit të përkrahësve të politikës së administratës të Bush-it. Është një ekspresion i nuancuar i urtësisë konvencionale ndër ekspertët amerikan për politikë të jashtme dhe një qortim për arrogancën vethumbëse të administratës të Bush-it për dy vjet e gjysëm rresht."

Përveç shpresës se dikush mund të marrë përsipër sjelljen në shqip e këtij libri, ajo që neve na shtyni të shkruajmë për librin, autorin dhe muhabetet përcjellëse ishte deklarata e fundit e Brzezinskit gjatë një interviste për VOA news. Ku ai në pyetjen e gazetarit për problemet me të cilat ballafaqohet bota sot e të cilat autori në librin e tij i emërton "Global Balkans" (Ballkani global) dhe zgjidhjen e parashtruar për to mes tjerash tha: në rend të parë me respektimin e dinjitetit politik të muslimanëve. Ngase nuk mund të silleni ndaj një religjioni, ... duke iu qasur regjionit në një stil kuazi-kolonialist pose imperialist. Na duhet patjetër të kuptojmë se ai relacion ai lloj politike i takon të kaluarës. Ajo nuk është ardhmëri."

Hasan Kahvexhi,
9.7.2004

Islami në dy tre fjalë

1. Muslimanët e adhurojnë All-llahun, i cili është një dhe i pashoq, dhe i cili i ka emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta. Kështu që qëllimet dhe aspiratat e muslimanit janë të përqëndruara te Zoti dhe Krijuesi i tij; ai i mbështetet Atij dhe prej Tij kërkon ndihmë, durim dhe përkrahje; ai beson se All-llahu është i mundshëm për të bërë çdo gjë, dhe nuk ka nevojë për grua apo djal. All-llahu i krijoi qiejt dhe tokën; Ai jep jetë dhe vdekje; Ai është Krijuesi dhe Mbajtësi prej të cilit robi kërkon furnizim. Ai është Gjithëdëgjuesi i Cili i përgjigjet lutjes së robit të Tij, dhe prej Të Cilit robi shpreson përgjigje. Ai është i Gjithëmëshirshmi dhe Falësi, të Cilit robi i drejtohet me pendim kur bën ndonjë mëkat ose kur ka mangësi në ndonjë adhurim. Ai është i Gjithëdituri dhe Gjithëshikuesi, i cili i dinë qëllimet dhe atë që e fshehin njerëzit në zemër. Robi turpërohet të bën mëkat duke e dëmtuar vetveten ose të tjerët, sepse Zoti i tij e mbikqyrë atë dhe e sheh çka vepron ai. Ai e din se All-llahu është i Urti, i cili e sheh të padukshmen, prandaj beson se ajo që All-llahu e urdhëron është në dobi të tij, edhe nëse ai nuk mund ta kuptoj urtësinë e saj.

2. Efektet e adhurimit në zemrën e muslimanit përshijnë këtë:

Namazi e mban robin në kontakt me Zotin e tij; nëse ai e bën atë me përlujtje dhe koncentrim, ai do të ndihet i qetë dhe i sigurtë, sepse ai e lut një Përkrahës të Plotëfuqishëm, që është All-llahu, qoftë i Lavdëruar dhe i Lartësuar. Për këtë shkak, Pejgamberi

i fundit, Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e kishte zakon të thoshte “të qetësohemi me namaz”. Nëse diçka e shqetësonte atë, ai do të nxitonte për tu falur. Çdo-kush që përballlet me shqetësime dhe sprova në namaz do të gjej fuqi, durim dhe ngushëllim sepse ai është duke i recituar fjalët e Zotit të vet, të cilat nuk mund të krahasohen me fjalët ngushëluese të ndonjë krijese. Nëse fjalët e një psikologu mund të ofrojnë një ngushëllim të vogël, çka mendon për fjalët e Atij i cili e ka krijuar psikologun?

Zeqati e pastron shpirtin nga kopracia dhe egoizmi, dhe i mëson njerëzit që të jenë zemërgjërë dhe tu ndihmojnë të varfërve dhe atyre që kanë nevojë. Kjo do të sjellë shpërblim të madh në Ditën e Ringjalljes, njashthu sikurse format e tjera të adhurimit. Zeqati nuk është i rëndë (ngarkesë), sikurse taksat e vendosura nga njerëzit; por është vetëm 2.5%, të cilën muslimani i sinqertë e paguan me gjithë dëshirë dhe nuk mundohet që ik prej saj, apo të pres derisa dikush ta ndjek atë.

Agjërimi do të thotë përmbajtja nga ushqimi dhe nga marrëdhëniet intime. Ai është një formë e adhurimit, dhe një mënyrë për ta shijuar urinë e atyre që janë të provuar me te. Ai poashtu na përkujton begatitë e Krijuesit, dhe sjell shpërblim shumë të madh. Haxhi është vizita e shtëpisë së shejtë të All-llahut, e cila është ndërtuar nga Ibrahim, alejhis-selam. Me kryerjen e haxhit ne e çojmë në vend urdhërin e All-llahut dhe thirjen për të ardhur dhe për ti takuar muslimanët nga e gjithë bota.

3. Islami urdhëron çdo gjë të mirë dhe ngalon nga çdo gjë e keqe. Ai nxit për sjellje të mirë dhe trajtim adekuat ndaj të tjerëve. Ai i urdhëron karakteristikat e mira si: sinqeritetin, durimin, maturinë, butësinë, përlësinë, modestinë, mbajtjen e premtiveve, dinjitetin, mëshirën, drejtësin, guximin, dashamirësin, mjaftueshmërin, pastërtinë, sjelljen e mirë, tolerancën, besnikërin, mirënjohjen ndaj dhuratave dhe vetëpërbajtjen në kohën e hidhërimit.

Islami e urdhëron muslimanin që ti përbush obligimet e veta ndaj prindërve dhe ti mban lidhjet familjare, ti ndihmon atij që ka nevojë, të jetë i mëshirshëm me të vegjëlit dhe ti respekton të moshuarit, të sillet mirë me robërit dhe kafshët, ti largon gjërat e dëmshme nga rruga, të fletë fjalë të mira, të falë në kohën kur ka mundësi të hakmeret, të jetë i sinqertë me shokët e tij musliman, t'i plotëson nevojat e muslimanëve, ti jep

borxhliut kohë për ta shpërguar borxhin e tij, t'u jep përparësi të tjerëve, ti ngushëllon të tjerët, ti përshëndes njerëzit me fytyrë të buzëqeshur, ti viziton të sëmurët, ta përkrah atë që është i shtypur, t'u jep dhurata shokëve, t'i nderon mysafirët, të sillet me gruan e tij mirë dhe të shpenzon për atë dhe për fëmijët, ta përhap selamin dhe të kërkon leje para se të hyn në shtëpinë e tjetërkujt, që të mos sheh diçka private që ai nuk don ta sheh.

Disa jobesimtarë mund ti bëjnë disa nga këto vepra nga edukata dhe sjellja e mirë, mirëpo ata nuk kërkojnë me këte shpërblimin e All-llahut dhe shpëtimin në ditën e gjykimit.

Nëse i shikojmë gjërat që Islami i ka ndaluar, do të vërejmë se kjo është në dobi të individit dhe gjithë shoqërisë. Të gjitha këto ndalesa shërbejnë që të mbrohen relacionet në mes robit dhe Zotit të vet, dhe relacionet e tij me vetveten dhe shokët e tij.

Muhammed Salih el Munexh-xhid
marrë nga: Islamway
përktheu: Omer Islami
25.6.2004

Shkëndija e udhëzimit

Unë po kthehesha prej një udhëtimi të gjatë dhe Allahu kishte caktuar që vendi im në aeroplan të ishte ngjeshur me një grup të papërgjegjshëm, të rinjsh, zëri i lartë dhe të qeshurat e të cilëve ishin shumë të larta dhe ajri ishte mbushur me re tymi nga duhani i tyre. Hiqmet i Zotit, aeroplani ishte plotë dhe unë nuk mund të ndryshoja vendin.

Unë u përpoqa të ikja nga problemi duke fjetur por ishte e pamundur...kur unë u mërzita nga zhurma e tyre unë morra mus-hafin tim dhe filova të lexoj çfarë mundesha,

nga Kur'ani, me një zë të butë. Pas pak kohe të gjithë të rinjtë filluan ta ulnin zërin. Disa prej tyre filluan të lexonin gazetatat dhe disa prej tyre ranë të flenë.

Pa pritur njëri prej tyre tha me një zë të lartë madje edhe pse ai ishte i ngjeshur me mua: "Mjaft, Mjaft".

Unë mendova se unë e kisha shqetësuar atë sepse zëri im mund të kishte qenë i lartë kështu që unë i kërkoja ndjesë atij dhe vazhdova të të lexoja me pëshpëritje të cilat vetëm unë mund t'i dëgjoja. Unë e pashë

atë duke e mbajtur kokën e tij me duart e tij, pastaj duke u përkulur në sediljen e tij, dhe duke lëvizur shumë. Pastaj ai e ngriti kokën dhe më tha me zemërim: "Të lutem, ndalu, nuk mund ta duroj".

Pastaj ai u ngrit nga sedilja e tij dhe u largua për pak kohë, pastaj u kthye më përshëndeti me selam dhe kërkoi ndjesë. Ai heshti dhe unë nuk dija se çfarë po ndodhte. Por pas njëfarë kohe ai u kthye tek unë me sytë e tij plotë me lot, dhe më tha duke pëshpëritur: "Për tre vite ose më tepër unë nuk e kam vënë ballin tim në tokë dhe as që kam lexuar ndonjë ajet! Një muaj të tërë unë e kam marrë këtë udhëtim dhe nuk ka patur të keqe të cilën nuk e kam kryer. Pastaj unë të pashë ty që po lexoje Kur'an dhe bota ime u kthye përmbys dhe zemra ime u mbush me dëshpërim. Unë u ndjeva sikurse dikush ishte duke më shtrënguar në fyt... unë ndjeva çdo ajet që ti lexove duke më ardhur mbi trupin tim si një kamxhik. I thashë vetes time; sa kohë kjo neglizhencë do të zgjasë? Ku kjo rrugë do të të çojë ty? Çfarë do të vijë pas kësaj loje të marrë? Pastaj unë shkova në banjo, a e di pse? Unë kisha një nevojë të madhe të qaja dhe unë nuk mund të gjeja asnjë vend tjetër për tu fshehur nga shikimi i njerëzve!"

Unë i fola atij në vija të përgjithshme rreth tevbës (pendimit) dhe të kthyerit tek Allahu pastaj ai heshti.

Kur aeroplani u ndal, ai më ndali dhe duke se ai donte të largohej prej shokëve të tij. Ai më pyeti me një shprehje serioze në fyty-

rën e tij: "A mendon që Allahu do ta pranojë pendimin tim? "Unë i thashë: "Nëse ti je i sinqertë dhe serioz në pendimin tënd, atëherë Allahu do të t'i falë gjynahet e tuaja".

Ai tha: "Por unë kam bërë gjëra të tmerrshme, shumë të tmerrshme".

Unë i thashë: "A nuk e ke dëgjuar se çfarë Allahu ka thënë: "Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, pse All-llahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!" [ez-Zumer 39: 53]

Unë e pashë atë duke qeshur me gëzim, me sytë e tij të mbushur me lot pastaj ai tha lamtumirën dhe u largua. SubhanAllah.

Nuk ka rëndësi sesa e madhe të jetë e keqja dhe gjynahi tek një njeri, në zemrën e tij ka një farë mirësie. Nëse ne mund të arrijmë atë dhe ta rritnim, atëherë do të jep frut, inshaAllah.

Kjo mirësie gjithmonë lufton në zemrën e njeriut madje edhe kur është e mbuluar nga dëshirat dhe epshet e zjarra. Kur Allahu dëshiron të mirën për robin e tij, Ai bën që shkëndija e udhëzimit të shëndrisë në zemrën e tij dhe ta udhëzojë atë tek rruga e atyre që janë të udhëzuar.

Allahu thotë: "Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu All-llahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë". [el-En'am 6: 153]

Ahmed Ibën Abd el-Rahman el-Suvejan

Marrë nga revista el-Bejan nr. 152, Rabiul al-Ahir, fq. 66-67

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

2.7.2004

Një miliard musliman në krah të Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem

Një organizatë e Vatikanit, kishte nisur një kampanjë me titull: "Një milion misionar kundër Muhamedit".

"Shoqata botërore për përkrahjen e vulës së pejgamberëve" me seli në Arabinë Saudite publikoi një deklaratë dhe ia nisi kampanjës me moton: "Një miliard me Pejgamberin, Muhammed".

Kampanja synon që të gjithë muslimanët të japin mundin e tyre për të sqaruar të vërtetat dhe realitetin mbi personalitetin e Pejgamberit të All-llahut. Vallë, sa musliman të sodit do të kontribuojnë në këtë kampanjë dhe sa prej tyre do ta vjelin frytin?!

.....
Më 30, Maj, 2004 gazeta gjermane Welt am Sonntag, publikoi një raport mbi një organizatë të Vatikanit, e cila kishte nisur një kampanjë me titull: "Një milion misionar kundër Muhamedit".

(<http://www.wams.de/data/2004/05/30/284942.html>)

Kjo organizatë me qendër në Vatikan, është organizatë që është themeluar mes viteve 1566- 1572, nga papa Pius. Kjo organizatë atëherë njihet me emrin "Lidhja e murgjërve", kurse tash e ka emrin "Lidhja e murgjërve për kristianizimin e popujve".

Kjo organizatë posedon buxhet vjetor që fillon nga minimumi 200 milion dollar, e që mund të arrijë deri në 500 milion dollar.

Posedon 85 mijë prift, 450 mijë organizata fetare, më shumë se një milion mësimdhënës për krishterizëm, ka 42 mijë shkolla, 1600 spitale, 6 mijë organizata ndihmëse, 780 strehimore për të sëmurët nga kanceri dhe 12 mijë shoqata humanitare dhe bamirëse anëmban botës.

Ky raport, të cilin e ka botuar kjo gazetë gjermane, ndoshta edhe nuk shpalos diçka të re, sepse këto aktivitete vazhdojnë me dekada, madje edhe me shekuj, mirëpo rëndësia e këtij raporti nxjerr në shesh urrejtjen që kanë ndaj Muhamedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Pejgamberit të Islamit, njëherëzi edhe Pejgamberi i fundit për mbarë njerëzimin, edhe pse në këtë kohë të fundit dëgjojmë për shumë konferenca dhe seminare për bashkjetesë dhe mirëkuptim, sidomos mes muslimanëve dhe të krishterëve.

Kjo kampanjë nuk është e para nga ky lloj, para disa koha Papa kërkoi nga të krishterët që të mos martohen me musliman, sepse muslimanët janë të egër kundrejt grave dhe se e krishterëja që do të martohet me muslimanin do të privohet nga të drejtat e veta! Kurse në vitin e kaluar në Amerikë u ngritën disa priftër ungjellor (fanatik të krishterë), siç është Xhimi Fallwell, Pat Robertsoni, etj, duke e njoftuar personalitetin e Muhamedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe duke e emërtuar me emërtime të ndryshme neveritëse.

Vatikani dhe organizatat që punojnë nën ëmbrellën e saj pengimin e përhapjes së Islamit dhe shëmtimin e pozitës së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e kanë përcaktuar si synim të vehtin, për realizimin e të cilit synim i kanë në shërbim të gjitha mundësitë materiale, kurse pas 11 shtatorit, shoqatat humanitare dhe bamirëse islame ballafaqohen me vështirësi prej ma të ndryshmeve, gjë e cila ua përkufizon mundësitë materiale dhe ua përkufizon hapësirën e veprimtarisë.

Shoqatat dhe organizatat islame akuzohen për përkrahje të terrorizmit dhe me këtë u ndalet veprimtaria, kurse organizatat për

kristianizim u jepet liri e gjërë në zhvillimin e aktivitetit të tyre anë e mbanë botës.

Me këtë liri, me këtë forcë njerëzore dhe me këtë shtrirje botërore, këto organizata dhe këtë pasuri, veprojnë organizatat misionare. Ky është shembulli i vetëm një organizatës.

Kurse organizatat e thirrjes islame, duhet të dihet buxheti i tyre, emri i donatorëve dhe ku janë harxhuar ato donacione. E gjithë organizata duhet të ndëshkohet nëse një punëtor i asaj organizate ka marrë pjesë në ndonjë gabim, kurse qeveritë ku gjindet ajo organizatë është përgjegjëse për te dhe duhet ta llogarit ate për punën që ban.

Pasi që Vatikani e filloi këtë kapmanjë, "Shoqata botërore për përkrahjen e vulës së pejgamberëve" me seli në Arabinë Saudite publikoi një deklaratë dhe ia nisi kampanjës së kundërt, me parollë: "Një miliard me Pejgamberin, Muhammed".

Kjo kampanjë synon që të gjith muslimanët të japin mundin e tyre për të sqaruar të vërtetat dhe realitetin mbi personalitetin e Pejgamberit të All-llahut, Muhammedit, alej-hisselam, duke i thirrur ata që të vazhdojnë në thirrjen në fenë e All-llahut, në përhapjen e Islamit në mbarë popujt. Këtë deklaratë e ka përfunduar me frazën:

Ju, një miliard muslimanët, vallë, jeni me Pejgamberin tuaj, Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem?!

Ne mendojmë se të gjith muslimanët duhet ta japin mundin e tyre për të sqaruar të vërtetat e Islamit, ta njoftojmë botën me personalitetin e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të cilin e zgjodhi All-llahu, subhanehu ve teala, që ta dërgoj për mbrarë njerëzit dhe me te ta vulos vargun e pejgamberisë.

Ne duhet të vazhdojmë në rrugën e dave-tit dhe përhapjes së kësaj feje, duke patur parasysht ajetin Kur'anor:

"E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si

mëshirë për të gjitha krijesat". (El-Enbija: 107).

Lufta kundër Islamit

Urrejtjen dhe mllëfin që kanë kundër Islamit del në shesh edhe në problemin e jugut të Sudanit. Ata këtë vend e konsiderojnë strategjik dhe konsiderojnë se nëse depërton islami me fuqi në këtë pozitë gjeografike, kjo domethënë se ka për të depërtuar në mbarë kontinentin afrikan, në burimet e Nilit dhe të liqeneve, rajon i cili konsiderohet strategjik dhe udhëkryq i Afrikës, andaj kisha ka vepruar me ngulm që të largojnë çdo gjurmë islame nga ky rajon.

Lord Katshneri, në vitin 1982 thotë:

"Ska dyshim se feja Islame është duke i prititur ngrohtë nga banorët e këtyre vendeve, e nëse forcat krishtere nuk i kapin kokat e çeshtjes së Afrikës në dorë, besoj se arabët do ta arrinë këtë gjë. Ata do të kenq pozitë qendrore në mesin e kontinentit dhe me te do të arrijnë të dëbojnë të gjitha ndikimet civilizuese në bregdet, kurse vendi do të bie në këtë skllavëri".

Kurse prifti Arshid Kunshu e sqaron këtë gjë qysh në vitin 1909 duke thënë:

"Nëse nuk i ndryshojmë këto fise të zeza në vitet e pakta të ardhshme, ata do të bëhen muhamedan, pasi që ky rajon është strategjik për qëllimet e kristianizimit...".

Pastaj thotë:

"Nëse kisha ka nevojë për vend që të strehohet, ajo është këtu për ta penguar përhapjen e Islamit dhe eliminimin e mësimëve të pejgamberit të rrejshëm".

Kjo është edhe porosia e konferencës misionare botërore në Adenbera, që është mbajtur në vitin 1910, ku mes tjerash shkruan:

"Gjëja e parë që kërkohet të bëhet, nëse mundet të përfitohet Afrika për ineteres të mesihut, të hedhet një forcë misionare e fuqishme në zemër të Afrikës për ta penguar depërtimin e Islamit".

Misionarizmi mjeti i tyre në këtë drejtim

Misionarizmi është lëvizje politike kolonizatore, e cila ka dalur në skenë pas dështimit të kryqëzatave, me qëllim për ta përhapur kristianizmin mes popujve të ndryshëm, në botën e tretë në përgjithësi dhe në mesin e muslimanëve në veçanti, që ti fusin nën sundimin e tyre.

Në këtë drejtim u ndihmon përhapja e varfërisë, injorancës dhe sëmundjeve në shumicën e vendeve islame, dominimi perendimor në shumë pushtete islame, dobësia e qeveritarëve musliman, të cilët heshtin para tyre ose u mundësojnë qëndrimin në këto pozita, me stimulime ose frikësime.

Që nga shekulli i pesëmbëdhjetë, gjatë zbulimeve portugaleze misionarët katolik kanë hyrë në Afrikë, e kurse një kohë të gjatë pas kësaj kanë filluar të depërtojnë atje misionarët protestantë, ungjëllor, gjerman e francez.

Ja disa informata që tregojnë dendshmërinë e veprimtarisë misionare:

Henri Martini (vdiq në vitin 1812) kishte rol të rëndësishëm në dërgimin e misionarëve në Asinë perendimore dhe e kishte përkthyer Tevratin në gjuhën hindu, persiane dhe ermene.

Në vitin 1795 është themeluar shoqata misionare e Londrës, që më pastaj ta pasojnë ajo e Skotlandës dhe Njujorkut.

Në vitin 1819 u morrën vesh kisha protestante me krishterët e Egjiptit për të themeluar dergesa të misionarëve dhe ata e morrën përsipër përhapjen e Ungjëllit në Afrikë.

Në vitin 1849 dërgatat e misionarëve filluan të qarkullojnë edhe në tokat e Shamit.

Në vitin 1855 u themelua shoqata e rinisë krishtere, prej anglezëve dhe amerikanëve, kurse synimi i tyre përkufizohej në futjen e mbretërisë mesihore në mesin e rinisë.

Në vitin 1895 u themelua shoqata e unionit të studentëve të krishterë në botë, e cila inretrohej për gjendjen e studentëve në të

gjitha vendet dhe vepronte në përhapjen e krishterimit mes tyre.

Samuel Zvimeri, i cili ishte kryetar i dërgatave misionare arabe në Bahrejn, ishte poashtu edhe kryetar i organizatave misionare në lindjen e mesme, ishte kryeredaktor i revistës "Bota Islame", që botohej në gjuhën angleze, të cilin e kishte filluar qysh në vitin 1911. kjo revistë akoma botohet nga Harvardi.

Dërgatat e Zvimerit dalloheshin më shumë në veprimtarinë medicinale, andaj edhe kishite hapur ambulanca dhe spitale në Bahrejn, Kuvajt, Maskat, Uman, etj.

Ky njeri konsiderohet shtylla më e lartë e misionarizmit modern, andaj në emër të tij kanë hapur edhe një institut hulumtues në Amerikë për kristianizimin e muslimanëve.

Keneth Kraxh e zëvendësoi Samuel Zvimerin në postin e kryeredaktorit të revistës "Bota Islame", një kohë ishte profesor në Universitetin amerikan në Kairo, ishte kryetar i katedrës teologjike krishtere në Harvard, i cili konsiderohet si institut i misionarëve. Prej librave të tija është edhe libri "Thirja e minares", i cili është botuar në vitin 1956.

Pengimi i unitetit mes muslimanëve është qëllim i tyre

Prifti Simon thotë:

"Uniteti islamik e grumbullon shpresën e popujve musliman dhe u ndihmon për tu çliuar nga dominanca europjane, kurse misionarizmi është element me rëndësi në thyerjen e fuqisë së kësaj lëvizjeje, andaj nëpërmjet misionarizmit duhet ta pengojmë unitetin e muslimanëve".

Lorens Brauni thotë:

"Nëse muslimanët bashkohen në një pe-randori arabe, kjo mund ti bëjë ata mallkim për mbarë botën dhe rezik, ose mund të jenë dhunti, mirëpo nëse mbeten të shpërndarë, atëherë mbeten pa peshë dhe pa ndikim".

Misionarët e kanë zakon të përhapin gënjeshtra dhe gjëra të kota në mesin e ithtarëve të tyre që ti pengojnë nga hyrja në islam dhe për ta shëmtuar bukurinë e kësaj feje.

Henri Xhezbi thotë:

"Muslimanët nuk i kuptojnë fetë, as nuk i vlerësojnë sa duhet, ata janë hajna, vrasës dhe të prapambetur, kurse misionarizmi ka të veprorë në qytetërimin e tyre".

Kurse ermeni Lutfi Lefonan, i cili ka shkruar libër kundër Islamit, thotë:

"Historia islame është një varg i trishtueshëm i gjakderdhjes, luftërave dhe masakrave".

Adisoni duke folur mbi Muhammedin, sallallahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Muhamedi nuk kishte patur mundësi ta kuptojë krishterimin, andaj ai në fantazinë e tij kishte vetëm fotografi të deformuar mbi të cilën e ndërtoi fenë e tij, të cilën e sollën arabët".

Misionari F.Xh. Harber thotë:

"Muhamedi në realitet ishte adhurues i idhujve, sepse perceptimi mbi realitetin ishte karikatorial".

Samuel Zvimeri në librin e tij "Bota Islame sot" thotë:

"Në duhet ti bindim muslimanët se të krishterët nuk janë armiqtë e tyre".

Gjithashtu thotë:

"Krishtianizimi i muslimanëve duhet të bëhet prej njerëzve të tyre dhe nga rradhët e tyre, sepse pemën duhet ta këputë dega e vet".

Koalicioni i kishes botërore dhe sionizmit

Sionizmi botëror, Vatikani dhe Këshilli botëror i kishave, e kanë zëvendësuar armikun e vjetër duke krijuar një armik të ri, që nëpërmjet tyre të realizojnë qëllimet e tyre strategjike afatshkurte dhe afatgjate. Ata dëshiruan të godasin ma shumë se një zog me një gurë në këtë formë:

- I ndezin luftat historike kundër islamit dhe muslimanëve, nëpërmjet tjerëve. Ata preferojnë të fusin individ, organizata dhe

shoqata që janë me "dekor islamik" që të shkaktajnë fitne mes muslimanëve. Pastaj nga ana tjetër kjo bëhet shkak që të ndërhyjnë perendimorët në çështjet e brendshme arabe dhe islame, i stimulojnë thirrësit e dhunës që të veprojnë kundër vatanëve të tyre, i strehojnë dhe përkujdesen për logjistikën e tyre, i fusin në tokat e tyre që të bëjnë fesad, herë herë në emër të fesës, e herë herë në emër të politikës opozitare.

- Angazhimi i arabëve në konflikte me të tjerët, duke e haruar Izraelin, e me këtë i japin mundësi Izraelit që ti arrijë qëllimet e veta në tokat arabe.

- Veprim për të dridhur sigurinë dhe rehatinë e tokave arabe, që ti thuhet botës: Izraeli është i rezikuar nga destabiliteti i fqinjëve, andaj kjo bëhet shkak për të penguar çdo tentim për marrëveshje ose zgjidhje të problemit.

- Huluntimi i fronteve të reja, pasi që janë skajësuar Egypiti, Jordani, e disa shtete arabe, në konfliktin arabo-izraelit, e me këtë rehatohet Izraeli, sepse te arabët nuk mund të kihet qëndrim unik, i cili do të ndikonte në vendimet e tyre dhe do ta turpëronte para opinionit ndërkombtar.

- Prishja e raporteve politike dhe marrëdhënieve e miqësisë mes shteteve arabe dhe islamike, duke i ngjallur projektet të cilat mbështeten në shembujt perendimor, në aspektin politik edhe shoqëror, stimulimi i institucioneve politike perendimore që të imponojnë kërkesa prej arabëve dhe muslimanëve, të cilat arrinë deri te ndërhyrja në çështje të brendshme.

- Disa ekspertë të tyre thonë: ekziston plan sekret për shndërrim të tokave të shenjta islame anë e mbanë botës në "rajone të izoluar", ku zhvillohet ritualet fetare, të udhëhiqen nga institucionet fetare, të cilat nuk kanë lidhje me politikën ndërkombëtare, përveç aspekteve që kanë të bëjnë me fenë, duke

patur si shembull në këtë Vatikanin në Itali.

- Kurse lobi grupet çifute në Amerikë kërkojnë nga administrata politike europiane dhe amerikane që të themelojnë pushtete të reja politike më të moderuara në rajonin e Gjirit Arab, për të bashkëpunuar më me shumë pozitivizëm me Amerikën dhe perendimin.

Ne asnjëher nuk duhet të harojmë ate që na ka treguar All-llahu, subhanehu ve teal, para shumë shekujsh, si këshillë dhe porosi:

"Ata duan ta shuajnë dritën e All-llahut me gojë të tyre, po All-llahu e plotëson (e përhap) dritën e vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët. Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fé të vërtetë, për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë. O ju që keni besuar, a t'ju tregoj për një tregti të bujshme që ju shpëton prej një dënimi të dhembshëm:

T'i besoni All-llahut dhe të dërguarit të Tij, të

luftoni në rrugën e All-llahut me pasurinë tuaj dhe veten tuaj, e kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse jeni që e dini". (Es-Saff: 8- 11).

Andaj në fund ne duhet të dimë se:

Cili është qëndrimi ynë përballë këtyre lëvizjeve misionare?!

Vallë, mos ishte shkaktar 11 shtatori, që Vatikani ta shpalojë fytyrën e vërtetë?!

Vallë, mos janë veprimet e dhunës ato që e stimulojnë këtë veprimtari?!

Cilat janë mjetet, sipas teje, për ta mbrojtur, ndihmuar dhe përkrahur, Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem?

(Në një artikull të publikuar më herët në Albislam ka disa mënyra për të ndihmuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: <http://albislam.com/artikuj/artikull.asp?NrArtikull=197>).

Vallë, sa musliman të sodit do të kontribuojnë në këtë kampanjë dhe sa prej tyre do ta vjelin frytin?!

Bekir Halimi,
9.7.2004

Zgjedhja e shokëve

Njerëzit gjithmonë kanë qenë krijesa shoqërore dhe të nëvojshëm për miq dhe shokë. Një pjesë e mirë e jetës sonë na kalon në bashkveprim me të tjerët. Për muslimanët sikurse jemi ne, që jetojmë në shoqëri ku jemi pakicë, çështja e zgjedhjes së shokëve të mirë është esenciale për ta ruajtur fenë tonë. Shoqërimi me muslimanët e udhëzuar dhe të moralshëm është i obligueshëm për të qëndruar në rrugën e drejtë.

Në një hadith të vërtetë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Njeriu është në fenë e shokut të vetë, andaj le të ketë kujdes me kë shoqërohet" [transmeton

Ebu Davudi dhe Tirmidhiu].

Shoqërimi i dikujt me pasuesit e çfardo rruge tjetër përpos rrugës së udhëzimit rezulton në ndryshimin e sjelljes, moralit dhe qëndrimeve të tij. Nëse ne shoqërohemi me kësi lloj shoqërie, atëherë do të trashëgojmë zakonet, sjelljet e ndoshta edhe fenë e tyre. Një musliman i tillë do ta gjen veten në një situatë ku do të jetë i gatshëm që ta fshehtë islamin e tij ose saj përpara atyre që e nënçmojnë atë dhe do të ndahet prej besimtarëve. Kur të ndodhë kjo situatë, është arritur një pikë ku ka shumë pak dallim në mes këtij muslimani dhe shokëve të tij të këqij. Shumë

herë muslimani nxitet nga shokët e tij (të këqij) që të bëjnë vepra të liga dhe ti haron obligimet e veta. Rezultati është se këtij muslimani shpesh herë i vjen turp që ti lenë ata dhe ta falë namazin, kështu që këta “shokë” bëhen shkaktarë që ky të devijon nga rruga e drejtë.

Në vend që të shoqërohemi me të devijuarit ne duhet të shoqërohemi me të udhëzuarit, mirpo përsëri të sillemi në mënyrë të mirë dhe të drejtë me të tjerët (kuptohet përderisa nuk na dëmtojnë sh.p.).

Në një hadith tjetër Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Shembulli i shokut të mirë dhe shokut të keq është si shembulli i shitësit të miskut (parfumit) dhe farkëtarit. Sa i përket shitësit të miskut ai ose do të dhurojë misk (erë të mirë), ose do të blesh prej tij, ose së paku do të kënaqesh nga era e mirë që i vjen. Sa i përket farkëtarit ai ose do ti djegë teshat ose do të marësh erë të keqe prej tij.” [Buhariu dhe Muslimi].

Gjatë komentimit të këtij hadithi Imam Neveviu, rahimehull-llahu, ka thënë se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e ka krahasu shokun e mirë me shitësin e miskut dhe ka folur për mirësinë e shoqërimit me shokë të mirë, të cilët kanë sjellje fisnike, devotshmëri dituri dhe kulturë. Të tillë janë ata prej sjelljes së të cilëve përfitojmë. Dhe ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na ka ndaluar të rrimë me ata që bëjnë keq, që bëjnë shumë mëkate dhe vepra tjera të këqija, si dhe me bidatxhit, përgojuetit, e kështu me rradhë.

Një dijetarë tjetër ka thënë: “Shoqërimi me besimtarët rezulton në arritjen e diturisë së dobishme, sjelljes fisnike dhe veprave të mira, përderisa shoqërimi me të këqijtë ndalon nga të gjitha këto.”

All-llahu, subhanehu ve teala, në Kuranin fis-

nik thotë: “Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: “I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!” O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar.” [El-Furkan: 27-29].

Ai, subhanehu ve teala, gjithashtu thotë: “Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë miq të njëritjetrit, përveç të devotshmëve.” [Ez-Zuhruf: 67].

Në dy transmetime të vërteta nga Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ne jemi urdhëruar që të shoqërohemi vetëm me besimtarët, dhe na është thënë se personi do të jetë me atë që e don (në ahiret). Kështu që nëse ne i duam dhe i shoqërojmë ata që janë të devijuar, duhet të frikësohemi për besimin tonë. Njeri i mençur është ai që bëhet gati për botën e ardhshme, jo ai që e neglizhon fenë e tij dhe bjenë në kurthën e shejtanit, i cili i thotë se do ti falen gabimet dhe se mund të bëjnë çfarë të don.

Nëse ne me të vërtetë besojmë se fjala më e mirë është fjala e All-llahut dhe se udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, atëherë ne duhet të veprojmë sipas kësaj, sepse përndryshe do të sjellim argument kundër vetvetes.

Nga ana tjetër, “besimtari është pasqyrë e vëllaut të vet”, dhe nëse ai sheh ndonjë gabim te besimtari tjetër, ai i'a tërheq vërejtjen në një mënyrë të pranueshme, i ndihmon të largohet dhe të pastrohet nga çdo e keqe që mund ta ketë.

E lusim All-llahun të na bëjë prej të udhëzuarve në rrugën e drejtë dhe të na jep shokë të cilët do të na largojnë nga zemërimi i Tij dhe do të na udhëzojnë në kënaqësinë dhe xhennetin e Tij.

Marrë nga: Islamway.com

Përkthëu: Omer Islami

Përgjegjësia e edukimit të fëmijëve

Çfarë do t'i jepni djalit tuaj në ditën e darsmës së tij për dhuratë? Një Mitsubishi apo një Honda apo do t'i jepni një rreshkë buke?

Kur djali i Ibën Kajjim-it ishte duke u martuar, ai e gjeti veten në një dilemë në lidhje me këtë dhuratë. Ai mendoi dhe mendoi dhe vendosi t'i bënte një dhuratë që nuk do të kishte dobi vetëm ai prej saj por të gjithë muslimanët. Ai ndezi qirium, ngjeu pendën e tij të famshme dhe filloi të shkruante. Dhurata? Një libër dedikuar djalit të tij dhe nuses së djalit, rreth martesës dhe të drejtave të fëmijëve. Ai e titulloi librin Tuhfetul Vedud bi Ahkam el-Mevlud. Kostoja e dhuratës? Pa vlerë në para.

Vëllezër dhe motra!

Shumë kohë ne dëgjojmë rreth respektit ndaj prindërve, sepse janë shpesh mu prindërit ata që flasin. Sa herë dëgjojmë të flitet për të drejtat e fëmijëve? Me të vërtetë ata kanë shumë të drejta, e që janë prej para 9 muajshit të krijimit të tyre — ata kanë të drejtën e dhënë nga Zoti, që nëna dhe babai i ardhshëm të zgjedh një partner që do t'i mësojë atyre rreth Allahut dhe të jetë një shembull i shkëlqyeshëm për ata.

Ibën Kajjim ka një kapitull në këtë librin që ai shkroi për djalit të tij: "Kapitulli i 25 – Për obligimin e mësimit të fëmijëve, disiplinimin e tyre dhe të qenurit i drejtë ndërmjet tyre.

Një nga të drejtat që ne dëshirojmë të flasim sot është e drejta e fëmijëve tanë për një edukim islam.

Allahu, subhanehu ve teala, na urdhëron

neve: "O ju që besuat, ruane veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin melekë të rreptë e të ashpër, që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar". [et-Tahrim, 66: 6]

Ne jemi të urdhëruar nga Allahu teala për të shpëtuar vetet tona nga Xhehen-nemi. Por nuk mbaron aty. Urdhëri zgjerohet tek familja jonë, ne duhet t'i shpëtojmë ata gjithashtu — duke përdorur të gjitha mundësitë tona — ne duhet t'i shpëtojmë ata nga flaka e Xhehenemit. Dhe arma më e madhe që ne kemi për t'i mbrojtur ata është dija të cilën Allahu dhe i dërguari i Tij, salallahu alejhi ve sel-lem, kërkon nga ata. Sepse me të vërtetë njeriu është armik i asaj që nuk njeh.

Në një ajet tjetër ne shohim: "E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti (dije), atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të keshë mirëkuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni punuar". [Llukman 31: 15]

Analizojeni sesi Allahu teala e përmend shirkun për në të cilin thirret fëmija si diçka që ai "nuk ka kurrfarë fakti ("nuk ka kurrfarë fakti (dije)" sepse nuk mund të ketë dije (fakt) për diçka që nuk është e vërtetë dhe nuk ekziston.

Dhe ende në një tjetër ngjarje, Allahu tealla e përshkruan diskutimin midis Nuhut dhe djalit të tij: "Ajo lundron me ta nëpër valë si kodra, e Nuhu e thirri djalin e vet, që ishte në një vend të ndarë: "O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bë me mohuesit!" Ai (djali) tha: "Unë do të ngjitëm në një kodër që do të më mbrojë nga uji (vërshimi)!" Tha: "nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të All-llahut, pos atë që Ai e ka mëshruar! "Vala hyri mes tyre të dyve, e ai (djali) u mbyt në ujë". [Hud 11: 42-43]

Thueth se rreth 90% të asaj që mëson fëmija, është ajo të cilën ai e mëson brenda 1 deri 5 vitet e para jetës së tij apo të saj. Fëmijët në atë moshë të pafajshme janë aq të përkushtuar t'i kënaqin të rriturit në jetët e tyre veçanërisht ata që i shikon ditë për ditë. SubhanAllah, është një aftësi që Allahu tealla e ka krijuar tek njerëzit. Sepse nëse ata nuk do të kishin këtë dëshirë për të kënaqur "mësuesin" ata nuk do të kishin një zhvillim intelektual në jetën e tyre.

Nëse do të shkonit tek një shkollë publike, imagjinoni më përpara kopshtin e fëmijëve ose klasën e parë dhe sesi ju vepronit me mësuesen tuaj. A nuk përpiqeshit ju ta kënaqnit atë në çdo moment që ju do tu jepej mundësia? A do të bënit gjëra vetëm për të fituar kënaqësinë e saj?

Histori e tmerrshme ndodh kur një fëmijë është vendosur nën kujdesin e një jo-muslimani, nën kujdesin e dikujt që nuk di asgjë rreth obligimit tonë ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij, dikënd të cilin fëmijët musliman janë të padëshirueshëm për ta kënaqur.

Një herë ishte një vajzë e vogël në një shkollë publike në një vend musliman mësuesja e së cilës nuk e praktikonte islamin. Vajza e vogël duke ndjekur shembullin e nënës së saj do të shkonte në shkollë me hixhabin islam. Hixhabi megjithatë ishte diçka

që nuk pëlqej nga mësuesja e saj, SubhanaAllah, kështu ajo i tha vajzës ta hiqte ate dhe të mos guxonte të kthehej në shkollë me të, të nesërmen përndryshe ajo do të vuante pasojat.

Vajza u kthye nga shkolla dhe i tregoi nënës së saj sesi mësuesja nuk donte që ajo të vishte hixhabin në shkollë dhe se ajo vet nuk dëshironte të mos i bindej mësueses së saj. Nëna e saj me qetësi i tha: "Kë dëshiron të kënaqësh atëhere, mësuesen tënde apo Allahun?" Vajza e vogël e shikoj në sy dhe tha: "Allahun!"

Ditën tjetër vajza e vogël u kthye me hixhabin në kokë. Kur mësuesja e pa atë, shpërtheu me qortimet: "Si guxon të mos më bindesh mua!"

Fjalët të dhimbshme filluan të dilnin dhe dilnin nga goja e mësueses derisa vajza uli kokën e saj, duke menduar. Pastaj ia ktheu: "Unë nuk e kuptoi, cilin jam e supozuar të kënaq – ty apo Atë?"

"Atë kë?" pyeti mësuesja.

"Allahun!"

Sytë e saj u zgjeruan dhe një frikë hyri përmes saj. Mësuesja pushoi së foluri. Nga prapa të qarave të saj vajza e vogël tha: "Jo, unë do të kënaq Allahun dhe vetëm Allahun, dhe le të ndodh ç'ka të ndodh".

Atë ditë mësuesja i dërgoi një letër në shtëpinë e vajzës së vogël drejtuar nënës së vajzës me fjalët: "Sot fëmija yt me tregoi mua kush isha unë dhe kush me të vërtetë është Allahu. Ju faleminderit për edukimin e një vajze të të tillë, të bekuar".

Këto kanale televizive dhe shkolla publike sot janë duke u përhapur një helm të shkatërrueshëm që ec përmes gjakut të rinisë sonë.

El-Hasan Ibën Ali, radijallahu anhu, thoshte shpesh: "Edukoni veten tuaj sot, sepse sot ju jeni të rinjtë e shoqërisë, e nesër ju do të plakeni".

Elhamdulillah, Unë kam takuar shumë të rritur të zgjuar në udhëtimet e mija në haxh. Kur unë uleshë me këto vëllezër dhe u mrekullohesha me intelektin e tyre, unë çuditësha me veten: "Ifarë ky person do të bëjë për islamit dhe komunitetin musliman nëse prindërit e tij do ta kishin edukuar atë rreth fesë islame?"

Të dashur vëllezër dhe motra, ne kemi këtu një nxënës në klasën e tretë i cili di më shumë se 7 xhuz të Kur'anit. Ai është 8 vjeç. Unë e di që nuk mund të gabohem nëse them që ai di më tepër Kur'an sesa 95% e të rriturve pjesmarrës në këtë hutbe. Ai është 8 vjeç. Unë kam parë studentë aq të zgjuar sa ky që hidhen në shkolla publike – zgjuarsia e tyre zgjerohet mbi majat e piramidave ndërsa ata nuk mund të shqiptojnë gërmat e gjuhës së tyre amtare.

Jahja Ibën Humejd ka thënë: "Ne shkuam tek Imam Hammed Ibën Selame njëherë dhe e gjetëm atë duke ndenjur me fëmijë duke i transmetuar hadithe atyre. Kur ai mbaroi dhe fëmijët ikën, ne i afroam atij dhe i thamë: "... ne jemi pleqtë e fisit tënd e të cilët kemi ardhur për të mësuar nga ti. Pse ti na lë ne dhe i kthehesh këtyre fëmijëve?" Ai u përgjigj: "Unë njëherë pashë një ëndërr se si unë isha i ulur buzë lumit, duke mbajtur një kovë me ujë për të pirë. Pasi piva ujë, unë ktheva mripa dhe pashë këta fëmijët atje dhe kështu i dhashë atyre kovën e ujit pas meje". (Ibën Ebi ed-Dunja)

Said Ibën Rahmah el-Asbahi i ka treguar studentëve të tij: "Unë do të vendosja një tentë jashtë xhamisë me shpresë që do të zija vendin më të mirë në halkat (bisedat apo ligjëratat) e Abdullah Ibën Mubarak. Unë kisha shokë të moshës sime por asnjëri prej tyre nuk vepronte ashtu siç veproja unë. Kur koha për halka (ligjërata) vinte, Ibën el-Mubarak do të vinte dhe me të do të vinin

edhe pleqtë. Ata iu ankuan atij: "Këto fëmijë na e kanë kaluar ne në halka (në mësimet e tuaja), nuk ka vend të afërt për ne tek tij". Ibën el-Mubarak iu është përgjigjur: "Këto fëmijë janë më të dashur për mua sesa ju. Ju – sa gjatë do të jetoni? Këto fëmijë ndoshta Allahu do t'i çojë shumë larg". Saidi atëhere u thonte nxënësve të tij: "Sot nuk është askush gjallë nga ajo halka-ja (rrethi i ligjëratave) të Ibën Mubarak përveç meje".

Kur fëmijët bëjnë eksperimentet në shkollë ka një instrument që ata përdorin, ai është termostati. Kjo është një vegël që reflekton atë nxehtësi që vejn nga një objekt apo zonë.

Kur ne shikojmë ummetin musliman ne do të shohim se si komunitetet tona nuk janë asgjë veçse termostate. Kur ka nxehtësi që vjen nga Bosnja regjistron një reagim në namazin tonë, duatë tona dhe librat tonë. Dhe kur ka nxehtësi në Çeçeni regjistron një reagim në namazin tonë, në duatë tona dhe në librat tonë. por kjo është një vepër e termostatit. Çfarë ne duhet të kemi janë kondicionerat, t'i ftohim gjërat kur ato bëhen shumë të nxehta dhe t'i nxehim gjërat kur ato janë shumë të ftohta.

Sot secili është duke parë vëllezërit dhe motrat tona në Palestinë dhe është duke shkukur flokët e tyre sepse ata nuk mund të bëjnë asgjë. Të dashur vëllezër dhe motra, mos lejoni gjërat që nuk mund t'i ndalni t'ju frenojnë ju nga të kryerit të atyre gjërave që ju mund të kryeni.

Vallahi, ajo që kam për qëllim me terma afatgjatë janë këta fëmijët tanë. Nëse ne nuk qëndrojmë në sfidën për edukimin e tyre në islam dhe duke i rritur ata në më të mirën mënyrë që ne mundemi, ne – me duart tona – jemi duke paralizuar të ardhmen e islamit në këtë vend.

"Të gjithë ju jeni barinj dhe të gjithë ju do të përgjegji për tufën tuaj"

Por kurrë mos mendoni që puna që ju bëni për përmirësimin e fëmijëve tuaj në edukimin islam mund të shkojë kot.

farë është për mua, ne gjithmonë pyesim. Shumë begati...

Së pari: Allahu teala do të mbrojë fëmijët tanë për shkak të devotshmërisë sonë.

Shembulli i dhënë për ne në Kur'an është ndërtimi i murit pa asnjë kompesim, ai i tha Musait pse-në: "Përsa i përket murit, ai ishte i dy djelmohave jetimë të atij qyteti, e nën të ata kishin një thesar (ari) dhe babai i tyre ka qenë njeri i mirë, e Zoti yt dëshiroi që ata dy (jetimë) ta arrijnë pjekurinë e vet dhe ta nxjerrin ata vetë thesarin e tyre. Kjo ishte mëshërë e Zotit tënd (ndaj tyre). Dhe unë nuk e pranova tërë atë sipas bindjes si-

me (po sipas udhëzimit të Zotit). Ky, pra, është sqarim i asaj për të cilën nuk munde të kesh durim!". [el-Kehf 18: 82]

Së dyti: Me edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve musliman ju do të plotësoni amanetin që Allahu ka vendosur mbi ju. Dhe në plotësimin e amanetit – besimit mbështetet sukcesi dhe planifikimi për në Xhennet.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "...ata të cilët me kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë, dhe ata të cilët i kushtojnë kujdes kohës së namazit të tyre. Të tillët janë mu ata trashëgimtarët, të cilët e trashëgojnë Firdevsin dhe aty ata janë përgjithmonë". [el-Muminun 23: 1-11]

Muhammed Sherif
Marrë nga: islaam.net
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
25.6.2004

Morali i shoqërisë muslimane

- I -

O ju musliman! Ju porosis ju dhe vetveten që të jemi të devotshëm, sepse devotshmëria është shkak i çdo lumturie dhe sukcesi dhe rruga e çdo fitoreje dhe shpëtimi.

Musliman të nderuar!

Muslimanët janë të përballuar me valët e fitnes në çdo aspekt, i rrethkojnë shkaqet e përçarjes, të këqijave dhe sprovave. Armiqët veprojnë për të përçarë rradhët e tyre, japin kontributin për të mbjellur farën e armiqësisë në mesin e muslimanëve, gëzohen kur shkëputen rradhët e muslimanëve dhe përçahet fjala e tyre, janë të lumtur kur përha-

pin shpirtin e urrejtjes në shoqërinë e tyre dhe kur fusin mllëfin në mesin e rinisë së tyre. Andaj muslimanët kanë shumë nevojë që të kapen për metodën e cila ua pastron zemrat, ua rehaton gjoksën dhe nëpërmjet tyre përhapen principet e dashurisë dhe pajtimit në shoqërinë e tyre.

Muslimanët sot kanë nevojë për të rilexuar metodologjinë e shkollës së madhe të moralit. Ata kanë nevojë të madhe për të realizuar shkollën e rregullave të vlerave të larta. Shkollë e cila përmban principet e mëdha të dashurisë dhe pajtimit dhe bazat e mëdha të veçorive fisnike. Është metodologji e shko-

llës islame, e cila kujdeset që të themelon shkaqet e dashurisë mes muslimanëve, mbjellë rregullat e vëllezërisë dhe afërsisë mes besimtarëve. Zoti ynë, tebareke ve teala, thotë:

"S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, ...". (El-Huxhurat: 10).

Kurse, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ju robër të All-llahut bëhuni vëllezër". (Buhariu dhe Muslimi).

Këto principe fisnike dhe këto vlera të mëdha e dërgojnë ummetin në çdo të mirë dhe ua realizon çdo dobi. Principe që janë baza e përqendrimit të shoqërisë, lumturisë së jetës dhe realizimit të interesit të tyre. Andaj njerëzit e urtë kanë thënë:

"Të gjithë popujt që duhet, kujdesen për njëri tjetrin, e kur kujdesen për njëri tjetrin bashkëpunojnë, e kur bashkëpunojnë veprojnë, e kur veprojnë ndërtojnë, e kur ndërtojnë jetojnë gjatë dhe u jepet bereqeti.

Për këtë në kohën më të mirë dhe shtetin më të mirë, All-llahu, subhanehu ve teala, flet për çeshtjen e ensarëve me muhaxhirët:

"Edhe ata që përgatitën vendin (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për te, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar". (El-Hashr: 9).

Nga kjo pikënisje, Pejgamberi ynë, Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u drejtoi porosi të përhershme këtij ummeti duke u thënë:

"Mos keni zili mes jush, mos urreni njëri tjetrin dhe mos u largoni njëri nga tjetri, e bëhuni, ju robërit e All-llahut, vëllezër. Muslimani është vëlla i muslimanit: nuk i ban padrejtësi, nuk e tradhton dhe nuk e nënçmon.

Secilit muslimani i ndalohet ta përdhos: gjakun, pasurinë dhe nderin e muslimanit". (Buhariu dhe Muslimi).

Ummeti islam!

Nën hijen e kësaj metode të madhe duhet të jetojë muslimani në shoqërinë e tij, sipas tij e zhvillon jetesën dhe aktivitetin, i lidhur me vëllezërit e tij, që është lidhja më e madhe. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Besimtari për besimtarin është si ndërtesa: e forcon njëri tjetrin; e i shtërngoi gishtërat njëri me tjetrin". (Buhariu dhe Muslimi).

Vëllezër musliman!

Nën hijen e zotëriut të njerëzimit dhe njeriut më të mirë, duhet të jetojë individ musliman, i cilësuar me cilësi të larta dhe i stolitur me domethënie madhore, bazë dhe princip i të cilit është të jetojë në shoqërinë e tij muslimane dashamir i vëllezërve të tij musliman dhe duke ua urrejtur atyre çdo gjë që ia urren vetvetes. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Askush prej jush nuk beson përderisa nuk ia don vëllaut të vet atë që ia do vetvetes". (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke i dhënë ummetit të vet deklarat të përhershëm thotë:

"Këtij ummeti tuaj i është bërë shëndeti në fillimin e vet, kurse pjesa e fundit e këtij ummeti do të goditet me sprova dhe gjëra që do ti mohoni. Do tu vijnë fitnet e do ta copëtojnë njëra tjetrën. Do tu vinë fitnet, e do të thotë besimtari: ky është shkatërrimi im, e pastaj do të largohet kjo fitne. Do ti vjen fitneja tjetër e do të thotë besimtari: kjo është ajo. Ai që dëshiron të hyjë në xhennet dhe të shpëtojë nga zjari, le ti vijë cdekja duke i besuar All-llahut dhe Ditës së Mbramë dhe le tu ban njerëzve atë që të tjerët dëshiron tia bëjnë atij". (Buhariu dhe Muslimi).

Një rregull peygamberik, i cili i përmban të gjitha domethëniet e të mirës, principet e pastërta dhe moralin fisnik. Një rregull, të cilin e jep njeriu me moral më të mirë, bamirësi më i madh dhe njeriu me vlerë më të madhe. Ky rregull i cili i përballon sfidat e çdo kohe dhe gjendjeje, kërkon që të cilësohemi me domethëniet e afërsisë, vëllezërisë, butësisë, mëshirës, ngrohtësisë, sjelljes së mirë, altruizmit, solidaritetit, largimit të vështirësive dhe kryerjes së nevojave. Për këto domethënie fisnike dhe vlera të larta Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke cilësuar gjendjen se si duhet të jetë shoqëria, thotë:

"Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirimin, solidaritetin mes tyre janë sikur shembulli i një trupit. Nëse i ankohet një gjymtyrë, i tërë trupi ankohet nga pagjumsia dhe temperatura". (Buhariu dhe Muslimi).

Gjithashtu Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili është i mëshirshmi dhe i butë, thotë:

"Ai që vepron për t'ia kryer nevojat vëllaut të vet, All-llahu është në ndihmën e tij, ai që ia zbulon një muslimanit një brengë, All-llahu ia zbulon një brengë të ahiretit, ai që ia mbulon muslimanit një të metë, All-llahu e mbulon në dynja dhe ahiret". (Buhariu dhe Muslimi).

Rregull peygamberik shumë i madh kërkon që të largohemi nga zilia dhe urretja reciproke në shoqëritë e muslimanëve, shkakton ndalimin e dëmtimit dhe pengimit të besimtarëve. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtarët, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me një mëkat shumë të madh". (El-Ahzab: 58).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Mos keni zili mes jush, mos ia shtoni çmi-

min gjatë shitblerjes njëri tjetrit, mos u largoni nga njëri tjetri, mos të ndërhyj dikush në shitblerjen e tjetrit. Bëhuni ju robërit e All-llahut vëllezër. Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i ban padrejtësi, nuk e tradhton dhe nuk e nënçmon. I mjafton e keqe një njeriu ta nënçmon vëllaun e tij musliman. Secilit musliman i ndalohet ta përdhos: gjakun, pasurinë dhe nderin e muslimanit". (Muslimi).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke vënduar rregull në shoqërinë muslimane thotë:

"Mos i ban dam as vetes e as tjetërkujt". (Hasen, Ahmedi dhe të tjerët).

Musliman të nderuar!

Këto janë premisat tona islame, rregullat e ndërtimit të shoqërisë muslimane. Rregulla që luftojnë prishjen e sigurisë, kundërshtojnë dëmtimin e vendit dhe njerëzve, pengon prishjen dhe çorodinë.

Andaj secili musliman le të kapet për këto domethënie fisnike, për këto udhëzime të ndershme, që të jetojë në shoqëri si njeri që dashuron dhe e dojnë, që mëshiron dhe mëshirohet. Vetëm në këtë rast do të jetojë jetesë të këndshme dhe dakorde. Zoti ynë, All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Besimtarët dhe besimtarët janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë". (Et-Teube: 71).

Kurse Pejgamberi ynë, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Nuk do të hyni në xhennet derisa nuk besoni. Nuk do të besoni derisa nuk duheni mes vehte. A tju tregoj diçka që nëse e veproni do të duheni mes vehte?! Përhapne selamin mes jush". (Muslimi).

All-llahu na dhashtë bereqet në Kur'anin fisnik, na baftë dobi nga sunneti dhe sqarimi. E them këtë fjalë dhe kërkoj falje nga All-llahu për ju, për mua dhe për mbarë muslimanët nga çdo mëkat, andaj edhe ju kërkon falje prej Tij, sepse ai është Falës dhe i Mëshirshëm.

- II -

E falënderojmë All-llahun, i cili është Mik i të mirëve. Dëshmoj se ska hyjni tjetër përveç All-llahut, i cili është Një dhe pa ortak, i cili është Zoti i mbarë botërave. Dëshmoj se zotëriu dhe pejgamberi ynë, Muhammedi, është i dërguar dhe rob i All-llahut, është zotëriu i pejgamberëve të dërguar. All-llahu ynë bekoje dhe përshëndete ate, familjen dhe mbarë shokët e tij.

O ju besimtar ju porosis ju dhe vehten time që të jemi të devotshëm, sepse kjo është porosia e All-llahu që ua ka dhënë njerëzve të parë dhe të fundit.

Robër të All-llahut!

Armiqtë e kësaj feje nuk lodhen duke bërë feshad në mesin e muslimanëve, ata vazhdimisht veprojnë që të mbjellin shpirtin e urrejtjes mes muslimanëve dhe të mbjellin farën e përçarjes mes besimtarëve.

Andaj muslimanët e kanë obligim kudo që janë, pasi qëIslami ua ka sqaruar rrugët e të mirave dhe shkaqet e shpëtimit, të përqëndrojnë në porositë e kësaj feje, sikur kodrat e mëdha dhe tia bëjnë vetvetes obligim që të kapen për ato udhëzime të bekuara.

Muslimanët jetojnë në dhunti të mëdhaja dhe të mira të qarta, për këtë edhe ua kanë zili shumë armiqtë të islamit dhe muslimanëve, për këtë muslimanët kudo që janë duhet të bashkohen në sunnet dhe udhëzim, të bashkëpunojnë në të mirë dhe devotshmëri. Të gjithë muslimanët duhet të jenë një dorë me përgjegjësit dhe dijetarët për të realizuar përfitime të mira dhe interese të shpresuara dhe të gjithë duhet të kujdesen nga shkaqet e përçarjes, hidhërimit, ndarjes dhe dobësimit, me qëllim që njerëzit ta kenë të ruajtur edhe fenë edhe dynjanë, të jetojnë në rehati, siguri, komoditet dhe mirëqenje.

All-llahu, subhanehu ve teala, na ka urdhëruar me një gjë të madhe, e cila na e pastron jetën dhe na e bën të lumtur ahiretin, e ajo është dërgimi i salavateve dhe selameve mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem...

Husjen Alu Shejh

Imam dhe hatib në xhaminë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Hutbe e mbajtur me 23/4/1425

Marrë nga: alminbar.net

Përktheu: Bekir Halimi

2.7.2004

Mëkatet gjatë verës

Të nderuar vëllezër musliman!

Jemi në fillimin e pushimeve verore, përjetojmë temperatura të larta, jemi në pushimet verore dhe në vend se ti shfrytëzojmë këto pushime dhe kohëra për t'u afruar më shumë All-llahut, ne me disa veprime që i bëjmë gjatë këtyre ditëve, më tepër largohemi nga All-llahu.

Ne, duke tentuar të freskohemi në këtë kohë me temperaturë të madhe, e fitojmë denimin e All-llahut me zjar të xhehenemit, që është shumë më i madh se sa kjo temperaturë.

Ne, në vend se ta shfrytëzojmë këtë kohë të lirë të pushimeve, për projekte më të mëdhaja dhe më të gjalla, ne e humbim kohën kot në vepra të padobishme, ose në vepra që sjellin fatkeqësi për mbarë popullin tonë.

Ne, e kemi obligim të flasim dhe ti shpallim këto anomali, me qëllim të shërimit të tyre, nëse dëshirojmë të shpëtojmë të gjithë ne nga denimi i All-llahut, i cili i kaplon që të gjithë, edhe ata që i zbatojnë mësimet dhe këshillat e Zotit edhe ata që bëjnë mëkate, nëse këta të parët nuk urdhërojnë në të mirë dhe nuk ndalojnë nga e keqeje.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka mësuar dhe na ka thënë:

"Pasha Ate, në Dorë të të Cilit është shpirti im, ose do të urdhëroni në të mirë ose do të ndaloni nga e keqeje ose së shpejti do t'ju kaplojë denimi i All-llahut, e pastaj do të luteni, mirëpo lutja e juaj nuk do të pranohet". (Hasen, Tirmidhiu).

Andaj, ne të gjithë, e kemi obligim që dukuritë negative që përhapen në shoqëri ti parandalojmë, se përndryshe të gjithë ne do të fundosemi në detin e mosbesimit, imoralitetit, dekadencës, paarsimit, dembelisë dhe përtacisë.

Prej dukurive që paraqiten gjatë pushimeve verore janë këto:

1- Lakuriqësia

Me arsyetim se është nxehtë, se duhet të freskohemi, të shumta janë ato muslimane që çveshen dhe dalin lakuriq.

Islami i ka mësuar muslimanët që mos të dalin lakuriq, sepse lakuriqësia është shenjë e primitivizmit, kurse mbulesa është shenjë e përparimit.

Pastaj lakuriqësia është shkas i dobësisë së nderit dhe moralit në mesin e të rinjve dhe të rejave dhe shkak që sjell prostitucionin në mesin tonë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Dy kategori njerëzish prej banorëve të xhehenemit nuk i kam parë: njerëz që në duar e tyre kanë shkopinjë si bishtat e lopës, me të cilat i rrahin njerëzit dhe gratë e veshura, mirëpo të çveshura, që lëkundën dhe dridhen, i kanë kokat sikur shpinda e deveve, ata nuk hynë në xhennet, as që do të nuhasin aromën e xhennetit, edhe pse aroma e xhennetit ndihet nga një largësi shumë e madhe". (Muslimi).

2- Përzjerja e burrave dhe grave

Kjo dukuri fatkeqësisht në shumë mese muslimane është ëbërë dukuri normale, saqë edhe nëpër pllazha të ndryshme, rrinë bash burra dhe gra, duke iu çbeshur njëri tjetrit. Duke e shpalosur turpin e vet secili para tjetrit.

Imam Aliu, radijall-llahu anhu, ka thënë:

"A nuk keni turp ose xhelozë. Kam dëgjuar se gratë tuaja dalin në tregje dhe shtyhen me burrat kafira". (Zevaid Musned, 1/ 133).

3- Shikimi pa kontrollë

Pasi që disa gra xhveshen, burrave, në mungesë të besimit të fortë dhe zbatimit të mësimave Kur'anore, nuk u mbetet asgjë përveç se të hapin sytë dhe të shikojnë atë

që u del para, ose edhe të hulumtojnë që të shohin gjëra sa më joshëse dhe tërëhjekëse.

All-llahu, subhanehu ve teal, na mëson dhe na thotë:

"Nuk është për ju ndonjë mëkat, nëse hyni në shtëpi të pabanuara, e që në to keni ndonjë përfitim. All-llahu e di atë që e shfaqni haptas dhe atë që e mbani fshehtë. Thuajni besimtarëve të ndalin shikimet (prej haremit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata". (En- Nur: 29- 30).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë Aliut, radijall-llahu anhu:

"Ali, mos përcjell shikimin me shikim, sepse e para është për ty, kurs e dyta kundër teje". (hasen, Ahmedi dhe të tjerët).

Ibën Kajjimi, rahimehull-llah, thotë: "Momentet (e shikimit) janë prijësit dhe të dërguarit e epshit, nëse i ruan ato e ruan edhe organin, sepse ai që shikon pa kontrollë, shikimi i tij e shpjen në shkatërrim". (Xhevabul-Kafi, fq. 106).

4- Mëkatet që paraqiten nëpër dasma dhe ahengje.

- Konsumim i alkoolit:

Fatkeqësisht, të rralla janë ato dasma në mesin e muslimanëve të vendeve tona, ku nuk përdoret alkooli. Dikund e fusin në mënyrë ilegale e dikund në mënyrë legale. Edhe pse futja në mënyrë legale dita ditës po bëhet më i zëshëm.

Kurse All-llahu, subhanehu ve teal, na ka treguar në Kur'an se alkooli sjell probleme në shoqërinë muslimane:

"O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqtë mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t'ju

largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?". (el-Maide: 90- 91).

Andaj shumë herë në dasmat tona nga ndikimi i alkoolit vjen edhe rrahja ose vrasja, Zoti na ruajtë.

- Harxhimi i tepruar:

Dasmat e sodit nuk bahen për gëzimin e familjes por për inatin e rrethit dhe fqinjëve. Andaj në rrethet tona bëhen dasma që kushtojnë me mijëra euro, që padyshim është tejkalim i çdo mestares dhe normales në harxhim.

E nëse po të njejtive u kërkon ndonjë ndihmë për shkollimin e ndonjë studenti, ose ndërtimin e ndonjë xhamie, ose organizmin e ndonjë kampingu, ose përgaditjen e ndonjë tribune, i gjen se nuk janë të gatshëm të japin as një përqind të asaj që kanë harxhuar në dasma dhe ahengje të tilla.

All-llahu, subhanehu ve teal, na mëson që mos të harxhojmë pa masë, por të jemi mesatar duke i përshkruar robërit e tij se janë:

"Edhe ata që kur shpenzojnë nuk e tepronë e as nuk janë dorështrënguar, por mbajnë mesataren e janë të matur". (El-Furkan: 67).

Sufjani ka thënë: "Çdo gjë që harxhohet në vepra që nuk janë adhurime, ajo është harxhim i tepruar, edhe në qoftëse është pak".

- Muzika, prania e këngëtarëve dhe këngëtareve dhe vallzimi burra e gra:

Ky mëkat, fatkeqësisht, është bërë fenomen i pandarë nga dasmat tona.

All-llahu, subhanehu ve teal, i drejtohet shejtanit duke i thënë:

"Dhe me atë alarmin e zërit tënd, mashtrroje atë që mundesh prej tyre, me kalorësit e këmbësorët tu thirri (bërtitu) ata, përzieju me ta në pasuri dhe në fëmijë dhe premtuju atyre, po shejtani nuk u premtton tjetër, përveç mashtrim". (El-Isra: 64).

Dijetarët kanë thënë se kjo është muzika.

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Do të ketë në ummetin tim njerëz që e konsiderojnë të lejuar zinanë, mëndafshin, alkoolin dhe instrumentet muzikore". (Buhariu).

- Mosthirrja e të varfurve nëpër dasma dhe gosti:

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Sa ushqim i keq është ushqimi i dasmave ku thirren të pasurit dhe injorohen të varfurit, kurse ai që nuk i përgjigjet thirrjes ai ka bërë mëkat ndaj All-llahut dhe Pejgamberit". (Muslimi).

- Fotografimi nëpër dasma sidomos në mesin e grave:

Kjo pa dyshim se sjell shumë probleme në mesin e muslimanëve, sepse ato mund të kapen në situata të palakmueshme, e të bëhen objekt i ngacmimit të epshit ose talljes.

E kjo mund të shkatërojë probleme shumë të mëdha në familjet e muslimanëve, siç është xhelozia, rrahja, ndarja, akuzimi për jonderë, etj.

5- Shkuarja në plazhë

Dita ditës shkuarja në pushimet verore, shkuarja në plazhë është duke u bërë pjesë normale në planfikimet tona. Kjo nuk ka qenë e njohur në mesin e muslimanëve tanë, mirëpo ja, fatkeqësisht, nga ndikimi i kulturës së perendimit dhe imitimit tonë të verbër, kemi ardhur edhe ne në atë gradë që të pasojmë zakonet dhe adetet e jomuslimanëve.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka mësuar që mos të shpalosim trupin dhe nderin tonë, duke thënë:

"Mos të shikon burri pjesët e turpshme (avretin) të burrit, e as gruaja pjesët e turpshme të gruas. Mos të flejë burri me burrin nën një mbulesë e as gruaja me gruan nën një mbulesë". (Muslimi).

6- Udhëtimi në vende të ndryshme për të bërë imoralitet

All-llahu, subhanehu ve teala, na ka thënë:

"Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë),

sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe". (El-Isra: 32).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka thënë:

"Kush më garanton atë që ka mes nofullave dhe atë që ka mes këmbëve i garantoj xhennetin". (Buhariu).

7- Moskujdesi për namazin, e sidomos për namazin e sabahut

Nga shkakut i ndejave të gjata gjatë natës, nga shkakut i habitës në argëtime na kalojnë namazet dhe i harojmë ato.

Andaj, All-llahu, subhanehu ve teala, na kërcënohet duke na thënë:

"Pra shkatërrim është për ata që falen, Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesishëm". (El-Maun: 4- 5).

Ibën Kethiri, rahimehull-llah, thotë: "Ose duke e vonuar nga koha e parë, ashtu që përherë ose zakonisht e vonojnë nga koha e vet, ose nuk e kryejnë si duhet, me kushtet dhe ruknet e urdhëruara, ose nuk kanë përvulje dhe koncentrim".

Andaj nëse vonimi i namazit e ka këtë kërcënim, çka të themi për ate që e lenë krejtësisht namazin?!

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Mos i bën All-llahut ortak, edhe nëse coptohesh ose digjesh, mos e len namazin obligativ, sepse ai që e le namazin me qëllim ka humbur garancën e Zotit, mos konsumo alkool, sepse është çelësi i çdo të keqeje..". (Sahih, ibën Maxheja).

Normalisht se në mesin e namazeve më i rëndi është namazi i sabahut, andaj Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Nuk ka namaz më të rëndë për munafikat se namazi i sabahut dhe jacisë. Po ta dinin se çka në to, do të vini edhe zvarras. Dëshirova që të urdhëroj muezinin të thërret ikametin, pastaj të urdhëroj dikend t'i fal njerë-

zit, e të marr një flakë e tua djegi (shtëpitë) atyreve që nuk kanë dalë akoma". (Buhariu).

8- Udhëtimi i gruas pa mahrem

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Nuk i lejohet gruas që beson në All-llahun dhe Pejgamberin të udhëtojë hapësirë një ditë e një natë, pa mahrem". (Buhariu dhe Muslimi).

9- Dhënia pasqyrë të keqe për muslimanët

Kur ne nuk i respektojmë rregullat e mëdha të fesë sonë të pastër, atëherë ua mbushim mendjen të tjerëve se edhe kjo fe nuk është aq e vërtetë dhe e mirë, sepse po të ishte feja e mirë, do të ishin edhe muslimanët e mirë.

Edhe në këtë mënyrë, në vend se ti afrojmë mosbesimtarët në fenë tonë, ne i largojmë ata, andaj All-llahu, subhanehu ve teala, na ka mësuar që të lutemi, duke thënë:

"Zoti ynë, mos na bën sprovë për ata që nuk besuan dhe falna, Zoti ynë, Ti je ngadhënjyesi, i urti". (El-Mumtehine: 5).

10- Humbja e kohës

Humbja e kohës bëhet në shumë mënyra. Sot janë krijuar institucione të tëra për tua harxhuar kohën njerëzve në gjëra të kota.

Koha harxhohet kot duke:

- lexuar revista dhe libra që stimulojnë imoralitetin;

- shikuar filma dhe telenovela të dëmshme;

- dhënia e flaktë pas ndeshjeve të ndryshme sportive e sidomos pas ndeshjeve të futbollit;

- kalimi i orëve të tëra në internet; etj.

Koha është ymri i jetës dhe mejdani i ekzistimit të njeriut.

Koha është nga ari, madje edhe më i shtrenjtë se ari.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm". (Sureja El-Asr).

Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë:

"Koha e njeriut, në realitet, është ymri i tij. Është lënda e jetës së tij të përhershme në dhuntitë e pafundshme. Është edhe lënda e jetës së tij të vështirë në denimin e dhembshëm. Kalon shpejtë si retë. Ajo që kohë që është për All-llahun dhe me All-llahun është jetesa dhe ymri i tij, kurse format tjera nuk llogariten pjesë e jetës së tij, edhe nëse jeton në atë kohë sikur kafshët. Nëse e kalon kohën në neglizhencë, pagjumësi dhe shpresa të kota, nëse koha më e mirë që e kalon është gjumi dhe dembelia, atëherë për te është më mirë të vdes se të jetojë". (Xhevabul-Kafi, fq. 184).

11- Disa alternativa

a- Udhëto për të kërkuar dije dhe për ti shoqëruar dijetarët.

b- Mer pjesë në kurse fetare dhe kapringje.

c- Mer pjesë në kurse të aftësimi në gjuhë, zanate, informatikë, e të ndryshme.

d- vizitën e vendeve Islame.

Normalisht se këto janë vetëm disa sinjale, edhe pse veprat që mund të bëhen gjatë këtyre pushimeve verore janë shumë ma shumë se kjo që kemi paraqitur në këtë hutbe.

E lusim All-llahun ta ruan rininë tonë, të ruan nderin tonë, të na e shtojë dijen në fe dhe veprat e mira dhe të na mbrojë nga sprovat që i dim dhe që nuk i dimë.

Bekir Halimi,
9.7.2004

Hifzi-mësimi përmendësh i Kur'anit

Në raportin e saj të datës 17. 06. 2004, kanali televiziv „el Xhezire“ në versionin e saj elektronik publikoi një raport nga korespondenti i saj në Islam Abad, Mehjub Huder në të cilin publikohet se që nga pamvarsimi i Pakistanit nga India në v. 1947 e këndej, ndër popullin e Pakistanit, dukuria e kapjes së popullit për fenë Islame vjen gjithnjë duke u ritur më shumë dhe nga dukuritë më të dukshme të kësaj është drejtimi i tyre drejt mësimin të Kur'anit fisnik.

Ajo që më së shumti bie në sy nga kjo është orientimi i prindërve —ndër to edhe ata laik-drejt mësimin të Kur'anit fisnik përmendësh (hifz) fëmijëve të tyre. Kjo nuk është e përhapur vetëm në një shtresë të masës në të katër provincat e Pakistanit, por ajo është e përhapur në të gjitha shtresat e popullatës në mënyrë të barabartë, si në ato të varfërat, të mesmet poashtu edhe në ato të pasurat.

Më tej në këtë publikim tregohet se motivi fetar ka luajtur pa dyshim një rol jashtzakonisht të rëndësishëm në orientimin e prindërve që fëmijët e tyre t'i orientojnë drejt mësimin të Kur'anit fisnik përmendësh, mirëpo ekzistojnë edhe motive tjera që i kanë nxitur ata në këtë hap të rëndësishëm, sikur të mëposhtmet:

bindja se hafizët e Kur'anit janë më sipëror në mësim krahasuar me shokët e tyre që nuk janë hafizë, bindje kjo e përforcuar edhe me disa hulumtime analitike të atjeshme lokale.

Pozita e ngritur dhe autoriteti që e gëzojnë hafizët në rrethin në të cilin jetojnë, etj.

Kështu pra, të shtyer nga këto motive, shumë familje pakistaneze i nxjerrin fëmijët e tyre nga shkollat e sistemit për të mund që që nga moshat e tyre të hershme tu bashkangjiten hallkave të mësimin të Kur'anit përmendësh. Për një afat kohor prej 1-2 vite, aq sa përafërsisht është kohëzgjatja e nxënies së Kur'anit përmendësh.

Sipas informatave të grumbulluara rreth numrit të hafizëve në Pakistan, del se mesatarisht në çdo tre shtëpi gjendet nga një hafiz e kjo rezulton në atë se numri i tyre nuk është më pak se 7-milionë hafizë.

Mënyra e hifzit (nxënies përmendësh):

Shkollat e hifzit të atjeshme e përdorin metodën e „telkinit“ (mësimin gojarisht) me të cilin e fillojnë mësimin e nxënies me nivelin e ashtuquajtur „nuranijje“, për një kohë afër 3- muaj, e që nënkupton mësimin e pastër të shqiptimit të harfeve (shkronjave kur'anore). Pastaj nxënies fillon me mësimin e tre ajeteve përmendësh dhe leximin e tyre para muhaffidhit (mësuesit të hifdit) të tij, dhe nuk kalon në ajete tjera që pasojnë, pa i mësuar dhe shqiptuar mirë këto të parat.

Poashtu caktohet kohë e mjaftueshme për çdo ditë për ta përsëritur hifzin e kaluar dhe zakonisht kjo është në një orë para namazit të sabahut dhe kështu pastaj vazhdojnë hallkat e hifzit deri në namazin e akshamit, mes të cilës ekzistojnë edhe dy pushime. Vlen të përmendim se shumica e atyre që mësojnë

hifz flejnë në xhami dhe kjo tregon se atyre u jepet njo kohë e mjaftueshme për hifz, larg nga familja dhe nevojat e saj. Zakonisht me hifz fillohet nga drejtimi i kundërt, pra nga xhuzit i fundit (pjesa e 30-të e Kur'anit).

Banorët e një vendi –në bashkëpunim me përgjegjësit e halkave të hifzit- e shfrytëzojnë rastin e kryerjes së hifzit të ndonjërit prej nxënësve, për pregaditjen e ndonjë programi, i cili shpesh është në nivel të lartë në të cilin marin pjesë familjet e atij rrethi ku në prezencën e dijetarëve të mëdhej të cilët më pas e bëjnë mbështjelljen e çallmës në kryen e nxënësit që e ka kryer hifzin, e cila në traditën pakistaneze njihet si mirënjohja (diplomë) e vërtetë për hafizin e Kur'anit dhe e cila e bën atë që të ndjehet krenar. Kështu pas vënies së saj në krye gjatë këtij ceremoniali ai më nuk ec rrugëve pa të mbi krye.

Pas përfundimit të hifzit, hafizët kryesisht ndahen në dy grupe:

1-Grupi i hafizëve të cilët kthehen në shkollat e tyre të sistemit që të vazhdojnë me shkollimin e tyre të ndërprerë, dhe

2-Grupi i hafizëve të cilët drejtohen për ndonjë punë, mvarësisht se çfar punë ju mundëson diploma e hifzit që të ushtrojnë në atë shoqëri që jetojnë.

Ky lloj i dytë i hafizëve ushtrojnë detyra dhe aktivitete të ndryshme, nga të cilat veçojmë:

-tahfidhi (mësimin e nxënësve hifzin) në halkën e hifzit në të cilën kanë mësuar apo në ndonjë tjetër,

-faljen e namazeve të teravisë me hatme nëpër xhamia (pra me leximin e tërësishtëm

të Kur'anit),

-leximin e Kur'anit në raste të ndryshme

Pikë me rëndësi që nxit në mësimin e Kur'anit përmendësh është edhe ajo se nuk paguhet asgjë gjatë qëndrimit dhe mësimin 1-2 vjeçar, kështu që harxhimet i mbulojnë vetë qendrat e hifzit nga donacione të ndryshme. Kjo gjë konsiderohet e rrallë krahasuar me shoqëri tjera, veçanërisht kur të kihet parasysh numri i madh i atyre që mësojnë hifz.

Vlen të përmendim se edhe nëpër vendet tona, ku jetojnë shqiptarët muslimanë praktikohet mësimi i Kur'anit përmendësh.

Ashtu në Maqedoni tashmë 30-vjet e shumë, molla Mahmud Asllani, muhaffidhi (mësuesi i hifzit) i mirënjohur i xhamisë së Larmë të Tetovës, ka nxjerrur më tepër se 100 hafiza kryesisht të moshës së re, në mesin e të cilëve më i riu ka qenë një 7-vjeçar. Kurse fshati Studeniçan, në afërsi të Shkupit është i njohur si "fshati i hafizave" për shkak të numrit të madh të hafizave në këtë fshat.

-Në Shqipëri janë hapur qendra të ndryshme për hifz kurse edhe në Kosovë e Mal të Zi është gati se e njëjta situatë, ku kryesisht këte e kanë bërë hoxhallarë duke i mësuar nxënësit e tyre nëpër mektebe.

Këtë shkrim e përfundojmë me një hadith të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem se "Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson tjerëve" me qëllim të nxitjes në mësimin e Kur'anit.

Allahu i shtoftë hafizët e Kur'anit dhe ata dhe muhaffizët e tyre i shpërbleftë me xhenetet e Tij. Amin.

Emin Limani

19.06.2004

25.6.2004

Sqarim për hadithin e Nexhd-it

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “O All-llah bekoje Shamin. O All-llah bekoje Jemenin.” Disa thanë: “O i dërguar i All-llahut, edhe Nexhdin.” Mendoj se të tretën herë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: “Atje do të ketë tërmete, sprova dhe fatkeqësi, dhe prej aty del briu i shejtanit.” (transmeton Buhari, Libri i Sprovave, Kapitulli “Fitnet do të vijë nga Lindja” 9/166)

Hadith i cili është keqkuptuar (me qëllim) nga grupe të caktuara njerëzish, të cilët mundohen ta shpërndajnë dalaletin e tyre dhe të mashtrorjnë muslimanët që nuk kanë dije.

Pasi që ta hulumtojmë dhe ta shqyrtojmë këtë hadith, si dhe pasi ti lexojmë fjalët e dijetarëve të mëdhenj do shohim se ky hadith nuk i referohet Nexhdit i cili gjendet në Arabinë Saudite, por se përkundrazi ky hadith i referohet Irakut.

Ndër dijetarët të cilët i'a kanë referuar këtë hadith Irakut janë: Ibën Haxher el-Askalani, Imam Neveviu dhe shumë dijetarë tjerë. Shkaqet për këtë janë të shumta dhe të qarta:

1. Hadithet e shumta të cilat tregojnë se Fitneja do të vjen nga lindja

Buhariu këtë hadith e ka vendosur nën kapitullin “Fitnet do të vijë nga Lindja”:

212- Nga Ebu Selimi: se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, qëndroi afër minberit (dhe bëri me gisht kah lindja) dhe tha: “Fitnet janë atje! Fitnet janë atje! Prej atje del briu i shejtanit..”

213- Nga Ibën Omer i cili ka thënë: E kam dëgjuar Të Dërguarin e All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili përderisa ishte i kthyer kah lindja tha: “Me të vërtetë fitnet janë atje, prej atje del briu i shejtanit.”

214- Hadithi i Nexhdit për të cilin po flasim.

Hadithe të ngjashme mund të gjenden në Sahihun e Muslimit (1/83+, 4/6938+.)

2. Në përgjithësi fitnet dhe fatkeqësit e para erdhën nga Lindja, shumica prej tyre nga vet Iraku

Ibën Haxher el-Askalani duke e komentuar Hadithin e Nexhdit ka thënë: “dhe të tjerë kanë thënë se njerëzit e lindjes ishin pabesimtarë në kohën kur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na informoi se fitnet dhe fatkeqësitë do të dalin nga ai drejtim dhe me të vërtetë ndodhi ashtu siç tha ai. Dhe sprovat e para që dolën, dolën prej drejtimit të lindjes dhe ato ishin shkak për përçarjen e reshtave të muslimanëve, e kjo është ajo që shejtani e don dhe e pëlqen. Gjithashtu bidatet dolën nga ai drejtim.” (Fet’hul-Bari 13/58).

Prej sprovave që dolën nga Iraku dhe nga Lindja ishte mbytja e Aliut, radijall-llahu anhu, vrasja e nipit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, beteja e parë në mes muslimanëve ndodhi në Irak, dhe shumë fatkeqësi tjera.

Imam Neveviu përmend se një nga sprovat më të mëdhaja që do të paraqiten nga Lindja do të jetë dalja e Dexh-xhallit (Sherh Sahihul-Muslim 2/29).

Prej bidateve që u paraqitën në lindje, e sidomos në Irak, është fakti se shumica prej sekteve të hershme devijante siç janë Kaderijeh, Xhehmijeh e të tjera, u paraqitën atje.

Në kohën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kishte 13 vende të njohura si “Nexhd”, kjo sepse “Nexhd” gjuhësisht do të thotë “tokë e ngritur”. Për këtë shkak Arabët nga respekti këtyre tokave u thoshin “Nexhd”. Një nga zonat që më së shumti është thirrur në atë kohë si “Nexhd” ka qenë zona ku është Iraku i sotshëm.

3. Nexhdi në drejtim të lindjes për ata njerëz që jetojnë në Medine është Iraku

Ibën Haxheri ka thënë: "El-Hatabi ka thënë: "Nexhdi" në drejtim të lindjes, për atë që është në Medine do të jetë shkretina e Irakut dhe rrethinat e saja, e kjo është në drejtim të lindjes për banorët e Medines. Kuptimi i fjalës "Nexhd" është "toka e ngritur", e kundërta e "el-Gaur" që do të thotë "ajo që është më e ulët". Tihameh (Rrafshina bregdetare në drejtim të Jug-Perendimit dhe Jugut të Gadishullit Arabik) është plotësisht "el-Gaur" dhe Meka është në Tihameh."

Ibën Haxheri vazhdon dhe thotë: "nga kjo (fjala e el-Hatabit) shihet se Nexhdi është në drejtim të Irakut, e kuptohet dobësia e fjalës së Ed-Davidit i cili thotë se Nexhdi është vend specifik. Kjo nuk është kështu, përkundrazi çdo vend që është i ngritur thirret "Nexhd" ndërsa regjioni më i ulët thirret "Gaur". (Fet'hul-Bari 13/58-59).

El-Mubarekfuri i përmend këto fjalë në komentimin e tij të "Sunenit të Tirmidhiut" (Tuh-fetuElhvedh, 10/314 nr. 4212).

4. Hadithi në Sahihun e Muslimit (nr. 6943)

Selim Ibën Abdull-llahu Ibën Omer ka thënë: "O njerëzit e Irakut, sa e çuditshme është që më pyetni për mëkatet e vogla ndërsa i bëni mëkatet e mëdha? (e ka fjalën për vrasjen e Husejnit, radijall-llahu anhu). Unë e kam dëgjuar babain tim Abdullah Ibën Omerin duke thënë se e ka dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili kur ka qenë i kthyer kah lindja ka thënë: "Me të vërtetë trazirat do të vijnë nga kjo anë, prej atje ku paraqitet briu i shejtanit dhe atje do ti goditni qafat e njëri-tjetrit...".

5. Hadithet e qarta që nuk lënë dyshim se për cilin "Nexhd" bëhet fjalë

-Hadithi i Ibën Omerit i transmetuar nga Ebu Nuajmi në "el-Hilje" (6/133): Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "O All-llah bekoje Medinen, dhe bekoje Meken, dhe bekoje Shamin, dhe bekoje Jemenin..." Një person tha: "O i dërguar i All-llahut dhe Irakun tonë", pastaj ai u largua pak prej tij dhe tha: "atje do të ketë tërmete, sprova dhe fatkeqësi dhe prej atje do të del briu i shejtanit." (Shuajb Arnauti në "Sherhus-Sunneh" thotë se isnadi i këtij hadithi është i vërtetë, 14/206-207).

-Hadithi i Ibën Omerit i transmetuar në "El-eusat" se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e fali sabahun pastaj u kthye kah njerëzit dhe tha: "O All-llah bekoje Medinen..." Një person tha: "Edhe Irakun o i dërguar i All-llahut?" Ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "prej atje del briu i shejtanit dhe sprovat dhe fatkeqësit do të vijnë si dallgë." (el-Hejthemi në "Mexhmeuz-zauaid" 3/305, kapitulli "përmbledhja e duave (për Medinen)" thotë: "transmetuesit janë të besueshëm").

-Hadithi i Ibën Abbasit i transmetuar nga Taberaniu: se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u lut dhe tha: "O All-llah bekoje Shamin dhe Jemenin". Një person tha: "O i dërguar i All-llahut edhe Irakun?", Ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "Me të vërtetë atje është briu i shejtanit, dhe sprovat dhe fatkeqësitë do të paraqiten si dallgë, dhe me të vërtetë ashpërsia është në lindje." (el-Hajthemi thotë: "transmetuesit janë të besueshëm").

Marrë nga: islaam.net
Përktheu: Omer Islami
2.7.2004

Dispozita islame për adoptin

Dispozita islame për adoptimin dhe dimensionet e tij njerëzore dhe sociologjike:

Shoqëria arabe në kohën e injorancës jetonte sipas botëkuptimit dhe ligjeve të njohur tek shoqëritë e tjera si romakët, grekët e vjetër si dhe sipas botëkuptimit tek disa popuj e qytetrimet në këtë periudhë bashkëkohore. Bazamenti i këtij botëkuptimi ishin ligjet racionale, tiparet individuale, zakonet e popujve, si dhe supozimet me dihapazon të ngushtë. Ky botëkuptim nxiste në ekzistimin e disa zakoneve të trashëguara që kundërshtoheshin me bazat e moralit të lartë, parimet e shoqërisë së shëndoshë si dhe me unitetin dhe harmoninë familjare.

Nga këto dukuri të përhpura në shoqëritë e tillë është edhe adoptimi i fëmijëve.

Adoptimi definicioni dhe shkaqet:

ET-TEBENNI-(adoptim i fëmisë) – që don të thotë: Lidhja që mes adoptuesit dhe adoptuarit krijon të drejtat dhe detyrat që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve- është një nga dukuritë negative që u përhapën si përgjigjë instiktit natyror i shfaqur në dashurinë ndaj fëmijëve në rast kur prindërit nuk kanë fëmijë, si dhe nga dëshira për adoptim të ndonjë fëmijë me vetëdije për faktin se prindi i vërtetë i atij fëmijë është dikush tjetër dhe se ky nuk është babai i vërtetë i tij.

Nga motivet për këtë dukuri është edhe përkujdesja për fëmijën e braktisur, me prejdardhje të panjohur ose fëmijën që nuk ka familje që do të kujdeset për të.

Gjithashtu shkak për të adoptuar ndonjë fëmijë mund të jetë dëshira që fëmiju t'i bashkangjitet trungut gjenealogjik të "prindit adoptues" i cili ka pozitë dhe respekt të madhë në shoqëri. Varfëria, mbrapambeturia, egoizmi si dhe mosmundësia për kryerjen e

obligimeve prindërore ndaj fëmisë janë disa nga shkaqet që inicijojnë shitjen apo dhurimin e fëmisë i cili do të rritet në ndonjë familje apo shoqëri krejtësisht të huaj. Kjo formë e adoptimit me këto motive është një nga rastet të cilët ne sot i dëgjojmë dhe i shohim nëpër mjetet e mass mediasë elektronike.

Pasi qëbota në vitin 1952 arriti të pajtohet të ndalon robërinë erdhi koha që të ndalon edhe adoptimin i cili është një formë e tjetër e padrejtësisë dhe përplasjes me natyrën njerëzore e cila ndërtohet mbi barazi dhe e cila kërkon që çdo fëmijë t'i atribuohet prindërit të tij e jo t'i atribuohet adoptuesit (Sipas legjislationit kosovar: Kur adoptimi i plotë është miratuar, atëherë mbiemri i të adoptuarit shkruhen si mbiemri i adoptuesit. Tek adoptimi i plotë adoptuesi regjistrohet në çertifikatën e lindjes si prind i të adoptuarit –neni 179-) (Te adoptimi i plotë të drejtat dhe përgjegjësitë ndaj prindërve të tij/saj dhe personave të tjerë në marrëdhënie me fëmijën shuhen –neni180-) (Pas krijimit të adoptimit të plotë njohja e atësisë dhe amësisë së fëmijës së adoptuar nuk është e lejuar –neni 181-). Me këto ligje ndalohet që fëmija e adoptuar ndonjëherë t'i kthehet prindit të vërtetë dhe gjithë lidhjet me ta shuhen. A nuk është kjo padrejtësi që i përngjan robërisë. Përgjigjen kësaj dileme do ta jepni vet ju.

Adoptimi tek arabët para Islamit:

Tek arabët adoptimi ka qenë dukuri prezente në kohën e injorancës si dhe pas ardhjes së Islamit, sepse ligjet e Islamit shpallëshin gradualisht, duke e edukuar popullin dal ngadal . Kur ndonjërit prej arabëve kur i pëlqente fuqia apo trimëria e ndonjë fëmisë e konsideronte një nga fëmijët e tij dhe ai e

fitonte të drejtën e trashëgimisë sikur që kishin fëmijtë e tjerë. Këtë fëmijë ata e thirrnin me emrin e adoptuesit të tij .

Edhe Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, para se të bëhet i Dërguari i All-llahut, e kishte adoptuar një djalë nga robërit e Shamit (Sirisë) të cilin e kishte blerë Hakim ibën Hizam ibën Huvejlid e ai ia kishte dhuruar hallës së tij Hadixhe binu Huvejlid e cila ishte gruaja e parë e Muhammedid, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pastaj ajo ia dhuroi Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ai e liroi ate nga robëria por Zejdi id ha përparësi mbetjes në praninë e të Dërguarit dhe nuk i kthye në Sham. Kur e Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e adoptoi tha: >O fisi i Kurejshit dëshmoni se ky është biri im dhe ky do të më trashigon mua e unë do të trashëgoi atë<

Kjo traditë është e njëjtë me shumë tradita që nuk u ndaluan përmjeherë në fillim të Islamit, por gradualisht si pirja e alkoholit, kamata dhe disa dukuri negative të kohës së injorancës.

Zejdi në atë kohë thirrej: Zejdi biri i Muhammedit. Kjo zgjati deri sa Islami e ndaloi adoptimin e fëmijëve sepse misioni Islam ishte që ta edukojë shoqërinë dhe t'i largon dukuritë negative që janë prezente në shoqëri në mënyrë graduale. Muhammedi a.s. thonte "Jam i dërguar t'i plotësoj virtytet e larta" (transmeton Buhariu në Edebul Mufred, Hakimi dhe Bejhakui nga Ebu Hurejreja, radijall-llahu anhu).

Dispozita Islame mbi adoptimin:

Argument për ndalimin e adoptimit të fëmijëve i kemi tre ajete kur'anore siç vijojnë :

"...E as nuk ua bëri djem tuaj të adoptuarit tuaj (fëmijët e tjetërkujt që i adoptoni si të juaj). Këto janë vetëm thënie tuaja që i shqiptoni me gojë tuaja, e All-llahu e thotë atë që është realitet, dhe Ai udhëzon në rrugën e drejtë." (El Ahzab, 4) "Ju thirrni

(mbështetni) ata në etërit e vërtetë të tyre, kjo është më e drejtë tek All-llahu, e nëse nuk ua dini (nuk dini se kush janë) etërit e tyre, atëherë ata janë vëllezërit tuaj dhe të afërmit tuaj në fé. Nuk është ndonjë mëkat juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaja e bëjnë qëllimisht, po All-llahu është që falë, është mëshirues." (El Ahzab, 5) "Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshtëm për çdo send." (El Ahzab, 40)

Që don të thotë : Muhamedi nuk është babai i vërtetë i asnjërit nga burrat tuaj, e as që është babai i Zejdit. Pas kësaj njerëzit filluan ta thirrën Zejdi biri i Harithes që ishte babai i tij i vërtetë, e jo Zejdi biri i Muhammedit siç thirrej më pare.

Këtë dispozitë poashtu e vërteton hadithi i Muhamedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: "Kush thirret në emër të dikuj tjetër i cili nuk është babai i tij i vërtetë dhe ai e din atë i është ndaluar hyrja në xhenet" Transmeton Ebu Davudi, Nesaiu, Ibën Maxhe, Ibën Hibani dhe Hakimi nga Ebu Hurejreja. Në hadithin tjetër është thënë: "...mbi të janë mallkimet e All-llahut të njëpasnjëshme deri në ditën e gjykimit" transmeton Ahmed, Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Ibën Maxhe nga Sa'd ibën Ebi Vek-kasi dhe Ebi Bekrete.

Islami e anuloi këtë zakon i cili kishte marrë hov të madh tek arabët si dhe sot në kohën bashkëkohore, dhe ka urdhëruar mos të thirret dikush pos në emër të babait të tij të vërtetë.

Kjo është kur fëmijët i dihet babai, por, në mungesë të babait të tij thirret si ndihmësi, i mbrojturi nga ose vëlla në fe. Me këtë emërtim ata hynë në familjen e gjërë të Islamit e ngritur mbi bazat e vëllezërisë, solidaritetit, mëshirës, dashurisë dhe kujdesit që mos të humbin lidhjet mes muslimanëve.

Urtësitë e kesaj ndalese:

1- Lidhja e ngushtë familjare në Islam mes prindëve dhe fëmijëve ndërtohet mbi lidhjen që formohet nga gjaku dhe prejardhja e përbashkëta nga një mitër. Kur ky element nuk ekziston paraqiten probleme që burojnë nga vetëdija se kjo familje është artificiale dhe nuk e ka atë lidhshmërinë e gjakut dhe prejardhjes së përbashkët. Kjo mes të afërmeve shkaton, grindje, armiqësi, gjaktrazim (incest) dhe dukuri tjera negative. Për këtë shkak sistemi i adoptimit kundërshtohet me fundamentet e ligjit hyjnor dhe moralet e larta, dhe fëmiju i adoptuar është i huaj në familje me gjitha pasojat që i ka vetëdija për këtë fakt nga nëtarët e tjerë të familjës.

2- Islami në të gjithë dispozitat e tij juridike bazohet në drejtësi. Nga kjo nënkuptohet se fëmiju duhet të thirret në emër të babait të tij të vërtetë, e jo në emër të babait të falsifikuar ngase e drejta e së vërtetës është që ajo të ndiqet dhe të respektohet.

3- Sistemi i trashëgimisë në Islam është i kufizuar në afërsinë nga gjaku dhe nëse nga të afërmit nuk ka trashëgues fëmiju i adoptuar nuk fiton të drejtë trashëgimi. Poqëse ne e lejojmë adoptimin a thua vallë çfarë do të ndodhte (probleme mes trashëguesve me të drejtë dhe të adoptuarve)??! Ruajtja e drejtave të trashëguesve është obligim të cilin e mbron Islami

4- Adoptimi nuk e realizon të drejtën e atësisë. Ai vetëm e verteton pretendimin që një njeri të bëhet prindër i ndonjë fëmijut. Kur të thirret dikush në emër të dikujt tjetër që nuk i ati i tij kjo thirrje është e falsifikuar, të cilën nuk e pranon as ligj hyjnor e as logjika e shëndosh. Obligim është që fëmiju të thirret në emër të babait të tij të vërtetë. Allahu si ligjdhënës vendos ligje të drejta, e thotë të vërtetën dhe udhëzon në rrugën e lumturisë.

“Ju thirrni ata në etërit e vërtetë të tyre, kjo është më e drejtë tek Allahu ...”

5- Fëmiju i adoptuar qoftë mashkull apo femër ai është i huaj në rrethin e ngushtë familjar dhe në këtë gjendje nuk mundet të ketë harmoni morale e as fetare. Kjo ndodhë se ata në vete e ndiejnë një lloj largësie mes njëri tjetrit sepse nuk janë me prejardhje të njejtë. Ky realitet mundet të shkakton çrregullime nga aspekti moral (imoraliteti)

6- Me adoptim i merret e drejta dhe i bëhet padrejtësi prindërit të vërtetë dhe njëkohësisht i mëkëmbet nderi njerëzor dhe të drejtat e tij si prindër (shih nenin 180).

7- Shoqëria homogjene në zakone dhe tradita është bazë e stabilitetit familjar, si dhe bazë e reciprocitet të dashurisë dhe simpatisë mes të fëmijëve dhe prindërve.

Kjo ngajshmëri që nuk cenohet nga elementi i huaj, i cili ndoshta vjen nga një shoqëri plotësisht të ndryshme, siguron unitetin në pikënisje dhe realizimin e synimeve të përbashkëta që janë trashëgimi kulturore dhe shoqërore e familjës në rrethin e gjërë të shoqërisë homogjene. Në të njejtën kohë largimi i fëmisë së adoptuar nga rrethi i tij kombëtar, fetar, shoqëror e privon nga formimi i tij individual nën hijen e trashëgimisë shoqërore të cilës ai i përket. Kështu tek i adoptuari janë ndërprerë gjitha lidhjet mes tij dhe tiparet kombëtare, fetare dhe shoqërore të familjës së tij. Ai në këtë mënyrë bëhet si druri rrënjët e të cilin janë prerë. Familjet adoptuese në shumicën e rasteve nuk e ruajnë identitetin kulturor të fëmisë dhe nuk i kanë parasysh besimet dhe përkatësinë e tij fetare në origjinë. (Kjo ndodhë kur fëmijë adoptohen nga familje të huaj prej shteteve të ndryshëm)

Ç'zgjidhje ofron Islami:

Fenomeni i fëmijëve të braktisur nuk neglizhohet nga Islami. Nga pikënisja e humanitetit Islami kujdeset për çdo njëri dhe mundohet t'i garanton jetë dinjitoze duke ia garan-

tuar të drejtën për jetë dhe plotësimin e nevojave të tyre. Preventimi është një më i mirë për zgjidhjen e kësaj dukurie. Edukimi i fëmijëve, lufta kundër varfërisë, parandalimi i keqpërdorimit seksual, sanksionimi i njerëzve që keqpërdorin naivitetin e vajzave janë vetëm disa nga mjeteve parandaluese.

Fëmiu i braktisur në shumicën e rasteve është fëmijë i marrëdhënies seksuale jash-tëmartësore:

Ëndrat e lumturisë dhe premtimet e princave shpeshherë thyhen para realitetit të idhët. Fjalët e ëmbëla harrohen atëherë kur paraqitet problemi i fëmisë së “padëshiruar” ose paplanifikuar. Vajza, e cila me siguri është pala më e dobët në këtë rast shpeshherë vendos të lirohet nga barra e padëshiruar dhe bën abortin ose braktis fëminë e saj.

(Në këtë realitet të idhët, nga i cili vuan tërë bota dhe mikropjesa e saj e njohur me emrin trojet shqiptare, del në shesh urtësia e ndalimit të marrëdhënies seksuale para legalizimit të tyre me anë të kontratës martesore, kurorëzimin. Në mungesë të kontratës valide fëmiu i padëshiruar është viktimë.)

Dispozita Islame mbi fëmijët nga marrëdhëniet joligjore:

Për këtë fëmijë kujdeset prijesi i shtetit Islam ose personi të cilin do ta cakton prijesi, shënohet si fëmijë i nënës dhe nuk e trashëgon atin e tij e as që trashëgohet nga ai.

Fëmiu nga marrëdhëniet jo të ligjshme në jurisprudencën Islame nuk përgjigjet për veprën e palejuar që e kanë bërë prinderit e tij e as që do të mirret në përgjegjësi para All-llahut, subhanehu ve teala. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: “Askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit.” (El En’am, 164)

“Kush e udhëzon veten në rrugën e drejtë, ai e ka udhëzuar vetëm vetveten e vet, e kush e humbë (rrugën), ai e ka bërë humbjen kundër vetvetes së vet, e askush nuk do ta

bartë barrën e tjetrit. E Ne nuk dënuam askë para se t’ia dërgojmë të dërguarin.” (El Isra, 15)

“Ndërkaq, nuk do ta bartë asnjë mëkatar barrën e tjetrit. Pastaj, e ardhmja juaj është vetëm te Zoti juaj, e Ai do t’ju njoftojë me atë që keni vepruar. Vërtet, Ai e di shumë mirë se çka mbajnë zemrat.” (Ez Zumer, 7)

Shejhul Islam Ibën Tejmijje, All-llahu e mëshiroftë, thotë: Fëmiu nga marrëdhëniet seksuale joligjore (pasi qëarrinë moshën e pjekurisë) do të shpërblihet ose denohet në bazë të veprave të tij. Nëse ka bërë vepra të mira do të shpërblehet dhe nëse ka bërë vepra të ndaluara do të dënohet për të (nëse don All-llahu). Dënimi dhe shpërblimi është i varur nga veprat e njeriut e jo nga prejardhja e tij. (Fetvatë e Shejhul Islamit Ibën Tejmijje, vëll.4, fq.312)

Fëmija i braktisur që nuk është domosdoshëm nga marrëdhëniet seksuale joligjore:

Fëmiu i braktisur në Islam është e lirë dhe obligimi i përkujdesjes për të është obligim kolektiv (Fardul kifaje). Përkujdesjen materiale e ka shteti në rast kur në praninë e tij nuk është gjetur ndonjë pasuri. Në rast kur në praninë e tij është gjetur pasuri ajo shpenzohet për përkujdesjen ndaj tij. Ai që e ka gjetur fëminë e braktisur është kujdestari për të por me kusht që të jetë i drejtë.

Nëse pas një kohë prinderit e tij kërkojnë kthimin e fëmisë u mundësohet kjo gjë sepse kjo është me mirë për fëminë.

Nëse më tepër se një palë pretendojnë se janë prindër të fëmisë përcaktohet me anë të analizës për vërtetimin e atësisë.

Opsioni tjetër:

Nga opsionet zgjidhese Islame në rregullimin e statusit të fëmisë së braktisur është edhe tajitja e fëmisë nga ndonjë grua. Me anë të gjidhënies (tajitje) (tajita: e ushqej me gji një foshnje të huaj, Fjalori i shqipës së sotme, fq.1321) krijohet lidhja prindër

(prej gjiri)-fëmijë (prej gjiri) dhe vëlla (prej gjiri)-motër (prej gjiri) mes fëmiut dhe familjës që kujdeset për të si dhe menjanohen problemet që do të ndodhin pas rritjes së fëmisë (vështirësohet jeta sepse femiu i mosshëritur bëhet faktikisht i huaj në rrethin familjar me gjitha implikimet që i ka kjo fjalë)

I Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,ka thënë:

“Lidhja familjare e krijuar me anë të tajtjes ndalon ato që i ndalon lidhja e gjakut” që don të thotë: Ndalimi i martesës dhe ndalimet e tjera mes të afërmëve për shkak të lidhjes familjare bëhen të ndaluar edhe kur krijohet lidhja me anë të gjidhënies. Kjo procedurë i ka kushtet që duhet plotësuar:

1. Numri i tajtjeve të jetë më tepër se pesë herë dhe ato duhen të janë ngopese
2. Qumështi i gjiut të jetë për shkak të shtatëzanisë.
3. Tajtja të ndodhë brenda dy viteve të para nga mosha e fëmiut
4. Nuk është kusht që fëmiu të thithë drejtëpërsëdrejti nga gjiu dhe mundet që atë ta

bën edhe nga ndonjë enë.

5. Gjatë ushqimit me qumësht të ngrirë nga bankat e qumështit duhet të dihet nëna, fëmiu dhe numri i tajtjeve

6. Gruaja që dyshon në numrin e tajtjeve e merr për bazë numrin më të vogël nga numrat për të cilët dyshon

7. Për këtë gjë pranohet dëshmia e muslimanes të mençur dhe besnike

8. Vëllëzërit e fëmisë të tajtur (prej gjakut) nuk e marrin dispozitën e tij për nga ndalesa e martesës me fëmitë e tajës (grua që ushqen një foshnjë të huaj, Fjalori i shqipës së sotme, fq.1321)

9. Bashkëshorti i tajës konsiderohet prindër i foshnjës së tajtur me një përjashtim ata nuk trashëgohen mes veti

10. Kujdesi i madhë duhet të kihet parasysht para së të ndërmiret ky hap për shkak të konsekuencave që rrjedhin prej tij

11. Futja e qumështit me anë të hundës ose ezofagut në rast të pamundësisë të thithjes me gojë e ka dispozitën e njejtë sikur thithja me anë të gojës.

Autor: Dr. Vehbe Ez Zuhejji
Përgatitën për publikim: Enver Azizi
Talha Kurtishi
9.7.2004

Definicioni i Sheriatit

Definicioni terminologjik i Sheriatit (esh-sheria) është: Sheriati është tërësia e rregullave që All-llahu, subhanehu ve teala, ia ka shpallur të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe ajo përfshin parimet e besimit, dispozitata praktike sekundare si dhe rregullat etike. Kurse etimologjikisht kjo fjalë ka kuptimin pirja e ujit prej burimi, rrugë e qartë, burim prej të cilit njerëzit pijnë, ligj etj.

Talha Kurtishi
(Shënim për librin në proces botimi nga “NuN”, me titull “Historia e fikhut islam” nga Sulejman Omer El-Eshkar.)

Konflikti mes mendjes dhe epshit

Normalisht se gjatë verës del në shesh edhe ma shumë ky konflikt, ndoshta ky konflikt është edhe vendimtari në ecurinë e njerëzimit drejt asaj që i sjell dobi dhe të mira në këtë jetë dhe në jetën e ahiretit, po edhe të këqijat.

Njeriu si duket edhe është viktimë e këtij konflikti, në të cilin, nga mungesa e përdorimit të shëndoshë të mendjes, fiton epshi.

Ose nga shkakut se më shumë i servohen elemente joshëse epshit se sa mendjes.

Kështu që nuk ka emision, reklamë, program, shkollë, universitet, rrugë, kafene, ku nuk ekspohet joshja e epshit, kurse në të gjitha këto raste mungon ekspozimi i joshjes së mendjes.

Në popullin tonë më shumë kemi raste ku organizohen koncerte muzikore, me karakter demoral dhe degjenerues, se sa promovime të librit. Madje edhe vet teksti i këngëve më nuk ka ndonjë karakter shkencor dhe letrar, por është një rënditje e rimuar e fjalëve që nuk ka ndonjë domethënie arsimuese dhe edukative.

Më shumë vizitohen prezentimet e miseve të ndryshme se sa të organizimeve që kanë të bëjnë me dijen dhe shkencën.

Organizimi i panairit të librit, zakonisht bëhet më i dobët se sa panairët tjerë.

Përgaditja e librave dhe prezentimi i tyre zakonisht bëhet më i dobët se sa i prodhimeve të ndryshme industriale.

Media shumë më pak mirret me librin, dijen dhe shkencën se sa me gjëra shumë të zbehta të realitetit tonë.

Po edhe vet shkolla më nuk e ka atë pozitë të arsimimit dhe edukimit që ka patur dikur, ose të cilën duhet ta ketë.

E mos të flasim për familjet, të të cilët janë prishur të gjitha kriteret, ato tradicionale, ato fetare edhe ato shkencore.

Epshi dhe njeriu

Epshi është i natyrshëm te njeriu, sepse në këtë formë e ka krijuar All-llahu, subha-

nehu ve teala, njeriun. Islami e konfirmon këtë emocion dhe e nderon, andaj e ka bërë të ligjshme martesën mes dy gjinive dhe sunnet të pejgamberëve, si përgjigje e kësaj nevojë, kurse këtë akt martesor e ka emërtuar si marvëveshje të rëndë, për të treguar rëndësinë dhe madhësinë e tij.

Ky instikt është prej instikteve më të fuqishme te njeriu dhe më i rezikshmi, andaj All-llahu, tebareke ve teala, e ka bërë prej epsheve të para, të cilat ia ka zbukuruar njeriut. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek All-llahu është e ardhmja më e mirë". (Ali Imran: 14).

Kontrollimi i epshit

Andaj, nëse i lirohen frerët këtij instikti dhe i hapen dyert gjërë e gjatë, në mungesë të kontrolluesit fetar dhe moral, ajo nuk le asgjë shëndosh, e shkatërron edhe gjendjen edhe pasurinë, shkakton prishjen e shoqërisë, humbjen e gjinisë njerëzore dhe sojit dhe shkatërrimin e popujve dhe njerëzve.

All-llahu, xhel-le shanuhu, na e ka tërënjekur vërejtjen nga afrimi imoralitetit e ka thënë:

"... mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, ...". (El-Enam: 151).

"Dhe mos iu afroni imoralitetit (zināsë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe". (El-Isra: 32).

E kur All-llahu e ndalon një gjë, ia ndalon edhe shkaqet që shpiejnë në atë gjë, andaj ka venduar dispozita dhe ligje që ia lehtësojnë njeriut largimin prej tyre. Për këtë, pasi që All-llahu e ka ndaluar zinanë (marëdhëniet intime pa kurorë) ka përcaktuar edhe ligje dhe rregulla që i mbrojnë njerëzit nga rënia

në kënetën e poshtërsisë.

Ligjet për kontrollimin e epshit

Prej ligjeve për kontrollimin e epshit janë edhe këto:

1- I urdhëron All-llahu, dy palët (meshkujt dhe femrat) të ulin shikimin.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Nuk është për ju ndonjë mëkat, nëse hyni në shtëpi të pabanuara, e që në to keni ndonjë përfitim. All-llahu e di atë që e shfaqni haptas dhe atë që e mbani fshehtë. Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haremit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata". (En-Nur: 29- 30).

2- Qëndrimi i grave në shtëpi, për ta ruajtur stabilitetin e shoqërisë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Dhe rrimi në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj si shfaqej në injorancën e hershme, ...". (El-Ahزاب: 33).

3- Nëse del për nevojë, sherijati ia ka bërë obligim mbulesën islame, për ta mbyllur derën e fitnes:

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"O ti Pejgamber, thuaju grave tua, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t'i vënë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen. All-llahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues". (El-Ahزاب: 59).

Dhe thotë:

"...të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, ...". (En-Nur: 31).

4- I ka ndaluar gruasë që ti përplas këmbët për të zbuluar stolitë e veta:

"...Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre...". (En-Nur: 31).

5- I ka ndaluar gruas të llastohet gjatë foljes:

All-llahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

"... andaj mos u llastoni në të folur e të llastojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij,

po thuani fjalë të matura". (El-Ahزاب: 32).

6- I ka ndaluar gruas të parfymoset për të huajit:

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Secila grua që del nga shtëpia e saj e parfymosur, kalon pran burrave që tia nuhasin aromën, ajo është lavire". (sahih, Nesaiu).

7- Ndalimi i përzierjes së gjinive dhe vetmimi i një burrit të huaj me një grua të huajë:

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Keni kujdes e mos hyni në mes të grave. I thanë: e ç' thua për hyrjen e vëllaut të burrit? Tha: kjo është si vdekja, kjo është si vdekja, kjo është si vdekja". (Buhariu).

"Çdo herë që vetmohet një burrë me një grua, i treti është shejtani". (sahih, Tirmidhiu).

8- Sherijati e ka bërë të ligjshme publikimin e martesës dhe praninë e dëshmitarëve prej kushteve të martesës.

Po ti implementonin këto rregulla njerëzit në jetën e tyre të përditshme, do të jetonin në harmoni dhe lumturi, mirëpo kur i lanë këto porosi edhe burrat edhe gratë, edhe të rinjtë edhe të rejat, na ndodhin fatkeqësi dhe prishet rehatia dhe siguria e shoqërisë.

Reziku i shikimit të pakontrolluar

Dera kryesore e poshtërsisë dhe imoralitetit është shikimi i pakontrolluar, qoftë direkt në realitetin e përditshëm të jetës sonë ose nëpërmjet kanaleve të ndryshme satelitore ose nëpërmjet internetit.

Fatkeqësisht shumë familjar dhe njerëz në vend se të kontrollojnë këto mjete, ata edhe ma shumë i lirojnë dhe nuk i kontrollojnë dhe me këtë bëhen shkak për devijimin e fëmijëve të tyre.

Pronarët e internet kafeneve, në vend se të vëndojnë programe që i kontrollojnë kompjuterat e tyre, ata përkundrazi veprojnë që tua lehtësojnë edhe ma shumë këto shërbime. Ata veprojnë për të fituar ma shumë, mirëpo e tërë kjo shkon në llogari të moralit të popullit tonë.

Pa dyshim se kur një adoloshent do të

hyjë në ato faqe, kjo do tia ngacmon epshin dhe do ta stimulojë për zbatim të asaj që e sheh edhe në praktikë. Kësaj sigurisht se ia ndihmon edhe shejtani, edhe do të mundohet që këtë nevojë ta shfryn në mënyrë të ndaluar fetarisht, ose me gjëra për të cilat ai mendon ndoshta se janë shërim, kurse aty qëndron sëmundja edhe më e madhe.

Kjo lind dëshirën për vizitë të vendeve të pista, siç janë diskotekat e ndryshme, kafetete, e shumë vende të posaçme për degjerim moral.

Pa dyshim se kjo mënyrë e pakontrolluar e shërimit të këtij problemi shkakton probleme psikike dhe pasoja negative në zhvillimin e personalitetit të tij.

Na dhemb zemra kur shohim se rinia, në kulmin e fuqisë dhe elanit të tyre, në vend se të miret me studim dhe prodhim, ai miret dhe preokupohet me epshin e tij, bëhet skllav i epshit të vet, synimi i tij final është kërkimi i vajzave dhe vizita e vendeve të pista. Kjo është brenga e tij kryesore, për te jeton, mendon dhe pushon. Vepron që tia plotëson dëshirat e saja, haron Krijuesin e vet, haron namazin dhe adhurimet e tija, haron familjen dhe shoqërinë.

Koka i është mbushur me vrapimin pas këtij instikti, andaj nëse njeriun nuk e udhëheq mendja, ate e udhëheq epshi kah të dëshirojë.

Cilat janë frytet që i sjell kjo sjellje:

Një: Strese dhe frikë që e kaplon nga çdo anë. Frikë që mos ti ikin vajzat, frikë nga turpi, frikë nga sëmundjet e ndryshme, etj.

Dy: Dekoncentrim dhe mologjikim i shëndoshë, sepse epshi ia ka sunduar mendjen.

Tre: Dobësia e rezultateve ideologjike dhe shkencore, sepse mendja e tij është e preokupuar me gjëra tjera, ka personalitet të thye dhe trupi i është lodhur.

Katër: Kallje epshore, ngacmim i instiktit, ky njeri i ngjan atij që pi ujë deti, aq sa ma shumë pi, aq ma tepër i shtohet etja.

Pesë: Nënçmohet dhe poshtërsohet duke tentuar të fiton sipmatinë e vajzave.

Gjashtë: Dobësia fizike e tij.

Shtatë: Mërija, ikja nga përgjegjësia, mosdurimi, ndjeshmëria e tepruar, hidhërimi për shkaqet më të vogla, ngushtica e gjoksit, ngërçe nervore dhe sëmundje psikike.

Tetë: Humbja e kohës në kënaqësi momentale, harxhimi i rinisë në vrapim pas epsheve.

Nëntë: harxhimi i sasisë së madhe të pasurisë, të cilat mund të harxhoheshin në shumë projekte të dobishme si për këtë jetë si për ahiret.

Dhjetë: Krimi i zinasë është borxh, të cilin e ka ai që bën zina, do ta kthen këtë borxhë në familjen e vet.

Njëmbëdhjetë: Dobësia e vullnetit për të mirë dhe dobi në mënyrë shkallëzore, sundimi nga epshi, derisa të bëhet skllav i epshit, i cili duke kërkuar të çlirohet nga kufizimet fetare dhe shoqërore, fitoi lirinë, sikur të papagallit, i cili gjindet në kafaz të arit, ose qenit, i cili është i lidhur me zinxhir të arit.

Dymbëdhjetë: Hidhërimi dhe mllafi i All-llahut, ardhja e fatkeqësive dhe defekteve, mosbërëqeti në pasuri, ymër dhe fëmijë.

Trembëdhjetë: Urrejti e familjes dhe farefisit, moskujdesi për zbatimin e obligimeve dhe mosdhënia rëndësi përgjegjësive.

Të vërtetën e thotë All-llahu kur thotë:

"E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kiametit do ta ringjall të verbër". (Taha: 124).

E lusim All-llahun të na shtojë dijen dhe besimin!

E lusim All-llahun të na shtojë nderin dhe moralin!

E lusim All-llahun të udhëzojë rininë tonë!

E lusim All-llahun të na mbrojë nga sprovat që i dimë dhe që nuk i dimë!

E lusim All-llahun që të na dhurojë të mirat e dynjasë dhe të ahiretit!

Amin!

Përgatiti: Bekir Halimi

Gruaja dhe familja

Arti i të dëgjuarit

Nëse një person fillon të ju tregojë, qoftë personalisht qoftë në prezencë të të tjerëve, diçka që ju mund ta dini shumë mirë, ju duhet të bëni sikur ju nuk e dini. Mos nxito për të treguar diturinë tënde ose për të ndërhyrë në bisedë. Në vend të kësaj tregohu i vëmendshëm dhe i përqëndruar për bisedën.

Tabi'ini i nderuar Imam Ata Ibën Ebu Rabah ka thënë: "edhe kur një djalë i ri do të më tregonte mua diçka që unë ndoshta mund ta kem ditur përpara se ai të ketë lindur".

Halid Ibën Safuan el-Tamimi i cili ka prezentuar kohën e dy halifeve; ate të Omer Ibën Abdul Aziz dhe ate të Hisham Ibën Abdul Melik, ka thënë: "Nëse një person të tregon ty diçka që ti e ke dëgjuar ose lajmet të cilat të kanë ardhur kohë më përpara mos

e ndërpre atë për të shfaqur diturinë tënde ayre që janë të pranishëm. Kjo është një sjellje e keqe dhe e shëmtuar".

Imami i nderuar Abdullah Ibën el-Kurejshi el-Masri një shok i Imam Malikut, El-Lejth Ibën Saudit dhe el-Thaurit ka thënë: "Nganjëherë një person do të tregonte një histori që unë e kisha dëgjuar përpara se prindërit e tij të ishin martuar, sërrish unë e dëgjoja sikur unë të mos e kisha dëgjuar atë asnjëherë më përpara".

Ibrahim Ibën el-Xhuneid ka thënë: "Një njeri i urtë i ka thënë djalit të tij: "Mëso artin e të dëgjuarit siç mëson artin e të folurit".

Të dëgjuarit mirë nënkupton mbajtjen e kontaktit me sy dhe duke e lejuar folësin të mbaron të folurin dhe duke u përmbajtur nga nevoja juaj për ta ndërprerë bisedën e tij.

Marrë nga: "Islamic manners"
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
25.6.2004

Babi, mi jep 10 euro!

Një njeri u kthye vonë prej pune, i lodhur, i irrituar, e djali i tij 5 vjeçar ishte duke e pritur te dera.

"Babi, a bën një pyetje?"

"Po, me siguri, çka të intereson?" ia ktheu ai.

"Babi, sa para i fiton për një orë punë."

"Ajo nuk është puna jote! Pse të intereson diçka e tillë?" u përgjigj njeriu i nervozuar.

"Unë kam dëshirë ta di. Të lutem më trego, sa fiton për një orë punë?" ia ktheu djali i vogël.

"Nëse e ke patjetër ta dishë, unë fitoj 20 euro për orë."

"Oh" u përgjigj djaloshi duke e ulur kokën. Pastaj ngriti kokën dhe tha: "Babi, mi jep 10 euro, të lutem!"

Babai u tërbua. "Nëse të intereson se sa

para fitoj vetëm që të mundesh ti huazosh prej meje për të blerë ndonjë lodër qesharake apo ndonjë marrëzi tjetër, atëherë ik te dhoma yte dhe shtrihu në krevat. Mendo pak se pse je kaq egoist. Unë punoj orë të tëra çdo ditë dhe nuk kam kohë për lojëra fëmijërore.”

Djali i vogël shkoi te dhoma e vet dhe e mbylli derën. Babai u ul dhe filloi edhe më tepër të hidhërohet nga pyetjet e djalit të tij të vogël. Si guxoi të pyesë diçka të tillë vetëm për të përfituar para. Pas një ore, ai u qetësua, dhe filloi të mendoj se ndoshta kishte qenë shumë i ashpër me djalin e vet. Ndoshta ai me të vërtetë kishte diçka për të blerë me ato 10 eurot, dhe ai me të vërtetë nuk e kishte zakon të lypte para. Ai u ngrit dhe shkoi te dhoma e djalit të vet dhe e hapi

derën. “A je duke fjetur bir? Pyeti ai.

“Jo babi, unë jam zgjuar” u përgjigj djali.

“Kam menduar, ndoshta isha shumë i ashpër me ty më herët,” tha babai. “Ka qenë një ditë e gjatë dhe unë e nxora te ti nervozën time. Ja ku i ke 10 eurot që i kërkoje.”

Djali u ngrit në këmbë i buzëqeshur. “Oh, të falenderoj baba” tha ai. Pastaj, e futi dorën nën jastëk dhe i nxori disa monedha. Babai kur e pa se djali i tij paska patur para filloi të nevrifikoset përsëri. Djali i vogël i numëroi parat ngadal, pastaj e drejtoi shikimin kah ai.

“Pse kërkoje para prej meje kur paske pasur?” gjëmoi babai.

“Sepse nuk kisha para të mjaftueshme, e tani kam”, u përgjigj djali i vogël. “Babi, tash i kam 20 euro... A mund ta blej një orë nga koha jote?..”

Marrë nga: Islamway
Përktheu: Omer Islami
2.7.2004

Këshillat e Lukmanit drejtuar të birit të tij

Kur’ani fisnik përmban dhjetë këshilla të çmueshme që i’a dha Lukmani, alejhis-selam, djalit të tij. Ja në vijim këto këshilla, të cilat u’a ofrojmë prindërve muslimanë, që ata t’ua komunikojnë ato fëmijëve të tyre, familjes dhe pjestarëve të shoqërisë, e që ata të mundën ti praktikojnë ato. Nëse këto këshilla të vlefshme i pasojmë dhe i praktikojmë, atëherë të gjithë ne do të jemi në rrugën e drejtë, e cila të dërgon në Xhennet. Llukmani, alejhis-selam, në disa fjalë e ka përmbledhë mënyrën për të arritur suksesin në këtë jetë dhe në Ditën e Gjykimit.

1. Lukmani, alejhis-selam, i’a tërhjek vërejtjen djalit të tij për zullumin (padrejtësinë) më të madhe që njeriu mund ta bën: “...O djali im, mos i përshkruaj All-llahut shok,

sepse idhujtaria është padrejtësi më e madhe!” [Lukman: 13]. Lukmani e thirrë djalin e tij duke i thënë “O djali im”, sepse kjo i’a tërhjek vëmendjen djalit që ai të mundet ta dëgjon babin me vëmendje. Pastaj i’a tërhjek vërejtjen djalit të vet për Teuhidin. Shirku, Lukmani tha: “është padrejtësia më e madhe”.

Prandaj, ai i cili i bën shok All-llahut në adhurim, i bën padrejtësi All-llahut, Poseduesit dhe Krijuesit të gjithësisë. Dënim i madh është i caktuar për mushrikun (atë që bënë shirk): Ai i nënshtrohet hidhërimit të All-llahut dhe dënimit të përhershëm në zjarr.

2. Lukmani ia përkujton djalit të tij të drejtat e prindërve: “Ne njeriu e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindit të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas

mundi dhe pas dy viteve ia ndau gjinin. (E porositëm) Të jeshë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj.” [Lukman: 14].

Lukmani e përmend varshmërinë që e ka foshnja nga nëna e saj për dy vjet. Falenderoje All-llahun, pastaj prindërit tu dhe dije se kthimi është tek All-llahu.

“E nëse ata të dy tentojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të keshë mirëkuptim ndaj tyre...” [Lukman: 15]. Nëse prindërit janë jobesimtarë, mos e paso rrugën e tyre: të drejtat e All-llahut janë në rend të parë. Mirëpo, përderisa janë gjallë, sillu mirë në lidhje me çështjet e kësaj bote.

3. Pastaj Lukmani i tregon për fuqinë e All-llahut: “O djali im, s’ka dyshim se edhe nëse ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë e fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, All-llahu do ta sjellë atë, se All-llahu është i butë dhe hollësisht i informuar.” [Lukman: 16]. Dituria e All-llahut është aq e përsosur, sa që çdo gjë që ekziston, e madhe qoftë apo e vogël, është në dijen dhe kontrollin e Tij. Lukmani mundohet t’a impresionon djalin e Tij duke i’a përkujtuar kontrollin absolut që ka All-llahu mbi mbretërinë e Tij.

4. Një këshillë e madhe e Lukmanit drejtuar djalit të tij, është që ai ta falë namazin rregullisht, në kohë dhe në mënyrën më të mirë: “O djali im, fale namazin...” [Lukman: 17].

Namazi është lidhja direkte në mes muslimanit dhe Krijuesit të tij. Prindërit duhet të kujdesen shumë që ti thërrasin dhe ti mësojnë fëmijët e tyre ta falin namazin.

5. Lukmani e këshillon djalin e tij: “...urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat...” [Lukman: 17].

Nëse çdo musliman e çon në vend këtë urdhër, atëherë në shoqërinë muslimane

nuk do të ketë vend për të keqen.

6. Lukmani e këshilloi që të jetë i durueshëm gjatë kryerjes së këtyre veprave, dhe gjatë çdo gjëje në jetë: “...përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të preferuara.” [Lukman: 17].

Durimi është vepër e mirë dhe urdhër i All-llahut për të cilin ka shpërblim të madh.

7. Madhështia është cilësi që i takon vetëm All-llahut

Krijuesi dhe Poseduesi i gjithësisë është i Vetmi që meriton të ketë kibër. All-llahu u kërcënohet njerëzve mendjemdhej (atyre që janë kryelartë, ja lidhin lart që në vete kanë kibër) se do t’i dënoj në Xhehenem: “Dhe mos shtrembëro fytyrën tënde prej njerëzve (me mendjemadhësi)...” [Lukman: 18].

8. Të jesh i matur: “...mos ec nëpër tokë kryelartë, se All-llahu nuk e do asnjë mendjemadh e që shumë lavdërohet.” [Lukman: 18].

All-llahu nuk i don pra njerëzit që janë arrogant dhe mendjemdhej.

9. Të jesh i matur në ecje dhe sjellje është gjithashtu një nga këshillat e Lukmanit: “Të jesh i matur në ecjen tënde...” [Lukman: 19].

Islami ofron rregullë për sjellje në çdo aspekt të jetës. Edhe mënyra se si muslimanët ecin dhe flasin është e rregulluar. Islami ofron direktiva në këtë çështje të cilat rezultojnë sjelljen më të mirë dhe do të jenë shkak për të fituar respektin.

10. Lukmani i’a përkujton djalit të tij se nëse është i ashpër në të folurit e tij, zëri i tij do t’i përngjajë zërit të gomarit. Britma nuk i përfiton zemrat, përkundrazi, ajo do ti ofendoj dhe armiqësoj njerëzit: “...ule zërin tënd, se zëri më i egër është zëri i gomarit.” [Lukman: 19].

Lukmani tregon urtësi të madhe në këshillat që i’a drejton djalit të tij. Nëse prindërit musliman e marrin këtë shembull, dhe fëmijët e tyre i praktikojnë këto këshilla, atëherë me lejen e All-llahut, ummeti ynë do të jetë i suksesshëm.

Marrë nga: islaam.net

Përktheu: Omer Islami

Dy fjalë nga zemra, motra–motrës

Subhana'ALLAH, a thua jemi sa duhet të vetëdijshëm për njëmendësinë e jetës, për qenësinë tonë dhe mbi rëndësinë e të qenit tonë si halif?

Sa herë ia shtrojmë këtë pyetje vetvetës sonë, në heshtje ose publikisht?

A ka jeta jonë kuptim, motra, vëllezër, po e haruam qëllimin e të qenit tonë?

Ato dromca jete përditshmerisë së nënave, motrave, bijave, kalamajve, në Palestinë, Irak, Afganistan, Çeçeni, dje pardje në Bosnje dhe Kosovë e hapësiren mbarëshqiptare, dhe ku jo në botën islame e joislame, në gjithë tokën e ALLAHUT, të këtij planeti të vogël, do të duhej të na shtyenin të meditojmë qoft edhe vetëm nga një çast në ditë! Dhe ky meditim do të na shtyente t'a vrasim sadopak ndërgjegjen tonë shpesh të përgjumur ose apatike!

E nëse jo, nëse kjo nuk arrinë të prekë ndërgjegjen tonë, atëherë motra dhe ju vëllezër ku qëndroka kuptimi i kësaj jete të shkurtër kalimtare? A thua jemi në sprovë apo vetëm djerakohës të kësaj bote? Kush duhet të ket përgjegjësi nëse jo vet ne!!!

A thua tërë fokusi ynë edhe sot duhet të kufizohet në komoditetin, begatitë e kësaj bote të rreme, fëmijë, pa mos u shqetësuar fare për misionin e lartë si halif t'ALLAHUT!

A benë t'a harojmë kaq shpejt të kaluarën e idhtë të dje pardjeshmes, plagët e së cilës po i vuajmë ende (shumë prej nesh)? A duhet të

ndalemi vetëm në hallet tona të përditshme ose edhe të habitemi pas lakmive të kësaj bote?

(Secili(a)le t'i përgjigjet në heshtje këtyre pyetjeve nga thellësia e tij e padukshme!!!!!!).

Do t'ishim në lartësi të detyrës sonë fisnike, si krijesat më të dashura dhe më të nderuara t'ALLAHUT, nëse vetëdijsohemi zëshëm për qenësin tonë, sidomos si musliman, nëse nuk do të habiteshim pas dynjallëkut me kotësira, nëse çdo mendim, veprim yni do t'ishte në harmoni me thirjen tonë të brendshme (shpirtërore); të reagojmë denjësisht ndaj padrejtësive, shtypjes, dhunës, t'ua shtrijmë dorën nevojtarve, hallexhinjëve aq sa mundemi, t'i kujtojmë jetimët, të shtypurit, t'ua drejtojmë një lutje të robëruarve, të bëjmë dy fjalë të sinqerta miradije motrave, nënave, bijave muslimane të shumëvuajtura por dinjitoze, kudo ku ndodhen!!

E nëse të gjithë do të vepronim kështu, motra, vëllezër, do të ndjekshim rrugën e Pejgamberit tonë të dashur, dhe nënave të besimtareve te para muslimane, Hatixhe, AISHE, Fatime, Kulsum e shumë të tjera, që lanë dunjallëkun për ahiretin! Kështu do të shpresonim takimin me ALLAHUN; do të qetësonim e paqëtonim zemrën, e shpirtin tonë, pa llogaritur kundëshpërblim të kësobotshëm!

Rrugët për fituar kënaqësinë e ALLAHUT, duke kryer obligimet tona, janë të shumta, të dëshmohe mi duke vepruar!

L.Kullashi

Imam Zuferi

Imam Zufer ibën Hudhejl, fekihu, muxhtehidi, dijetari i devotshëm. Njëri nga përfaqësuesit më të dalluar të shkollës juridike Hanefite, al-lameja dhe gjeniu Ebu Hudhejl, Zufer ibën Hudhejl ibën Kajs ibën Selem El Anberi.

Ka lindur në vitin 120 H në Asbahan (Isfahan). All-llahu, subhanehu ve teala, deshi që ky njeri të përfiton nga shumë dijetarë në krye e të cilëve ishte Imam Ebu Hanifeja, rahimehull-llah. Nga vargu i mësuesve prej të cilëve përfitoi dije do t'i përmendim; El A'mesh-in, Ismail ibën ebi Halid-in, Muhammed ibën Is'hak-un, Haxhaxh ibën Ertah-un dhe gjeneratën e tyre.

Nga Imam Zuferi përfituan shumë nxënës prej të cilëve me përmendje do t'i veçojmë: Hassan ibën Ibrahim El Kirmani, Ekthem ibën Muhammed, Abdul Vahid ibën Zijad, ebu Nu'ajm El Mulai, En Nu'man ibën Abdus Selam et Tejmi, Hakem ibën Ejjub, Malik ibën Fudejk etj. Shumica e nxënësve të tij ishin mocanikët e tij.

Për vendin e tij të lartë mjaftë flasin fjalët e dijetarëve të cilët e përshkranin me epitetet më të lartë;

Ebu Nu'ajm El Mulai dhe Jahja ibën Me'in-i thonin: Ishte i beshueshëm, besniku...

El Hasen ibën Zijad El Fekihu thoshte:

Zuferi dhe Davudi Et Ta'i kishin qëllimin e njejtë, të bëhen dijetarë. Davudi e braktisi fikhun dhe iu përkushtua adhurimit kurse Zuferi i bashkoi, fikhun dhe adhurimin.

El Hasen ibën Zijad El Lu'lui thoshte: Kur e shikoja ndonjë fekih se si debaton me Zufferin, e mëshiroja.

Ebu Nuajmi thoshte: Kur takohesha me Zuferin më thoshte eja të ti shoshiti hadithet që i ke dëgjuar.

Dhehebiu kështu e përshkruan: Ishte prej detrave të fikhut, prej të zgjuarve të kohës, mësoi tek Ebu Hanifeja dhe ishte nxënësi më i madh i tij, bashkoi dijen me punë, e njihte hadithin në mënyrë precize. Ishte imam, i drejtë gjatë hulumtimit, pasues i sunnetit.

Thoshte (Imam Zuferi): Ai që ulet (për të ligjësuar dhe për të dhënë fetva) para kohës, do të nënçmohet.

I dinte hadithet e deroguar dhe deroguesit e tyre.

Ishte i drejtë dhe respektonte hadithin e saktë më të cilin punonte dhe i këshillonte njerëzit të punojnë me të.

Pas jetës së shkurtër në këtë botë ndërroi jetë në vitin 158 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë. Amin.

Imam Edh Dhehebi, Sijer A'lam Nubela, vëll. 8, fq. 38-41

Shqipëroi: Talha Kurtishi
Imam Edh Dhehebi,
25.6.2004

Imam Ebu Theuri

Fekihu i Bagdadit, nxënësi i Imam Shafi'iut, Imami, Hafidhi, Muxhtehidi, myftiu i Irakut. Besniku, i devotshmi, argumenti...Autori i librave që hadithit ia bashkangjitën fikhun (kuptimin)

Quhet Ibrahim ibën Halid ibën Ebil Jeman El Kelbi, Ebu Theur El Bagdadi. Lindi diku rreth vitit 170 H dhe pati fatin të përfiton nga imamët e kësaj periudhe të bekuar. Në fillim u shoqërua me ithtarët e mendimit të lirë (Ehlur-rejj) që më vonë të takohet me Imam Shafi'iun i cili ndikoi dukshëm në përcaktimin e tij shkencor.

Nga mësuesit e tij me do t'i veçojmë: Sufjan ibën Ujejne, Abide ibën Humejd, Ebu Mu'avije Ed Darir, Veki' ibën El Xherah, Jezid ibën Harun, Reuh ibën Ubade dhe Ebu Katan. Më i dalluar prej këtyre ishte Imam Shafi'iu.

Nga dija e tij të gjërë përfituan imamë siç ishin: Ebu Davudi, Ibën Maxhe, Ebul Kasim El Begavi, Ahmed ibën El Hasen Es Sufi, Muhammed ibën Is'hak Es Ser-raxh dhe shumë tjerë.

Për dijen e tij të gjërë dëshmojnë fjalët e

dijetarëve:

Imam Ahmedi thoshte: E njoh si pasues të Sunnetit prej kohe. Ai tek unë është në gradën e Sufjan Eth Theuriut.

Shpesh herë kur e pyetnin (Imam Ahmedi) thoshte: Pyetni tjerët, pyetni fukahatë, pyetni Ebu Theurin.

Sulejman Esh Shadhekuni thoshte: Shkruaj mendimet e Imam Shafi'iut dhe takohu me Ebu Theurin mos ia lejo vetës që të mos përfitosh nga ai.

Imam Nesaiu: Besniku, njëri prej fukahave...

Ebu Hatimi kështu e përshkruante: Njëri prej imamëve të botës, fekihu, alimi modest, njeriu plot virtyte. Shkroi librat të shumtë, mbroi sunnetin dhe e komentoi atë. All-llahu e mëshiroftë...

Edh Dhehebiu përshkrimin e tij e përmbloshi në këto fjalë: Ai padyshim ishte Huxhxhe (argument).

Ndërroi jetë në muajin Safer të vitit 240 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë. Amin

Shih: Sijer A'lam En Nubela, vëll.12, fq.72-76
Talha Kurtishi,
2.7.2004

Imam Ibën Salah

Njëri nga dijetarët fisnik të kohës së tij, alimi në lëmitë e tefsirit, fikhut, gjuhës dhe veçanërisht në lëminë e hadithit dhe shkencat përcjellëse të hadithit. Imami i devotshëm dhe shembëlltyra e dijetarëve pas tij. Quhet Ebu Amër Uthman ibën Abdur Rahman ibën Uthman ibën Musa ibën Ebi Nasr El Kurdi Esh Shehrezuri i njohur me ofiqin Ibën Salah Esh Sherhani Esh Shafi'ij.

Ka lindur në vitin 577 H në vendin Esh Sherhan një prej fshatrave afër Irbilit (rajoni të cilin e banon popullsi kurde), Iraku verior.

Mësimet e parë në fikh i morri para atit të tij Salah i cili ishte një prej dijetarëve të dalluar në kohën e tij. Më vonë udhëton në Mosul ku vazhdon kërkimin e diturisë dhe specializon librat e medhhebit Esh Shafi'ij. Udhëtoi gjithashtu edhe në Bagdad, Hemedhan, Nejsabur, Damask dhe Horasan ku mësoi lëmitë e hadithit.

Nga mësuesit e tij do t'i përmendim: Ubejduallah ibën Semin, Nasrullah ibën Selame, Mahmud ibën Ali El Musili, Abdul Mushsin ibën Et Tusi, Ebul Fadl ibën Mugrim, ebu Mudhaffer ibën es Sem'ani, Muveffekudin El Makdisi, Fahrudin ibën El Asakir dhe shumë tjerë.

Nga nxënësit e tij më të dalluar janë: Fahrudin ibën Umer El Kerxhi, Zejnuddin El Faruki, El Kadi Shihabuddin El Xheuzi, El Hatib Sherefuddin El Azzavi etj.

Më pas filloi të japë mësim në medresenë "En Nasirije" në Kuds të cilën e ndërtoi Salahuddin El Ejjubi. Më vonë u vendos në postin e mësuesit në medresenë Er Revvahije në Damask.

Kur mbreti El Eshref ibën Ejjub ndërtoi shkollën "Darul Hadith" filloi ligjëratat e ha-

dithit në të. Si mësues gjithashtu punoi edhe në disa shkollë.

Ibën Halikani kështu e përshkruan: Kishte dije të madhe dhe ishte shumë i devotshëm. E vizitova në Damask dhe e shoqërova një vit e gjysëm...

Ishte Imam i madhë, fekih, muhaddith, zahid i modest, mësues i suksesshëm dhe i dobishëm. Banoi në Damask dhe në të e ktheu kohën e të parëve tanë, e zbukuroi me kopshte të dijës nga pemët e të cilëve ushqeheshin kërkuesit e dijës.

Edh Dhehebiu thotë: Ishte pasues i selefit, me besim të pastërt larg shtrembërimeve të apologetëve. Besonte në tekste të shpalljes dhe nuk thellohej në te'vil. I respektuar, me pamje të bukur, i mirëpritur nga mbretërit dhe sulltanët...

Thoshte: Në gjumë u inspirova me këto fjale: Largohu nga kërkimi prej njerëzve sepse çdo ditë e re vjen më rrizkun e tij. Kërkimi prej njerëzve largon bukurinë e fytyrës. Sa e mirë është ndihma që ia ofron atij që ka nevojë...

Hiseja të cilën ta ka caktuar All-llahu është e ytja. Mos e përshpejto para kohës që të goditesh me humbje të shpresës nga mëshira e All-llahut. All-llahu e di më së mirë.

Shkroi libra të shumta nga të cilat më të njohur janë:

Fetava ibën Salah në të cilën janë tubuar fetvatë e tij dhe

Ulumul Hadith i cili është libri i parë në terminologjinë e hadithit.

Jeta e tij përfundoi me 25 Rebi'ul Ahir 643 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Talha Kurtishi

Ibën Haxher El Askalani

Njëri nga dijetarët më eminentë në lëmitë e hadithit dhe historisë, autori i afro njëqind veprave shumica e të cilave është në lëminë e hadithit. Nuk ka asnjë segment të shkencave të hadithit për të cilën nuk ka shkruajtur libër që është referencë e paevitueshme për hulumtuesit. Komentimi i tij që ia bëri Sahihul Buhari në librin e tij Fet'hul Bari është libër bazë e shumë studimeve.

Quket Ebul Fadl Shihabuddin Ahmed ibën Ali ibën Muhammed ibën Muhammed ibën Ali ibën Mahmud El Kinani El Askalani El Misri Esh Shafi'ij. Rrjedh prej fisit Benu Kinane që jetoi në qytetin El Askalan në Palestinë.

Ky gjeni u lind në Egjipt në vitin 773 H/1372 G. Që si fëmijë mbeti pa përkujdesjen e babës i cili ndërroi jetë kur ai kishte katër vjet. Përkujdesjen për të e morri përsipër një nga tregtarët më të njohur në atë kohë Zekijjuddin El Harubi.

Kërkimin e dijës e fillon prej moshës pesëvjeçare duke e mësuar Kur'anin para mësuesit Sadrudin Es Sifti. Në moshën nëntëvjeçare bëhet hafidh i Kur'anit. Gjatë Ramazanit të vitit 805 H ai ua fal si imam namazin e teravisë muslimanëve në Mesxhidul Haram në Mekke.

Si fëmijë i ka mësuar përmendësh librat "Umdetul Ahkam" të El Hafidh El Makdisiut, "El Elfijje" të el Hafidh El Irakiut, "El Havi Es Sagir, "El Muhtesar" etj.

Përpos në Egjipt ku është rritur, ai vizitoi edhe vende tjerë në kërkim të diturisë si: Hixhazi, Jemeni, Palestina etj.

Pasi që e mësoi Kur'anin dhe Texhvidin, vazhdoi mësimin e hadithit duke e lexuar Sa-

hihun e Buhariut në Mekke para mësuesit Afifuddin Abdullah En Neshavuri. Këtë vepër e lexon edhe para Salah Ebu Ali Ez Ziftavi dhe Abdur Rahman ibën Abdul Vehhab ibën Rezin.

Nga mësuesit e tij do t'i përmendim edhe: Ebul Hamid El Mekki, 'Izz ibën Xhema'a, shejhul Islam Siraxhuddin El Belkini, Muhammed ibën Ali El Kattan, El Hejthemi, Et Tehuhi dhe Ebul Fadl El Iraki ndikimi i të cilit e determinoi për t'u specializuar në lëminë e hadithit.

Para Mexhduddin El Fejruzabadi mësoi gjuhën dhe letërsinë arabe.

Sipas Es Sehaviut askush si Ibën Haxher nuk është takuar me aq shumë dijetarë ekspertë të lëmvive të ndryshme. Mësuesit e tij i ka përmendur në "El Mexhme'ul Muesses bil mu'xhem El Mufehres".

Sipas gjitha referencat Ibën Haxheri ishte dijetari më respektabil tek i cili mësuan shumë nxënës të dijës. Si nxënës më të dalluar do t'i përmendim: Shemsuddin Es Sehavi, Zekerijja El Ensari, Xhemaluddin El Kalkashendi, Ahmed ibën Ebu Bekr El Busiri, Burhanuddin El Beka'i etj.

Punonte palodhshëm në shërbim te fesë. Plotë njëzet e një vjet ishte në postin e kadisë. Punonte edhe si ligjërues në disa shkollë. Ka qenë hatib fillimisht në xhaminë e Az'harit që më vonë të transferohet në xhaminë e Amër ibën El As-it, radijall-llahu anhu. Gjatë punës si përgjegjës i bibliotekës El Mahmudije përpiloi katalogun e dorëshkrimeve në të.

Kujdes të veçantë i kushtoi edhe shkrimit. Ganim ibën Abbas El Ganim redaktori i

botimit të librit Lisanul Mizan përmend listën prej 191 titujve që i ka shkruar Ibën Haxheri.

Vepra më e rëndësishme që e shkroi është "Fet'hul Bari", vepër kapitale në të cilën komentoi hadithet që i ka përmbledhur Imam Buhariu në sahihun e tij.

Këtë vepër Sheukaniu e krahason me fitoren e muslimanëve ndaj mushrikëve gjatë çlirimit të Mekkes.

El Mubarekfuri thotë se kjo vepër është fjalor dhe enciklopedi e Sunnetit.

Në këtë vepër ai punoi plotë njëzet e pesë vjet (817 H-842 H). Nga veprat e tij do t'i përmendim edhe:

- Tehdhibu Tehdhib
- Takribu Tehdhib
- Lisanul Mizan
- El Isabe fi Temjizi Sahabe
- Bulugul Meram fi ehadith el Ahkam
- El Metalib el Alije bi zevaid El mesanid Eth Themanije
- El Isabe fi temjizi Sahabe
- Te'xhilul Menfe'a
- Ed Durer El Kamine fi A'jan El Mieti Eth Thamine
- Nuz'hetul Fiker fi istilah Ehilil Ether
- Ed Dibaxhe

- Tegliku Ta'lik
- It'haful Mehere bil Fevaid El Mubtekere min Etrafil Ashere dhe shumë tjerë...

Të tjerët për Ibën Haxher-in:

Kur para vdekjes e pyetën El Hafidh El Iraki-un kush do të të trashigon (në dije) pas vdekjes? Tha: Ibën Haxheri, pastaj djali im Ebu Zur'a pastaj El Hejthemi-u.

Ibën El Imad-i kështu e përshkruante: Dijetar i madh i Islamit, autoritet i jashtëzakonshëm, Emirul mu'minin në hadith dhe hafidhi i kohës së tij.

Et Tekij El Fasi-u dhe Burhan El Halebi-u thonin: Nuk kemi takuar të ngjajshëm me të.

Esh Sheukani: Hafidhi i madh dhe i njohur i hadithit, i dalluar në njohjen e hadithit dhe shkencave të tij. Në mënyrë precize i njëjtte mangësitë e fshehta të hadithit.

Ibën Fejd El Mekki: Ka shkruar libra me vlerë të jashtëzakonshme dhe më dobi të shumëfishta. Me këto libra ua kaloi dijetarëve bashkëkohorë.

Jeta e tij në këtë botë përfundoi në vitin 852 H/1449 G në Kairo. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Përktheu: Talha Kurtishi

Tema: Pastrimi dhe namazi i të sëmurëve

Numri: 1182 Data: 12.07.2004

Pyetje: Çka kanë për obligim të sëmurit lidhur me pastërtinë dhe namazin?

Përgjigje: Mënyra e pastrimit të të sëmurit

Themi: Këto janë ca fjalë të shkurtëra për të treguar se çka kanë për obligim të sëmurit lidhur me pastërtinë dhe namazin. Ngase i sëmuri ka dispozita të veçanta për shkak të gjendjes në të cilën gjindet, për të cilën gjendje sheriati Islam është kujdesur. All-llahu, subhanehu ue teala, e ka dërguar Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, me fe të pastër e të lartë e cila është e vënduar mbi themele të lehtësimit. All-llahu, azze ue xhel-le, ka thënë: "...dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi...". (el-Haxh 78); "All-llahu dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështërsim për ju". (el-Bekare 185) dhe ka thënë: "Andaj, sa të keni mundësi keni frikë All-llahun, dhe dëgjoni e respektoni...". (et-Tegabun 16). Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: "Feja është lehtësim"; (Buhariu (39)) dhe ka thënë: "Kur t'ju urdhëroj me diçka, veprone atë sa të keni mundësi". (Buhariu (7288); Muslimi (1337))

Sipas këtij rregulli themelor, All-llahu, azze ue xhel-le, ka bërë lehtësime në ibadetet e atyre që kanë arsye aq sa është nevoja, që të kenë mundësi ta adhurojnë All-llahun pa ndonjë problem apo vështirësi. E falënderimi i takon vetëm All-llahut.

"Si pastrohet i sëmuri?"

1. E ka obligim të pastrohet me ujë, të merr abdest nga prishja e vogël e abdestit dhe të merr gusëll nga prishja e madhe (xhunubllëku).

2. Nëse ska mundësi të pastrohet me ujë nga pamundësia, nga frika e shtimit të sëmundjes apo vonimi i shërimit, atëherë merr tejemmum.

3. Mënyra e tejemmumit: Të prekë në tokë të pastër me duart e tij një herë, pastaj fërkon fytyrën e pastaj i fërkon duart mes vete.

4. Nëse nuk mundet të pastrohet vetë, atëherë i ndihmon dikush të merr abdest apo tejemmum. Ashtuqë, ky personi tjetër prekë tokën e pastër me duart e tij dhe ia fërkon fytyrën dhe duart e të sëmurit. Sikurse, nëse nuk mundet të merr abdest t'i ndihmojë në marrjen e abdestit.

5. Nëse në ndonjë pjesë të trupit ka plagë, e lanë me ujë, në rast se uji e dëmton atëherë vetëm e fërkon një herë me dorë të lagur, e nëse edhe fërkimi e dëmton atëherë merr tejemmum.

6. Nëse ka ndonjë gjymtyrë të thyer, të lidhur me fashë apo të mbështjellur me gips, atëherë e fërkon atë me ujë dhe nuk e lan, poashtu ska nevojë për tejemmum kjo, sepse fërkimi e zëvendëson larjen.

7. Lejohet të merr abdest në mur ose në diç tjetër të pastër ku ka pluhur, e nëse muri është i lyster me diç që nuk e ka esencën prej toke sikurse boja, atëherë nuk lejohet të merr tejmum në atë mur, përveç nëse mbi të ka pluhur.

8. Nëse nuk mundet të merr tejmum në tokë, mur apo diç tjetër të pastër që ka pluhur, atëherë nuk prishë punë që t'i sillet një enë apo leckë me dhé, dhe të merr tejmum prej aty.

9. Nëse merr tejmum për një namaz dhe nuk e prish tejmumin deri në kohën e namazit tjetër, mundet të falet me tejmumin e parë dhe nuk ka nevojë ta përsërisë tejmumin, për shkak se ende është i pastër, dhe nuk ka ndodhë diç që ia prishë pastërtinë.

10. E ka obligim i sëmuri të pastron trupin nga flliqësirat, e nëse nuk ka mundësi, falet ashtu si është, namazin e ka në rregull dhe nuk duhet ta përsërisë.

11. E ka obligim i sëmuri që të falet me rroba të pastra, e nëse i flliqen rrobat atëherë duhet t'i pastrohen ose t'i ndrrohen me tjera të pastra, e nëse nuk ka mundësi, falet ashtu si është, namazin e ka në rregull dhe nuk duhet ta përsërisë.

12. E ka obligim i sëmuri që të falet në vend të pastër, e nëse i flliqet vendi, duhet patjetër të lahet ose t'i ndrrohet vendi ose të shtrohet diç e pastër mbi vendin e flliqur, e nëse nuk ka mundësi, falet ashtu si është, namazin e ka në rregull dhe nuk duhet ta përsërisë.

13. Nuk i lejohet të sëmurit ta vonon namazin e tij nga koha e vet për shkak të pamundësisë për pastrim, por pastrohet aq sa mundet dhe e falë namazin në kohën e tij edhe nëse ka ndonjë papastërti në trup, rroba apo në vendin ku falet, të cilat nuk mundet t'i largojë.

Muhammed ibën Salih el-Uthejmin

përktheu: Omer Berisha

(marrë nga libri "Fetva rreth shtyllave të Islamit"-Muhammed ibën Salih el-Uthejmin, libri është në proçes botimi nga ana e shtëpisë botuese "NuN")

12.7.2004

Gjendja jonë e dhimbshme

Shejhu ynë! E dimë këto ditë se Islami është i sulmuar në të gjithë rruzullin tokësor, pa asnjë kujdes nga qeveritë, ne çka duhet të bëjmë në këtë çështje? A kemi mëkat me të ndejturit tonë duke mos ndërmarrë diçka?

Përgjigje: (Muhammed Nasiruddin Albani)

Falenderimi i takon Allahut, Ate e falenderojmë, Atij ndihmë dhe falje i kërkojmë. Allahut i mbështetemi nga e keqja e shpirtave tanë dhe nga e keqja e veprave tona, kën e udhëzon Allahu nuk ka kush e devijon, e cilin e devijon Ai nuk ka kush që e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka hyjni përveç Allahut të vetmit, të pashoq, dhe dëshmoj se Muhammedi është robi dhe i Dërguari i Tij;

"O ju që besuat frigohuni Allahut në mënyrën më të denjë dhe assesi mos vdisni ndryshe përveçse si muslimanë" (ajet)

"O ju njerëz, frigohuni Allahut i Cili ju krijoi nga një shpirt dhe nga ai krijoi çiftin e tij e nga ato dy shpërndau shumë burra e gra dhe frigohuni Allahut për të cilin pyetni dhe për farefisn sepse Allahu është që ju vëzhgon mirë" (ajet)

"O ju që besuat, frigohuni Allahut dhe flitni fjalë të vërteta, ua përmirson juve veprat tuaja dhe ua falën mëkatet, e kush e respekton Allahun dhe të dërguarin e Tij ka fituar fitore të madhe" (ajet)

Më pas "Fjala më e mirë është fjala e Allahut, udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e sendet më të këqija janë ato të shpikurat dhe çdo e shpikur është bidat dhe çdo bidat çon në zjarr".

Pyetja, siç duket nga pamja dhe fjalët, si-

kur është më pak se ajo që e ka për qëllim ai që e thotë, me që ai thotë: rrijmë e nuk veprojmë diçka! E çka ka për qëllim ai me "diçka"? -jo diçka absolute, por diçka të kufizuar, sepse nuk ka kush që thotë: se muslimani duhet të jetojë siç jetojnë kafshët, nuk ndërmerr diç-sëpse ai është krijuar për diçka shumë të madhe, e ajo është të adhuroarit Allahun, të vetmin, e pashoq, prandaj le të mos qarkullojnë në mendjet e askujt pyetje të këtilla, se ai ka për qëllim që të mos ndërmerret asgjë, por se ka për qëllim që nuk ndërmerret diçka që përkon me realitetin që i ka rrethuar muslimanët nga të gjitha anët. Kjo pra është qëllimi i pyetjes e jo ajo që duket nga fjalët e pyetësit.

E në këtë ne përgjigjemi: Realiteti i muslimanëve sot nuk ndryshon as më shumë e as më pak nga ai që ka qenë da'veja islame në kohën e saj të parë, e me këtë kam për qëllim periudhën mekkase. Dhe çdonjëri prej neve e dijmë se ai që e bënte da'ven atëbotë ishte i dërguari ynë Muhammedi, alejhis-selam, e me këto fjalë dua të them se da'veja ishte e luftuar nga po i njëjti popull nga i cili ishte i dërguar edhe vet Pejgamberi, alejhis-selam, siç tregohet në Kur'anin fisnik.

Pastaj kur filloi da'veja të përhapet dhe të zgjerohet rrethi i saj në mesin e fiseve arabe, kur Pejgamberi, alejhis-selam, urdhëroi që të bëhet hixhreti nga Mekkeja në Medine, natyrisht që ne tani shënojmë me majet e lapsave sepse historia e hershme e islamit dhe biografia e Pejgamberit, alejhis-selam,

janë të njohura në mesin e shumicës së prezentëve ngase kam për qëllim-përmes kësaj rezyemeje të shkurtër-të arrij deri tek përgjigjeja në këtë pyetje.

Në bazë të kësaj, them: pasi që Muhammedi, alejhis-selam, e bëri hixhretin për në Medine dhe në këte e ndoqën disa sahabë të tij dhe filloi që t'i vëndosë qëllimet e themelimit të shtetit islam-atje në Medine-gjithashtu filloi një armiqësim në mesin e kësaj da'veje të re-gjithashtu në Medine-ku filloi kjo da've të afrohet te pragi i shtëpisë së krishterëve, e që ishte atëbotë Siria, në të cilën ishte Herakliti, perandori romak.

Atje u bë një armiqësi e re kundër da'ves edhe atë jo vetëm nga arabët e Gadishullit arabik por edhe nga vet krishterët e veriut-pra nga Siria, e pastaj u paraqit edhe një armik tjetër e ajo ishte Persia. Kështu da'veja u bë e luftuar nga të gjitha anët; nga mushrik në Gadishullin arabik, nga krishterët dhe jehudët nga disa anë dhe nga ana e Persisë, ndërmjet të së cilës dhe të krishterëve ka pasur armiqësi të përbetuar siç mësojmë nga Fjala e Tij xhel-le xhelaluhu: "Elif Lam Mim. U ngadhnyen Romakët. Në tokën më të ulët, por pas disfatës së tyre ata do të ngadhnyejnë, brenda disa viteve..."(Rum: 1-4)

Ajo që vërehet këtu është: assesi mos të habitemi tash me gjendjen e thirrjes islame në aspektin e asaj se ajo luftohet nga të gjitha anët. Nga ky këndvështrim da'veja islame që nga fillimi i saj i parë poashtu ka qenë e luftuar nga të gjitha anët.

Atëherë vjen pyetja dhe përgjigja.

Çka të veprohet? Çka bëni Pejgamberi, alejhis-selam, dhe sahabet e tij, numri i të cilëve atëherë në krahasim me muslimanët e sodit ka qenë shumë i vogël, numri i të cilëve prej atëherë është zmadhuar shumë?

Këtu fillon përgjigja: a i luftuan muslimanët arabët kundërshtarë-d. m. th. popullin e

tyre-në fillim të da'ves? A i luftuan muslimanët të krishterët në fillim? Përgjigja është: jo, dhe gjithë kjo e ka përgjigjen jo. Atëherë pra, çka bënë muslimanët?

Ne sot duhet të bëjmë saktësisht atë që e kanë bërë muslimanët e parë, me që ajo që është duke na goditur është mu ajo që i ka goditur edhe ata dhe me çka e kanë shëruar musibetin (fatkeqsi) e tyre duhet edhe ne me të që ta shërojmë musibetin tonë. Dhe mendoj se kjo parathënie të gjithë prezentëve ju sinjalizon për përgjigjen me një isharet dhe se ky isharet do të jetë i përforcuar me fjalët e qarta.

Andaj edhe them: Nga kjo kronologji historike dhe logjike në të njejtën kohë, kuptojmë se Allahu, azze ve xhelle, u ka ndihmuar muslimanëve të parë, numri i të cilëve ka qenë shumë i vogël në krahasim me të gjithë kafirët dhe mushrikët, nga gjithë miletet dhe drejtimet e tyre, porse Allahu u ka ndihmuar atyre me imanin e tyre që e kanë pasur.

Atëherë pra ilaçi apo shërimi i kësaj armiqësie të ashpër që e rrethonte da'ven atëbotë duhet të jetë i njëjti ilaç që duhet ta përdorin muslimanët sot, për realizimin e frytit të këtij shërimi siç u realizua fryti i shërimin të parë. Çështja pra është siç thuhet-historia përsërit vetveten-. Bile më mirë se kjo fjalë është që të themi se në robët e Tij dhe gjithësinë që e ka krijuar, Ai ka bërë ligje të Tij që nuk ndryshojnë. "Ligji i Allahut, dhe për ligjin e Allahut nuk mund të gjejsh ndryshim e as ndërrim" (ajet)

Këto ligje muslimani patjetër duhet që t'i vërejë e të kujdeset për to në mënyrë më të mirë e në veçanti për ato të sheriatit. Pra, ka ligje sheriatit dhe ka ligje gjithësie.

Sot, në kohën tonë, ndoshta edhe thuhet ligje natyrore. Në këto ligje natyrore të gjithësisë, të përbashkët në to janë muslimani dhe kafiri, i miri dhe i keqi.

D.m.th. cili e rregullon jetën fizike të nje-

riut? Ushqimi, pija, ajri i pastër dhe të ngjashme me to dhe kjo don të thotë se ai veten e ka ekspozuar për një vdekje materiale! A mundet pra, të jetojë nëse ai del nga të përbajturit për ligjet e gjithësisë?

Përgjigja është jo: "Ligji i Allahut, dhe për ligjin e Allahut nuk mund të gjejsh ndryshim. ."

Këtë, siç thash edhe më lartë, e njeh çdo njeri përmes njohjes empirike, ska dallim ndërmjet muslimanit dhe kafirit, të mirit dhe të keqit.

Por ajo që na intereson tash është që të dijmë se ka ligje sheriati, pra të dijmë se ka ligje sheriati! Ai i cili i mer ato ligje arrin deri tek qëllimet e tyre dhe prej tyre vjel frytet, e cili nuk i mer nuk do të arrijë tek synimet për të cilat janë vënë ato ligje. Pra, mu e njëjta që tham për ligjet e gjithësisë, se njeriu nëse i pranon dhe i zbaton, do të arrijë tek qëllimet e tyre!

Po kështu është edhe me ligjet e shariatit nëse i mer muslimani, realizohet qëllimi për të cilin janë vënë ato, dhe nëse ndodh e kundërta atëherë jo.

Besoj se këto fjalë janë të kuptuara por ka nevojë pak për sqarim, e këtu është pika e synimit dhe këtu fillon përgjigja për atë pyetje të rrëndësishme!

Çdonjëri prej neve e lexon ajetin kur'anor, e ky ajet ndoshta dikujt ia zbukuron mexhliset (ndejet) e dikujt ndoshta muret e shtëpisë, e ai është Fjala e Allahut: "nëse e ndihmoni Allahun, Allahu ju ndihmon juve" (Muhammed: 7)

Nëpër levha që shkruhen me bukurshkrim të praruar në stilin rik'a (lloj shkrimi kaligrafik) apo ate persian, etj., e pastaj varet nëpër mure. Dhe për fat të keq, me këtë ajet vetëm muret janë zbukuruar, kurse zemrat e muslimanëve janë bërë të rrënuara, kur gati se nuk kemi ndjenjë fare për atë në të cilën aludon ky ajet "nëse e ndihmoni Allahun (pra fenë e Tij), Allahu ju ndihmon juve" Prandaj sot gjendja e botës islame është në shqetësim dhe turbullirë sa që gati se nuk i

gjendet rrugëdalje, edhe pse rrugëdalja është përmendur në shumë ajete, ku edhe ky ajet është nga ato ajete.

E nëse ua përkujtojmë muslimanëve këtë ajet, mendoj se çështja nuk ka nevojë pastaj për shumë sqarime dhe komentime sepse çështja është vetëm përkujtim: "...sepse përkujtimi u bën dobi besimtarëve"! (ajet)

Çdonjëri prej neve-inshaAllah-e din se fjala e Allahut: "nëse e ndihmoni Allahun" është kushtimore, përgjigja e së cilës është: "ju ndihmon juve"; nëse han, nëse pin, nëse...përgjigja është do të jetosh; nëse nuk han, nëse nuk pin, çka? Do të vdesësh!

Saktësisht kjo është domethënia në ajetin "nëse e ndihmoni Allahun, Allahu ju ndihmon juve", kuptimi është —në bazë të asaj që e thuan dijetarët e Usulit-të kuptuarit e të kundërtës (mefhumi muhalif): nëse nuk e ndihmoni Allahun, Ai nuk u ndihmon juve; e kjo është situata e muslimanëve sot!

Sqarimi në lidhje me këtë ajet është cekur në shumë citate të Sunetit, e në veçanti në hadithe.

"Nëse e ndihmoni Allahun", nga vetvetiu dihet se Allahu në këte nuk ka për qëllim të thotë që ta ndihmojmë Atë kundër armikut të Tij, me ushtritë, flotat dhe forcën tonë fizike, jo! Sepse Allahu është mbisundues mbi çështjen e Tij! Ai nuk ka nevojë që ta ndihmojë Atë dikush me ndihmë materiale, dhe kjo dihet vetvetiu.

Prandaj domethënia e "nëse e ndihmoni Allahun" nënkupton se nëse i ndiqni dispozitat e Allahut, është ndihma juaj ndaj Allahut, subhanehu ve teala.

Dhe tash, a e kanë bërë muslimanët këtë kusht? E kanë bërë -së pari- këtë detyrë? Pastaj, -së dyti- kjo është kusht i realizimit të ndihmës së Allahut ndaj muslimanëve!

Përgjigja është tek çdonjëri prej juve, se muslimanët nuk e kanë ndihmuar Allahun, xhel-le xhelaluhu, dhe këtu dëshiroj të cek një fjalë, poashtu nga aspekti i të përkujtua-

rit e jo nga ai i të mësuarit, të paktën për disa që janë prezent këtu, se muslimanët në përgjithësi sot janë larguar nga njohuritë e tyre apo njohja e tyre ndaj dinit të tyre, nga mësimi i tyre dispozitat e fesë së tyre. Shumica prej tyre nuk e dinë Islamin dhe një numër i tyre apo shumica prej tyre edhe nëse mësojnë (arrijnë të kuptojnë) prej Islamit diçka, do të del se është Islam jo i vërtetë; e njohin një Islam të devijuar nga ai në të cilin ka qenë Resulullahi, alejhis-selam, dhe sahabët e tij.

Prandaj ai të cilit i premtohet ndihma e Allahut, duhet që së pari ta njohë Islamin me njohje të shëndoshë, siç ka ardhur në Kur'an dhe Sunnet, pastaj së dyti, të veprojë me to. Në të kundërtën, njohja e tillë do të jetë pesim i keq për të zotin e saj, siç ka thënë i Lartmadhëruari: "O ju që keni besuar, pse e thoni atë që nuk e veproni, mëkat i madh është tek Allahu që ta thoni atë që nuk e veproni" (Saff: 3)

Atëherë pra, ne kemi nevojë për ta mësuar Islamin dhe për të vepruar me Islam.

Ajo që dëshiroj t'u përkujtoj, siç thash edhe më lartë, është se tradita e shumicës së muslimanëve sot është që fajin, për nënçimin dhe poshtërimin që i ka kapluar, ta gjuajnë mbi kryetarët dhe mbretërit e tyre të cilët nuk i ndihmojnë dinit të tyre, e ata për fat të keq janë të tillë! Nuk i ndihmojnë dinit të tyre dhe nuk u ndihmojnë muslimanëve të nënshtruar dhe të shkelur nga qafirët e mëdhenj, jehudë të krishterëve edhe të tjerë!

Kështu kjo sot qarkullon në mesin e muslimanëve! Hudhja e fajit mbi pushtetmbajtësit, e sikur këta as që i kaplon ai faj që e gjuajnë mbi pushtetmbajtësit! Ndërsa në realitet ky faj i kaplon të gjithë, qofshin kryetarë apo popullatë! Dhe nuk është vetëm kjo, por ka një grup prej këtyre qortuesve që janë qortues ndaj kryetarëve të muslimanëve, për shkak se këta të fundit nuk i zbatojnë dispo-

zitat e dinit të tyre. Ata kanë të drejtë me këtë qortim por janë në kundërshtim me fjalën e Allahut "nëse e ndihmoni Allahun", e kam fjalën për të njëjtët muslimanë, qortues të qeveritarëve kur i veçojnë vetëm ata me faj, se ata i kanë kundërshtuar dispozitat e Islamit, kur për ndryshimin e kësaj gjendje të pikëlluar të muslimanëve ndjekin rrugën në atë mënyrë që është në kundërshtim me atë të Pejgamberit, alejhis-selam, ku ata së pari i shpallin pushtetmbajtësit qafira, e pastaj, së dyti shpallin domosdoshmërinë e huruxhit (dalje, kryengritje) kundër tyre!

Këtu më pas ndodhë fitne e verbër, e shurdhër dhe memece në vetë duart e muslimanëve, ku pastaj vetë muslimanët në mes veti përçahen! E prej tyre pra janë edhe këta që tregova pak më lartë të cilët mendojnë se ndryshimi i kësaj gjendje nënçmuese e goditëse ndaj muslimanëve duhet të bëhet përmes daljes kundër pushtetmbajtësve! Çështja nuk ndalet tek ky problem, por ajo zgjerohet edhe më shumë deri sa të bëhet përçarje edhe ndërmjet vet muslimanëve, e pastaj pushtetmbajtësi bëhet i izoluar nga kjo përçarje!

Përçarja filloi nga teprimi i disa islamistëve në shërimin e kësaj gjendje të dhimbshme, se duhet patjetër që të luftohen kryetarët e muslimanëve për përmirësimin e kësaj gjendje! Mirëpo çështja shkoi deri aty sa që këta muslimanë armiqësohen me muslimanët tjerë të cilët mendojnë se shërimi i situatës së mjerueshme nuk bëhet përmes daljes kundër kryetarëve edhe pse shumë prej tyre e meritojnë daljen kundër tyre, për shkak se ata nuk gjykojnë me atë që e ka zbritur Allahu!

Mirëpo, a bëhet shërimi-siç pretendojnë këta njerëz —a bëhet mënjanimi i asaj që i ka goditur muslimanët nga ana e qafirëve me atë që ne të fillojmë me gjykimin e kryetarëve në vendet islame të muslimanëve? Edhe pse disa prej tyre i konsiderojmë musli-

manë gjeografik, siç thuhet në kohën e sodit.

Këtu ne themi: "I renditi Sa'di dhe Sa'di ishte tubues-por kështu o Sa'd nuk mbli-dhen devet" (proverb popullor arab, sh. p.).

Ajo në të cilën nuk ka dyshim është se qëndrimi më i thellë i armiqve të Islamit, e që janë jehudët, krishterët dhe ateistët jash-të vendeve islame, janë padyshim më të dëmshmit se disa kryetarë të cilët nuk u për-gjigjen disa kërkesave të muslimanëve që t'u gjykojnë me atë që e ka zbritur Allahu! E çka munden këta muslimanë? E kam për qëllim një anë të tyre e që janë ata të cilët shpallin domosdoshmërinë e luftimit të kryetarëve të muslimanëve! Çka munden këta muslimanë që për ta dalja kundër kryetarëve është va-xhib para fillimit me përmirsimin e vetes to-në?! Ashtu si ishte shërimi me të cilin filloi Pejgamberi, alejhis-selam.

Këta assesi nuk kanë mundësi që të bëjnë gjë! Realiteti është argumenti më i madh për këtë! Sepse shërimi të cilin e ndjekin ata, që të fillojnë t'i luftojnë kryetarët e muslimanëve, nuk e jep frytin e duhur, ngase dobësia, siç thash edhe më sipër, nuk është vetëm tek kryetarët, por edhe tek populli! Të gjithë ata pra e kanë për detyrë që ta përmirësojnë ve-ten. Ndërsa ky përmirësim ka studim më vete, që kemi folë për të shumë herë e ndoshta, inshaAllah, do të flasim edhe në të ardhmen.

Me rëndësi është tash se të gjithë musli-manët janë të një mendimit se gjendja e tyre është diçka për të cilën as xhelozojnë e as lakmojnë! Por ajo është një nënçmim dhe poshtërim të cilin nuk e njeh Islami! Pra, prej nga të fillojmë?!

A të bëhet fillimi me luftën kundër kryeta-rëve të muslimanëve? Apo të jetë fillimi me luftën kundër të gjithë qafirëve nga të gjitha vendet?! Apo të jetë fillimi me luftën kundër nefsit që urdhëron gjithnjë në të keqe? Nga këtu duhet të jetë fillimi, për shkak se Pej-

gamberi, alejhis-selam, filloi me përmirësi-min e shpirtrave të individëve muslimanë të thirrur në fillim të thirrjes islame-siç e për-mendëm në fillim të këtij fjalimi.

Da'veja filloi në Mekke, pastaj u shpërngul në Medine, pastaj filloi përleshja në mes qafirëve dhe muslimanëve, pastaj në mes muslimanëve dhe romakëve, pastaj mes muslimanëve dhe Persisë...dhe kështu, siç thamë më lartë, Historia përsërit veten! Tash muslimanët le t'i ndihmojnë Allahut që ta shërojnë këtë gjendje të dhembshme, e jo që të shërojnë një anë që nuk e jep frytin e dëshiruar në të, nëse kanë mundësi që ta bëjnë atë! Cila është kjo anë? Të luftuarit e kryetarëve të cilët nuk gjykojnë sipas asaj që e ka zbritur Allahu!? Kjo, së pari -siç thash edhe më lartë- është e pamundur sot që të luftohen kryetarët! Sepse këta kryetarë sikur të ishin qafirë sikur jehudët dhe të krishterët, e muslimanët sot a munden që t'i luftojnë jehudët dhe krishterët? Përgjigja është: jo!

Çështja është e njëjtë siç kanë qenë musli-manët e parë në periudhën e Mekkes! Ata ishin të dobësuar, të nënçmuar, të luftuar nga të gjithë, të torturuar e të vrarë, pse? ! Sepse ata ishin të dobët dhe nuk kishin forcë dhe fuqi përveç imanit i cili depërtoi në gjoksat e tyre për shkak se e ndiqnin thirrjen e Pejgamberit të tyre, alejhis-selam. Kjo ndjekje me sabër ndaj vuajtjeve ishte ajo që e dha rezultatin e dëshiruar, të cilin ne sot e potencojmë. Cila është pra, rruga deri tek ky rezultat? E njëjta rrugë që e ndoqi Pejgambe-ri, alejhis-selam, me sahabet e tij të nderuar.

Atëherë pra, sot muslimanët nuk kanë mundësi t'i luftojnë qafirët, në çfarëdo dala-leti qofshin ata! E çka duhet ata të bëjnë? Ata duhet që të besojnë në Allahun dhe Pej-gamberin në mënyrë të vërtetë (pra hakk!). Por, muslimanët e sodit, siç ka thënë Zoti i të gjitha botërave "shumë prej tyre nuk e

dinë"! (ajet), muslimanët sot janë me emër e nuk janë muslimanë të vërtetë (hakk)! Mendoj se edhe ju dini, bashkë me mua, qëllimin e këtij mohimi! Por unë ua përkujtoj thënien e Allahut, subhanehu ve teala,: "Besimtarët kanë shpëtuar, të cilët në namaz janë me hushu (frikrespekt i plotë, përvullësi), të cilët u shmangen të kotave (fjalë a punë), të cilët e japin zeqatin, dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (intim), përveçse ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj atyre (robërshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar, e kush kërkon përtej tyre, të tillët janë që kanë shkelë normat e caktuara" (Mu'minun: 1-7)-d.m.th tiranët, zullumçarët.

E nëse i marim vetëm këto cilësi dhe nuk kalojmë nga ajetet që i ngërthejnë këto cilësi në ajete tjera, në të cilat përmenden disa cilësi që nuk janë përmendur në këto ajete, do të shohim se ato të gjitha sillen rreth të vepruarit me Islam! Te cili njeri realizohen këto cilësi të përmendura në këto ajete të lartpërmendura dhe në ajete tjera, konsiderohet prej atyre për të cilët thotë Allahu i lartmadhëruar: "ata janë me të vërtetë (hakk) besimtarë" (Enfal: 4).

E ne pra a jemi besimtarë me të vërtetë (hakk)? Përgjigja është: jo! Atëherë vëllezër mos u shqetësoni!

Ne namazlijtë sot-kjo cilësi-: "Besimtarët kanë shpëtuar, të cilët në namaz janë me hushu (frikrespekt i plotë)", a jemi me hushu' në namazin tonë?

Unë nuk flas për një person, dy, pesë, dhjetë, njëqind, dyqind, njëmijë, dymijë... Jo, por flas, së paku për muslimanët të cilët pyeten në mes veti, cila është zgjidhja nga ajo që i ka goditur muslimanët? Nuk i kam për qëllim ata muslimanë që zbaviten dhe bëjnë mëkate, ata të cilët nuk iu intereson ahireti i tyre por i interesojnë epshet dhe ngopja e barkave të tyre! Jo, por flas për muslimanët namazli!

Këta namazli pra a janë pajisur me ato cilësi të përmendura në fillim të sures Mu'minun?

Përgjigja, si xhemat dhe si ummet, është: jo!

Pra, shpreson në shpëtim e nuk e ndjek rrugën e saj? Anija nuk lundron në të thatë!

Atëherë pra, patjetër t'i kapim shkaqet, të cilat janë prej plotësuesëve të ligjeve të shariatit pas atyre të gjithësisë, derisa ta ngrejë Zoti ynë nga ne këtë poshtërim i cili na ka kapluar të gjithëve!

Këto cilësi unë i përmenda prej cilësive të besimtarëve që përmenden në fillim të kësaj sure. Por kemi hadithe të Pejgamberit, alejhis-salam, për të cilat i përkujtojmë vëllezërit tanë, të cilat na e përkujtojnë gjendjen e muslimanëve sot, dhe se sikur që ata ta përkujtojnë këtë hadith do t'u vinte turp që të pyetnin se pse na ka goditur kjo poshtërim! Sepse ata haruan se e kundërshtojnë Sheriatin e Allahut! Prej atyre haditheve është edhe fjala e tij, alejhisselam: "nëse bëni shitblerje me fajde, shkoni pas bishtave të lopëve, dhe jeni të kënaqur vetëm me mbjelljekorje, dhe e leni Xhihadin në rrugë të Allahut, Allahu ua mvesh një poshtërim që nuk e tërhjek nga ju derisa t'i ktheheni dinit tuaj" (Ebu Davudi në Sunenin e tij nr. 3462, Ahmedin në Musnedin e tij nr. 5007 dhe 5562 dhe Taberaniu në Musnedushshamijin nr. 2417 dhe të tjerët. Të gjithë, merfu', nga hadithi i Ibën Omerit)

Për këtë hadith kam folur shumë e shumë herë, dhe në raste të shumta, por unë ndalem vetëm te fjala e Alejhisselamit: "nëse bëni shitblerje me fajde". Fajdeja është një nga llojet e kamatës dhe nuk dëshiroj që të futem në të në mënyrë të veçantë, por a ka ndonjëri prej juve që nuk i njeh marrëdhëniet e muslimanëve me llojet e kamatës? Këto bankat që veprojnë me kamatë i kemi në çdo krah dhe çdo këmbë në të gjitha vendet islame dhe të pranuar nga të gjitha organi-

zatat e akredituara në vendet islame! Sërisht kthehem dhe them se nuk janë të pranuar vetëm nga qeveritarët por edhe nga të qeverisurit (populli) sepse këta të qeverisurit (populli) janë ata të cilët bashkëpunojnë me këto banka dhe po ata janë të cilët kur të bisedohet me ta dhe t'u thuhet: ju e dini se kamata është haram dhe se çështja është sikur që thotë Alejhisselami: "një dirhem (lloj monedhe) kamate të hajë njeriu, tek Allahu azze ve xhel-le është më e keqe se tridhjet e gjashtë zina" (Ahmedi në Musnedin e tij nr. 22007 dhe 22008 edhe Darekutni në Sunenin e tij 3/16 edhe të tjerë nga Abdullah bin Handhale), vëllau im përse bashkëpunon me kamatë?!

Ai ta kthen: e çka të bëjmë, duhet të jetojmë!

Atëherë pra çështja nuk ka lidhje vetëm me kryetarët, por me kryetarët e edhe me të kryesuarit (popullin)! Të kryesuarit (popullit) në të vërtetë u përngjan shembulli i atyre kryetarëve, dhe siç thonë: "krymbi i prishjes është prej tij dhe (kthehet) në të" (proverb popullor sirian). Këta kryetarë nuk kanë zbritur në mesin tonë nga Marsi, por lindën nga ne dhe ndër ne! E nëse dëshirojmë përmirësimin e gjendjes tonë atëherë kjo nuk duhet që t'u shpallim luftë të pakuptimtë kryetarëve tanë e ta harrojmë vetveten tonë! Kurse problemi është nga ne dhe në ne, sikur që është problemi në botën islame!

Prandaj ne i këshillojmë muslimanët që t'i kthehen dinit të tyre dhe ta zbatojnë atë që e kanë mësuar nga dini i tyre, dhe "atëditë do të gëzohen besimtarët me ndihmën e Allahut" (Rum: 5). Të gjitha problemet ekzistuese, nga të cilat disa të rinj emocionohen e thonë se çka duhet bërë, qofshin ato që themi se e kanë goditur botën islame dhe arabe siç është pushtimi i Palestinës nga ana e jehudëve, apo ato që themi se kryqtarët i luftojnë muslimanët në Eritri, në Somali, në Bosnjë, në... e deri tek vendet e njohu-

ra sot, nuk mund të shërohen përmes ndjenjave (solidarizuese), por shërohen me dituri dhe vepër: "dhe thuaj: veproni e pastaj Allahu do ta shohë veprën tuaj dhe i Dërguari i Tij e pastaj do të ktheheni tek i Ditur (Allahu) i të fshehtës dhe të haptës dhe do t'u lajmërojë për atë që keni vepruar"! (Teube: 105)

Tash të ndalemi tek kjo pikë: "dhe thuaj: veproni. . ."! Të vepruarit sot për Islam në arenën islame është në shumë mënyra dhe në lloje të ndryshme, në grupe e partia të ndryshme! Çështje e vërteta se këto parti janë prej problemit të botës islame të cilat problemin e stërmadhojnë edhe më shumë se sa që e shohin disa prej tyre. Disa prej tyre e shohin problemin se është në okupimin e Palestinës nga jehudët, e disa, siç e përmendëm edhe më lartë, e shohin se problemi është tek luftimi i qafirëve ndaj shumë vendeve islame dhe banorëve të tyre! Por, JO!

Ne themi: se problemi është më i madh, e ajo është përçarja e muslimanëve! Pra muslimanët vet në mes veti janë të ndarë në grupacione dhe parti, në të kundërtën e fjalëve të Allahut, subhanehu ve teal: "mos u bëni nga mushrikët, të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe (partija), ku secila parti i gëzohet asaj që e ka" (Ruum: 32).

Tash xhematet islame janë të përçarë në lidhje me mënyrën e shërimit të problemit nga i cili qahen të gjitha xhematet islame, e ai është poshtërimi i cili u ka rënë mbi krye muslimanëve dhe cila është rruga për t'u shporrë ail

Aty ka disa mënyra:

Mënyra e parë: është mënyra më e mirë për të cilën nuk ekziston të dytë, e ajo është ajo në të cilën gjithnjë dhe përherë thirrim. Ajo është të kuptuarit e shëndoshë të Islamit dhe të praktikimit të tij dhe edukimi i muslimanëve në këtë Islam të kulluar. Ky është sunneti i të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, siç kemi përkujtuar dhe përkujtojmë

pandërprerë! I Dërguari i Allahut, alejhisselam, filloi me sahabët e tij duke i udhëzuar ata në besim (iman) në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, duke ua mësuar atyre dispozitat e Islamit. Ata i qaheshin nga goditjet që i pësonin nga zullumi dhe vuajtjet që ua bënin mushrikët, por ai alejhisselam i urdhëronte për sabër dhe vetëm sabër! Dhe se ky është ligji i Allahut në krijesat e Tij, që të luftohet hakki (e vërteta) nga batili (e kota, e pavërteta) dhe që të luftohen besimtarët nga mushrikët, e kështu me radhë!

Pra mënyra e parë për shërimin e këtij realiteti është dituria e dobishme dhe vepra e mirë. Ekzistojnë lëvizje dhe thirrje tjera të cilat të gjitha takohen në kundërshtim me atë rrugën e parë dhe më të mirë e përvëç të cilës nuk ka të dytë, e që janë: lerëni Islamin tash anash, përse i përket domosdoshmërisë së të kuptuarit të tij! Kurse sa i përket domosdoshmërisë së të vepruarit me të, çështja tash është më me rëndësi se kjo çështje, e ajo është që ne të tubohemi dhe të bashkohemi në luftën kundër qafirëve! Subhanallah!

Si mundet t'i luftojmë qafirët pa armë? Çdo njeri që ka një grimcë mend e din se nëse ai nuk posedon armatim material, nuk mund ta luftojë armikun e tij të armatosur! Nëse ndokush dëshiron ta luftojë këtë armik të tij të armatosur, çka i thuhet? Lufto i paarmatosur, apo armatosu e pastaj lufto? Në këtë çështje as që ka diskutim se përgjigja është: armatosu e pastaj lufto! Kjo është sa i përket anës materiale.

Ndërsa sa i përket asaj morale, çështja është shumë më me rëndësi se kjo, nëse ne dëshirojmë që t'i luftojmë kufarët! Pastaj, ne nuk do të mundemi t'i luftojmë kufarët e Islamit ta lëmë anash, sepse kjo është në kundërshtim me atë që i ka urdhëruar Allahu, subhanehu ve teala, dhe i Dërguari i Tij a. s. besimtarët në shumë tekste, sikur ky në të

cilin thotë I Madhërishmi: "Pasha asrin (kohën, shekullin), njeriu me të vërtetë është në humbje! Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira dhe njëri tjetrin e këshillonin në hakk dhe njëri tjetrin e këshillonin në sabër" (Asr: 1-3)

Ne pa dyshim jemi në humbje "njeriu me të vërtetë është në humbje"! Pse? Sepse nuk hyjmë në përjashtimin që e ka përmendur Allahu, azze ve xhel-le, kur tha: "njeriu me të vërtetë është në humbje! Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira dhe njëri tjetrin e këshillonin në hakk dhe njëri tjetrin e këshillonin në sabër"! Ne tash themi kemi besuar në Allahun dhe Pejgamberin e Tij, mirëpo kur i ftojmë muslimanët e partizuar dhe të tubuar jashta thirrjes së vërtetë, të kthehen në Librin (Kur'anin) dhe Sunetin, thonë këtë tash ta lëmë anash, kur çështja është edhe më e rëndësishme, të luftuarit kufarët! Dhe themi: me armë apo pa armë? ! Patjetër duhet me të dy llojet e armëve! Arma e parë: arma morale.

E ata thonë, tash lëreni këtë armatim anash dhe merrni armën materiale! E pastaj, nuk ka armë materiale! Kjo me që është e pamundur për gjendjet në të cilat tash jemi të sunduar, jo vetëm nga kufarët që na kanë rrethuar nga të gjitha anët por edhe nga disa kryetarë që na sundojnë! Ne pra edhe sikur të duam, sot nuk mundemi që të bëjmë pregaditje për armatim material! Dhe themi: dëshirojmë të luftojmë më armën materiale! E për këtë nuk kemi rrugë për të arritur deri tek ajo.

Kurse sa i përket armës morale ajo është në duart tona e që është: "dije se nuk ka zot përveç Allahut" (Muhammed: 19), dituria pastaj vepra në suaza të asaj që mundemi. Ndërsa këtë e themi në mënyrën më të thjeshtë: lëreni këtë anash? ! Kjo na është e mundur dhe urdhërohemi që ta lëmë anash?! Kjo me të vërtetë është e pamundur!

Prandaj themi: duhet të luftojmë! E me çka

të luftojmë? I humbëm të dy armatimet së bashku! Armatimin moral të dijës themi ta shtyjme për më vonë, sepse nuk është tash koha e tij! Armatimin material nuk mundemi dhe mbetëm të prishur, të shkatërruar dhe të dobët në të dy armatimet, atë moral dhe atë material!

Nëse kthehemi në shekullin e parë më të ndritshëm, e që ishte shekulli i parë i Muhamedit, alejhis-selam, dhe të pyesim: a ka pasur armatim material? Përgjigja është: jo!

Atëherë me çka ka qenë çelësi i fitores, me armatimin material apo me atë moral? Padyshim se me atë moral dhe me të filloi da'veja, sikur në ajetin: "dije se nuk ka zot përveç Allahut"!

Atëherë pra, dija para çdo gjëje! Dija për Islamin para çdo gjëje e pastaj zbatimi i këtij Islami në suaza të asaj që mundemi. Mundemi që ta njohim akiden islame-natyrisht atë të shëndoshën-; mundemi t'i njohim ibadetet islame, mundemi t'i njohim dispozitat islame, mundemi ta njohim sjelljen islame, etj. Të gjitha këto edhe pse janë të mundura, shumica e muslimanëve me partitë dhe grupacionet e tyre, ua kanë kthyer shpinën atyre! Pastaj ngritim zërat lartë: dëshirojmë xhihad!

Ku është xhihad, përderisa armën e parë e kemi të humbur e të dytën nuk e kemi në duar?! Sikur të gjejmë ne sot një grup muslimanësh të tubur në islamin e shëndoshë dhe ta zbatojnë atë në mënyrë të shëndoshë, mirëpo ata nuk kanë armatim, atyre u vjen urdhëri i Allahut në ajetin e njohur: "e përgadituni për ata sa të keni mundësi force (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë, e me të ta frikësoni (trishtoni) armikun e Allahut dhe armikun tuaj" (Enfal: 60) Sikur ta kishim armën e parë morale, atëherë ne do të ishim ata të cilëve u drejtohet ky ajet për përgaditje fizike.

Atëherë pra, a të luftojmë nëse nuk kemi përgaditje (të armës) materiale?

Përgjigja është: jo, sepse nuk e kemi realizuar këtë ajet që na urdhëron për përgaditje materiale! Atëherë pra çka është puna me ne? Si kemi mundësi të luftojmë kurse kemi falimentuar në të dy armët, edhe ato morale edhe ato materiale? ! Atë material tash nuk e kemi në mundësi, kurse për atë moral kemi mundësi.

Atëherë, "Allahu nuk e ngarkon askënd jashtë mundësive që ka" (Bekare: 286) dhe "frigohuni (me takva) Allahut sa të keni mundësi"! (Tegabun: 16)

E ajo që kemi tash mundësi është dija e dobishme (ilm nafi') dhe vepra e mirë (amel salih).

Ndoshta e zgjata në këtë përgjigje më tepër sa që duhej, por unë tash e rezymoju dhe them:

Vëllezër, nuk është problemi vetëm tek Palestina, sepse për fat të keq, nga devijimi aq i madh (me të madhe) që i ka goditur sot muslimanët, ata dijen e tyre e kundërshtojnë me veprat e tyre! Kurse kur flasim për Islamin dhe për vatanin islam, themi: të gjitha vendet islame janë vatan i çdo muslimani; nuk ka dallim ndërmjet arabit dhe joarabit, ndërmjet atij të Hixhazit dhe jordanezit dhe egjiptianit etj. Mirëpo, këto dallime faktike janë dhe ekzistojnë, dhe jo vetëm në aspektin politik! Dhe nuk është për t'u çuditur kurrë! Ky dallim është edhe tek islamistët, p.sh. gjen disa dajj (thirrës) se si i kushtojnë rëndësi vetëm Palestinës dhe i harojnë vendet tjera, e nuk ju intereson çka i godet muslimanët tjerë në vendet tjera, si p. sh. kur ishte lufta ndërmjet muslimanëve afganë dhe sovjetëve dhe komunistëve me ta. Përse? Sepse ata nuk janë, p. sh. sirianë, egjiptianë, e të ngjajshme!

Pra problemi tash nuk është i kufizuar vetëm në Palestinë, por ka kaluar edhe në shumë vende tjera islame. E si ta shërojmë këtë problem të përgjithshëm?

Me të dyja armët, atë morale të dijës dhe atë materiale.

E me çka të fillojmë?

Para çdo gjëje fillojmë me atë më me rëndësi, dhe më të rëndësishmen, e në veçanti kur të jetë më e rëndësishmja e kollajshme.

Ajo është arma morale-pra të kuptuarit e shëndoshë të Islamit dhe praktikimi i tij i shëndoshë, e pastaj arma materiale nëse është e kollajshme.

Sot për fat të keq ajo që ndodhi në Afganistan, dhe armatimi që u përdor –arma materiale-me të cilat muslimanët i luftuan komunitetët, a ishin armë islame? Përgjigja është: jo!

Ato ishin armë perëndimore dhe ne tash nga aspekti i armatimit material jemi të robëruar! Sepse sikur të duam të luftojmë dhe jemi të fuqishëm nga aspekti i forcës morale, ne kemi nevojë që ta importojmë këtë armatim, ose me çmim ose me lëshim ose me diçka për diçka! Siç e dini politika perëndimore sot është sikur ai proverbi popullor: "më jep, të të jap". D. m. th. se cilido shtet sot as edhe me çmim nuk të shet armatim pa të kërkuar lëshime. Të bësh lëshime ty o populli musliman për të të dhënë armatim të cilit gjithashtu ia paguan hakun. Pra, vëllezër çështja nuk është siç e paramendojmë ne, vetëm ndjenja dhe emocione të rinisë dhe revolucione, sikur fluska e sapunit e cila ngritet lart pastaj avullohet dhe shkrirhet në tokë pa asnjë gjurmë!

Në fund them: "dhe thuaj: veproni dhe pastaj do ta shohë Allahu veprën tuaj dhe Pejgamberi i Tij..." deri në fund të ajetit.

Por e përsëris se vepra (ameli) nuk bën dobi pa qenë e shoqëruar me dije të dobishme (ilm nafi'), ndërsa dija e dobishme është: ka thënë Allahu, ka thënë Pejgamberi, siç ka thënë Ibën Kajjim-rahimehullah:-

"Dija është ka thënë Allahu, ka thënë

Pejgamberi

kanë thënë Sahabet, e jo me maskim

Dija nuk është përpjekja jote e keqe për ngatrim

në mes Pejgamberit dhe atij të keqit

Assesj, as mospranim i Sifateve dhe

mohim i tyre

kujdes nga prishja dhe turbullimi"

Musibeti (goditja) e botës islame është edhe më e rrezikshme, dhe ndoshta dikush nga ju e mohon këtë që e them! Por musibeti i muslimanëve sot është më i rrezikshëm se okupimi i jehudëve ndaj Palestinës! Musibeti i botës islame është se ata e kanë humbur rrugën e vërtetë, se ata nuk e kanë njohur Islamit përmes të cilit arrihet lumturia e kësaj dhe e botës tjetër, së bashku. E sikur muslimanët të jetojnë në disa rrethana të nënçmuar dhe të torturuar nga kufarët dhe mushrikët e të vriten apo të gozhdohen dhe pastaj të vdesin, ska dyshim se vdesin të lumtur edhe pse kanë jetuar në këtë botë të shkelur dhe të nënçmuar.

Ndërsa ai i cili jeton krenar në këtë jetë dhe ai është larg të kuptuarit të Islamit, siç ka dashur Allahu dhe i Dërguari Tij, ai do të vdesë si fatkeq edhe pse në pamje të jashtme duket se ka jetuar i lumtur.

Atëherë pra, Allahu ju bekoftë, ilaçi është: ikni tek Allahu, ilaçi është ikni tek Allahu! Ikni tek Allahu (ajet) don të thotë; kuptoni atë që e ka thënë Allahu dhe që ka thënë Pejgamberi i Tij dhe veproni me atë që ka thënë Allahu dhe që ka thënë Pejgamberi i Allahut, dhe me këtë e përfundoj këtë përgjigje. Ve sal-lallahu ala nebijjina ve ala Alihi ve Sahbihi ve sel-leme, velhamdulil-lahi Rabbil alemin.

Marrë nga: islamvay.com

Përktheu: Emin Limani

Muhammed Nasirud-din Albani,

18.6.2004

12. Vlera e zuhdit në këtë botë

Transmeton Abdullah ibën Omeri, radijallahu anhu, i cili thotë: Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, më vëndoi dorën mbi supin tim dhe më tha: "Jeto në këtë botë sikur të jesh i huaj ose si një kalimtarë rruge". Ibën Omeri gjithnjë thoshte: kur të ngrysesh mos prit agimin e kur të gdhiesh mos e prit muzgun e mbrëmjes. Merr nga shëndeti yt për sëmundjen tënde dhe nga jeta yte për vdekjen tënde. Transmeton Buhariu.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "E ti (Muhammed) paraqitjau atyre shembullin e kësaj bote që është si një ujë (shi) që Ne e lëshojmë nga qielli, e prej tij bima e tokës zhvillohet e shpeshëtohet sa që përzihet mes vete, e pas pak ajo bëhet byk (pas tharjes) që e shpërndajnë erërat. All-llahu ka fuqi për çdo send. Pasuria dhe fëmijët janë stoli e kësaj bote, kurse veprat e mira (frtyi i të cilave është i përjetshëm) janë shpërblimi më i mirë te Zoti yt dhe janë shpresa më e mirë." (El-Kehf -45, 46)

Të jesh asket në një gjë don të thotë t'ia kthesh shpinën asaj gjëje dhe ta vlerësosh si të vogël, të pavlerë që nuk përkon me ambiciet e larta.

Selefi (gjeneratat e para të muslimanëve) dhe ata që kanë ardhur pas tyre kanë spjeguar domethënien e zuhdit në këtë botë. Në një hadith tjetër Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "të jesh asket ndaj kësaj bote nuk do të thotë të ndalosh të lejuarën apo të shkatërrosh pasurinë porse të jesh asket do të thotë që shpresa yte të mos jetë më e fortë në atë që e ke ne dorën tënde nga ajo që është në dorë të Allahut dhe të dëshirosh që nëse të godet ndonjë fatkeqësi të mos lirohesh nga ajo Oe qëllim që të fitosh shpërblime." (Transmeton Tirmidhiu i cili dhotë: hadithi është garib dhe nuk e njohim vetëm në bazë të këtij senedi).

Vehb ibën Virdi lidhur me zuhdin ka thënë: zuhdi ndaj kësaj bote është: të mos ndiesh keqardhje nga ajo që të ka ikur dhe të mos gëzohesh me atë që e fiton prej të mirave të kësaj bote.

Zuhriu kur u pyet për zuhdin tha: ai që harami i tij nuk ia tejkalon sabrin dhe hallalli nuk e pengon nga ibadeti .

Ahmed ibën Havarij, rahimehull-llah, e ka pyetur Sufjan ibën Ujejnën: cili është asket (zahid) në këtë botë? Ai është përgjigjur: ai i cili falendëron për begatitë e nëse sprovohet duron. Ai përsëri i ka thënë: o Ebu Muhamed, ai i cili kur i vijnë bëgatitë falendëron Allahun kurse kur sprovohet bën durim dhe ndahet nga ato begati si mund të jetë asket? Ai i tha: hesht! Atë që s'e pengojnë begatitë për të falenderuar Allahun e as fatkeqësitë për të duruar, ai është asket i vërtetë.

Rebia ibën Hajthem ka thënë: kulmi i asketizmit është mbledhja e gjërva me të drejtë dhe vënia e tyre në vendet përkatëse me të drejtë.

Sufjan Etheuriu ka thënë: asketizmi ndaj kësaj bote është shpresa afatshkurte, nuk është ushqimi i papëlqyer e as veshja e dobët. Pastaj tha: prej lutjeve që bëjnë ata janë: o Zot na bën asketë në këtë botë dhe na jep prej të mirave të saj, mos na privo nga ato që të mos lakmojmë.

Imam Ahmedi tha: asketizmi ndaj kësaj bote është shpresa afatshkurte, kurse në një rrast tjetër tha: ...shpresa afatshkurte dhe most ë lakmosh atë qe është në duar të huaja.

Për kuptimin e hadithit të përmendur në fillim të kapitullit kanë thënë: mos u fundos në të mirat e

kësaj bote dhe mos e bën atë vatan tëndin, mos i pëshpërit vetes për qëndrim të gjatë në të e as për përkujdesjen ndaj saj. Mos u lidh për të si, bën gurbetxhiu me vendin e huaj dhe mos u merr ne të me atë që nuk do të merrej një gurbetxhi ne vendin e huaj i cili mendon që të kthehet në vendin e tij.

Sa i përket fjalës së Ibën Omerit .." kur të ngrysesh mos prit agimin e kur të gdhihesh mos e prit muzgun e mbrëmjes" është një nxitje prej tij që besimtari gjithmonë të jetë i përgatitur për vdekje, kurse përgatitja për vdekje bëhet me punë të mira, ashtu siç mund të kuptojmë nga hadithi nxitje për të qenë dëshirat tona afatshkurte, pra të mos i vonojmë punët e natës deri në mëngjes e kur të gdhihemi të mos i pëshpërsim vetes për mbrëmjen dhe t'i vonojmë punët e ditës deri në mbrëmje.

Fjala "Merr nga shëndeti yt për sëmundjen tënde" është nxitje për të shfrytëzuar shëndetin, të derdhim mundin gjatë kohës kur jemi të shëndoshë me frikë që të mos na godet ndonjë sëmundje e të paaftësohemi për punë. Njëashtu edhe fjala e tij "... dhe nga jeta yte për vdekjen tënde" është nxitje për shfrytëzimin e ditëve të jetës sepse ai i cili vdes i ndëpritet mundësia e të vepruarit, i këputet shpresa dhe i rritet ngashëria. Ta dijë ky njeri se do t'i vij një kohë e gjatë e ai do të gjendet nën dhe, dhe nuk do të ketë mundësi të vepron.

Hadithet që flasin për vlerën e zuhdit ndaj kësaj bote janë të shumta, prej tyre: një njeri i that të Dërguarit të Allahut: më udhëzo në ndonjë punë të cilën nëse e bëj do të më dojë Allahu dhe do të më duan njerëzit! Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, i tha: "bëhu asket ndaj kësaj bote të don Allahu dhe bëhu asaket ndaj asaj që e posedojnë njerëzit të duan njerëzit" (Tranmeton Ibën Maxheja dhe Tirmidhiu i cili thotë se hadithi është hasen)

Poashtu hadithi "ka shpëtuar ai i cili ka pranuar Islamin, ai që rrizku (që ia ka caktuar Allahu) i tij i mjafton dhe është i kanaqur me të." (Transmeton Tirmidhiu)

Ibrahim Ed-hemi ka thënë: zuhdi është tre lloje: obligativ, vullnetar dhe shpëtues. Zuhdi obligativ është të përmbajturit nga harami (e ndaluara), zuhdi vullnetar është mosthëllimi në gjëra të lejuara kurse ai shpëtues është të përmbajturit nga dyshimet. Vëlla i nderuar musliman! Dije se zuhdi më i mirë është ai i Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe shokëve të tij të zgjedhur. Librat e kodifikimit të sunnetit janë përplot shembuj ku tregohet zuhdi dhe durimi i tyre, mund të përmendim fjalën e Omerit r.a.: kam parë Pejgamberin, salallahu alejhi ve sel-lem, të cilit i kalonte tërë dita e ai krrusej ngaqë nuk gjente as humën e llojit më të dobët për t'u ushqyer" (Transmeton Muslimi)

Aishja, radijallahu anha, thotë: "nuk është ngopur familja e Muhamedit me bukë thekri dy ditë njëra pas tjetrës deri sa ka ndërruar jetë Pejgamberi." (Transmeton Muslimi)

Ebu Hurerja, radijallahu anhu, thotë: "nuk është ngopur i Dërguari i Allahut dhe familja e tij tre ditë me rradhë me bukë gruri deri sa u nda prej kësaj bote." (Transmeton Muslimi)

Një njeri hyri në shtëpinë e Ebu Dherrit dhe pasi rrotulloi shikimin rreth e përçark tha: o Ebu Dherr! Ku i ke plaçkat e shtëpisë? Ai tha: ne kemi një shtëpi tjetër kah e cila shpresojmë (ka për qëllim xhenetin sh.p.) ai përsëri iu drejtua: patjetër të kesh plaçka përderisa jeton në këtë vend! Ebu Dherr i ktheu: pronari i shtëpisë nuk na lejon që të mbetemi këtu.

Omer ibën Abdulazizi në një hutbe (ligjërim) të tij tha: kjo botë nuk është vendbanimi i përher-hsëm i juaji, Allahu ka caktuar për te zhdukjen kurse për banorët e saj udhëtimin. Sa prej begative të mëdha janë shkatërruar shumë shpejtë dhe sa prej banorëve të lumtur prej saj kanë udhëtuar!

Hasen el Basriu, rahimehull-llah, ka thënë: nënçmoeni dunjanë se pasha Allahun më të lumtur jeni kur nënçmoni dunjanë.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)